

**PËRMBLEDHJE
LËNDËSH TË
PËRZGJEDHURA
NGA PRAKTIKA
GJYQËSORE LIDHUR
ME ARMËT E ZJARRIT**

**E DREJTA PENALE
DHE PRAKTIKA
GJYQËSORE NË KOSOVË**



United Nations
Office on Drugs and Crime



ROADMAP
FOR SALW CONTROL
IN THE WESTERN BALKANS BY 2020



**GLOBAL
FIREARMS
PROGRAMME**

Countering Illicit Firearms Trafficking and Related Crimes

PËRMBLEDHJE LËNDËSH TË PËRZGJEDHURA NGA PRAKTIKA GJYQËSORE LIDHUR ME ARMËT E ZJARRIT

**E DREJTA PENALE
DHE PRAKTIKA
GJYQËSORE NË KOSOVË**

Heqje përgjegjësie

Emërtimet e përdorura dhe mënyra e paraqitjes së përmbajtjes së këtij dokumenti nuk nënkuptojnë shprehje të opinionit nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin ligjor të asnjë vendi, territori, shteti ose të autoriteteve të tyre, apo në lidhje me kufijtë e tyre të brendshëm ose të jashtëm. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë medoemos pikëpamjet e Kombeve të Bashkuara (KB), duke përfshirë Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC), apo të shteteve anëtare të KB-së.

Falënderime

Ky botim u përgatit nga Programi Global i Armëve të Zjarrit (GFP), Seksioni i Mbështetjes së Implementimit, Dega e Krimit të Organizuar dhe Trafikut të Paligjshëm, Shërbimi Kontraktues pranë UNODC-së, nën mbikëqyrjen e përgjithshme nga znj. Simonetta Grassi, udhëheqëse e GFP-së. Dokumenti u hartua nga autorët: z. Agim Maliqi dhe z. Afrim Shala, gjyqtarë të Gjykatës Supreme të Kosovës¹. Ky botim u përgatit falë mbështetjes financiare të ofruar nga: Gjermania, Suedia, Holanda, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Norvegjia, përmes Fondit Shumë-Partnerësh të Mirëbesimit për implementimin e Udhërrëfyesit për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (SALW) në Ballkanin Perëndimor dhe me mbështetjen e Bashkimit Evropian (BE). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i opinionit zyrtar të këtyre vendeve.



1 Referencat për Kosovën në këtë dokument kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Abstrakt

Në publikimin "Përmbledhje lëndësh të përzgjedhura nga praktika gjyqësore lidhur me armët e zjarrit" analizohen dhe trajtohen në mënyrë të hollësishme disa lëndë nga praktika gjyqësore në Kosovë gjatë periudhës 2020-2024, në lidhje me veprat penale të armëve, me theks të veçantë tek armët e zjarrit.

Analizimi dhe trajtimi i këtyre lëndëve është bërë me qasje sa më praktike, duke i evidentuar çështjet më tipike të veprave penale të armëve të zjarrit, ku mund të paraqiten vështirësi në interpretimin e nocioneve të caktuara, dhe duke synuar ofrimin e zgjidhjeve më adekuate në lidhje me këto aspekte.

Përmbajtja

1	Hyrje	7
2	Fjalë kyç dhe shkurtesa	9
3	Legjislacioni relevant lidhur me armët e zjarrit, veprat penale të armëve dhe kompetenca e gjykatave në Kosovë	12
4	Lëndë të përzgjedhura nga praktika gjyqësore në Kosovë	24
5	Të dhëna statistikore	76
6	Konkluzione	81

Hyrje

1

Kjo përmbledhje lëndësh të përzgjedhura nga praktika gjyqësore në Kosovë lidhur me armët e zjarrit është autorizuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin² në kuadër të Programit Global të Armëve të Zjarrit.³

Nga viti 2011, UNODC filloi të zbatojë Programin Global të Armëve të Zjarrit (GFP) për të ndihmuar shtetet anëtare në parandalimin e trafikut të paligjshëm ndërkombëtar të armëve të zjarrit, përmes ratifikimit dhe implementimit të Protokollit kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve,⁴ që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (UNTOC).⁵

Ndërsa, nga viti 2020, UNODC përmes Programit Global të Armëve të Zjarrit (GFP) u ofron mbështetje shteteve të Ballkanit Perëndimor, në lidhje me harmonizimin e legjislacionit të tyre me Protokollin e lartcekur të KB-së për armët e zjarrit, në rritjen e kapaciteteve të tyre institucionale për të parandaluar, zbuluar dhe ndaluar flukset e paligjshme të armëve të zjarrit, si dhe për të mbledhur dhe shkëmbyer të dhëna lidhur me armët e zjarrit.

Në funksion të arritjes së synimeve të lartcekura, është edhe mbështetja e dhënë për përgatitjen e përmbledhjeve të lëndëve të përzgjedhura nga praktika gjyqësore e shteteve të Ballkanit Perëndimor që pasqyrojnë lëndë të cilat kanë të bëjnë me posedimin e kundërligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të zjarrit.

Përndryshe, kjo përmbledhje lëndësh të përzgjedhura nga praktika gjyqësore në lidhje me armët e zjarrit është e ndarë në gjashtë (6) pjesë, me përmbajtjen si në vijim:

Pjesa hyrëse përbën pjesën e parë të kësaj përmbledhjeje, ndërsa në pjesën e dytë janë paraqitur fjalët kyç dhe shkurtesat që përdoren në këtë punim, me qëllim që lexuesit të kenë më të lehtë identifikimin dhe kuptimin përkatës.

Në pjesën e tretë është paraqitur dhe trajtuar legjislacioni i aplikueshëm lidhur me armët e zjarrit në Kosovë, ndërsa në vijim janë trajtuar veprat penale të armëve të zjarrit sipas Kodit

² <https://www.unodc.org/>

³ <https://www.unodc.org/unodc/en/firearms-protocol/>

⁴ <https://www.unodc.org/unodc/en/firearms-protocol/the-firearms-protocol.html>

⁵ https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsq_no=XVIII-12&chapter=18&clang=en

Penal të Kosovës⁶, si dhe kompetenca e gjykatave në trajtimin e lëndëve të tilla sipas Kodit të Procedurës Penale⁷ dhe Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, datë 23.11.2018.⁸

Në pjesën e katërt janë paraqitur dhe trajtuar njëzet e pesë (25) lëndë nga praktika gjyqësore në Kosovë që përfshin periudhën 2020-2024, ndërsa këto lëndë kanë të bëjnë me vepra penale që lidhen me armët e zjarrit, ndërsa disa lëndë edhe me narkotikët dhe krimin e organizuar.

Secila lëndë e përzgjedhur është shtjelluar sipas një metodologjie standarde, duke përfshirë aspektet vijuese:

1. Paraqitja e të dhënave themelore në lidhje aktgjykimet e trajtuara (gjykata, numri i lëndës dhe data e nxjerrjes së aktgjykimit);
2. Fjalët kyç në lëndën përkatëse;
3. Përmbledhja e shkurtër e lëndës;
4. Mënyra e vendosjes nga gjykata themelore kompetente, Gjykata e Apelit e Kosovës dhe Gjykata Supreme e Kosovës;
5. Pyetjet apo çështjet ligjore që kërkojnë përgjigje në lëndën përkatëse;
6. Gjetjet kryesore lidhur me pyetjet apo çështjet ligjore; dhe
7. Paraqitja e pjesëve kryesore të arsyetimit të aktgjykimit të nxjerrë nga gjykata kompetente në lidhje me gjetjet kryesore në lëndën përkatëse.

Në pjesën e pestë janë paraqitur të dhëna statistikore në lidhje me numrin e lëndëve që janë pranuar, përkatësisht aktakuzat e ngritura në lidhje me veprat penale të armëve të zjarrit, numrin e lëndëve të zgjidhura, numrin e lëndëve të mbetura, si dhe mënyrën e zgjidhjes së lëndës (aktgjykim fajësues, aktgjykim lirues, aktgjykim refuzues apo mënyrë tjetër).

Kurse pjesa e gjashtë dhe e fundit përfshin konkluzionet në lidhje me identifikimin e praktikave më të mira dhe sfidave në trajtimin e lëndëve që lidhen me armët e zjarrit.

Autorët:

Agim Maliqi dhe Afrim Shala

6 Kodi nr. 06/L-074 Kodi Penal i Kosovës, datë 23.11.2018 (në tekstin e mëtejshmë: KPK). KPK mund të gjendet këtu: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

7 Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, datë 14.07.2022 (në tekstin e mëtejshmë: KPP). KPP mund të gjendet këtu: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61759>

8 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

Fjalë kyç dhe shkurtesa

2

Fjalë kyç

Amnisti	Gëzhjojë
Armë	Granatë dore
Armë artizanale	Grup i organizuar kriminal
Armë me gaz	Gjurmim
Armë zjarri	Heqje e shenjave në armë zjarri
Armëmbajtje pa leje	Hetime financiare
Bashkëkryerje	Import
Bashkëpunëtor	I paraburgosur
Bashkëpunimi ndërkombëtar	Karikator
Blerje	Këmbim
Bombolë gazi	Kërcënim
Deaktivizim	Kompetencë e gjykatës
Detyrim	Konfiskim
Devijim	Kontrollim
Dënim me burgim	Konvertim
Dënim me gjobë	Korrupsion
Dënim plotësues	Krim i organizuar
Diabolë	Krim kibernetik
Doganë	Krim transnacional
Dorëzim	Legalizim i armës
Eksport	Legjislacion
Eksportues	Leje
Falsifikim	Lëndë (materie) plasëse
Falsifikim i shenjave në armë zjarri	Licencë
Figurë e veprës penale	Licencë e rreme
Fishekë	Marihuanë

Masa të fshehta vëzhgimi dhe hetimi	Prodhim ose montim i palicencuar ose i paautorizuar
Materie plasëse	Prodhues
Mbajtje e të dhënave	Pushkë ajrore
Mbrojtje e dëshmitarit	Pushkë gjahu
Mjet i rrezikshëm	Refuzim i akuzës
Mjet plasës	Riaktivizimi
Modifikim	Sanksione penale
Municion	Sekuestrim
Narkotikë	Statistika
Ndërmjetësim	Subjekt juridik
Ndihmë e ndërsjellë juridike	Substancë narkotike
Ndryshim i shenjave në armë zjarri	Substancë psikotrope
Njësi të Specializuara	Shenja të rreme
Numër serie	Shitje e paautorizuar
Operacion i fshehtë	Shkatërrim
Organ kompetent	Shkelje e ligjit penal
Paaautorizuar	Shkrepje
Parandalim	Terrorizëm
Paratë	Testim balistik
Pastrim i produkteve të veprës penale	Të dhëna
Përdorim i armës	Trafik i paligjshëm
Përdorim i paligjshëm	Trafikim i drogës
Përfitime personale	Transferim
Pikë kufitare	Transferim i personit të dënuar
Pistoletë	Transferim i procedurave penale
Pistoletë me gaz	Transferim ndërkombëtar i armëve të zjarrit
Pjesë të armëve të zjarrit	Transit
Pjesëmarrje në grup të organizuar kriminal	Tregtar
Policia	Vlefshmëri e lejes
Poligon	Zbulim
Posedim i paligjshëm	Zhdukje e paligjshme e shenjave në armë zjarri
Pranim i fajësisë	Zyrtar korrektues
Prodhim	
Prodhim i paligjshëm i armëve të zjarrit	

Shkurtesa

BE	Bashkimi Evropian
GFP	Programi Global i Armëve të Zjarrit
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KB	Kombet e Bashkuara
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KFOR	Prania ndërkombëtare e sigurisë e vendosur në territorin e Kosovës në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit e përbërë nga Organizata e Paktit të Veriatlantikut (NATO), duke përfshirë shtetet anëtare, organet ndihmëse, shtabet ushtarake dhe elementet ose njësitet kombëtare përkatëse, si dhe vendet kontribuuese që nuk janë anëtare në NATO.
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KPK	Kodi Penal i Kosovës
SALW	Fondi Shumë-Partnerësh i Mirëbesimit për implementimin e Udhërrëfyesit për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional

Legjislacioni relevant lidhur me armët e zjarrit, veprat penale të armëve dhe kompetenca e gjykatave në Kosovë

3.1. Legjislacioni relevant lidhur me armët e zjarrit në Kosovë

Bazuar në fuqinë juridike, karakteristikat dhe rëndësinë përkatëse, legjislacioni relevant lidhur me armët e zjarrit në Kosovë mund të klasifikohet në katër (4) grupe:

Dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare

Kodi Penal i Kosovës

Ligjet që rregullojnë armët e zjarrit

Aktet e ndryshme nën-ligjore

1. Dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare

Ka një sërë dokumentesh juridike ndërkombëtare të cilat rregullojnë çështje të ndryshme lidhur me armët e zjarrit, si në nivel të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ashtu edhe në kuadër të organizatave të ndryshme kontinentale dhe rajonale.

Në këtë drejtim, duhet të përmendet Rregullorja (BE) nr. 258/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14.03.2012,⁹ që implementon nenin 10 të Protokollit të Kombeve të

⁹ <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2012/258/oj>

Bashkuara kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit), dhe krijon autorizimin e eksportit, dhe masat e importit dhe kalimit transit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve.

Gjithashtu, është e rëndësishme të përmendet edhe Direktiva e Këshillit 91/477/KEE¹⁰ mbi kontrollin e marrjes dhe posedimit të armëve të zjarrit, e ndryshuar me Direktivën 2008/51/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21.05.2008. Më pastaj, duhet përmendur edhe Direktivën (EU) 2021/555 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24.03.2021, për kontrollin e blerjes dhe posedimit të armëve.¹¹

Ndërsa në nivel të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për sa i përket çështjes së armëve të zjarrit, dokument i rëndësishëm konsiderohet Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional,¹² e miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, nr. 55/25, datë 15.11.2000. Ky dokument paraqet instrumentin bazë me karakter ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar transnacional. Së bashku me Konventën u miratuan edhe tre (3) protokolle që lidhen me fusha të caktuara të krimit të organizuar transnacional, duke përfshirë Protokollin e Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve.¹³

2. Kodi Penal i Kosovës

KPK është njëri nga ligjet bazë përmes së cilit inkriminohen një sërë veprimesh që kanë të bëjnë me armët e zjarrit, por jo vetëm.

Në Kapitullin XXIX të KPK-së janë parashikuar veprat penale të armëve. Në këtë kapitull parashikohen disa vepra penale që lidhen me armët e zjarrit.

Në anën tjetër, është e rëndësishme të theksohet se në nenin 113 të KPK-së është përcaktuar se çfarë përbën armë në kuptimin juridiko - penal. Në këtë drejtim, në paragrafin 40 të këtij neni është parashikuar se termi **“Armë”** do të thotë çdo send ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave, të cilat lirohen gjatë djegies së materieve shpërthyes, elektrike, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, hedh predha në formë të një plumbi të vetëm, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që krijohet dhe përdoret për të shkakuar lëndime trupore ose dëm fizik, qoftë edhe psikologjik, si dhe secili

10 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/ALL/?uri=CELEX%3A31991L0477>

11 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021L0555>

12 https://treaties.un.org/pages/VieDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XVIII-12&chapter=18&clang=_en

13 https://treaties.un.org/doc/source/recenttexts/18-12_c_e.pdf

send tjetër, qëllimi kryesor i të cilit është kryerja e sulmit fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose ndaj pasurisë. Armë po ashtu përfshin municionin, pjesët dhe përbërësit e armëve, si dhe armët nukleare, biologjike dhe kimike.

Në vijim të këtij paragrafi janë përcaktuar disa lloje të armëve dhe atë: armët e zjarrit; armët e koleksionit; armët pneumatike (ajrore); armët që përdoren për shpërndarjen e gazit irritues; armët shpërthyes; armët me shigjeta; armët e ftohta; armët për sinjalizim akustik dhe të dritës; armët elektrohok dhe armët me rrymë.

Ndërsa më tej në këtë paragraf është përcaktuar gjithashtu se për qëllimet e Kodit Penal nuk konsiderohen armë: armët për qëllime industriale; armët dekorative; imitimi i armëve; armët e zjarrit të bëra të papërdorshme (të deaktivizuara) në mënyrë permanente me aplikimin e procedurave teknike që garantohen nga organi kompetent ose që njihen nga organi kompetent, si dhe fuzhnjat për peshkim nën ujë.

3. Ligjet që rregullojnë armët e zjarrit

Njëri nga ligjet më të rëndësishme në Kosovë që lidhet me armët e zjarrit është Ligji nr. 05/L-022 për armët, datë 23.07.2015.¹⁴ Me këtë Ligj rregullohen kushtet për blerjen, posedimin, armëmbajtjen, ruajtjen, prodhimin, çaktivizimin, riparimin, tregtimin, importimin, transitin, shitjen, transportimin dhe shenjat e armëve dhe municionit për personat fizikë dhe juridikë brenda territorit të Kosovës, si dhe eksportimin nga Kosova të armëve dhe municionit të destinuar për përdorim civil.¹⁵

Gjithashtu, ligje tjera të rëndësishme në këtë drejtim konsiderohen edhe: Ligji nr. 05/L-134 për legalizimin dhe dorëzimin e armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive, datë 31.03.2017¹⁶ dhe Ligji nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri, datë 28.10.2010.¹⁷

4. Aktet e ndryshme nën-ligjore

Shumë çështje që kanë të bëjnë me armët e zjarrit në Kosovë janë të rregulluara edhe me një sërë aktesh nën-ligjore në formën e udhëzimeve, rregulloreve të ndryshme, etj. Në këtë mënyrë, në uebsajtin e Ministrisë së Punëve të Brendshme gjenden disa udhëzime administrative dhe akte të tjera juridike me të cilat rregullohen çështje të ndryshme që ndërlidhen me armët e zjarrit.¹⁸

14 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11018>

15 Neni 1, paragrafi 1 i Ligjit nr. 05/L-022 për armët, datë 23.07.2015.

16 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14605>

17 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2737>

18 <https://mpb.rks-gov.net/f/35/Udhezime-administrative>

Udhëzime Administrative më të rëndësishme që kanë të bëjnë me armët e zjarrit mund të konsiderohen:

- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 25/2010 për gjurmimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre dhe municionit;
- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 26/2010 për shenjat e armëve të zjarrit, pjesëve dhe municionit të tyre;
- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 15/2010 për legalizimin e armëve të zjarrit që i takojnë kategorisë B, C dhe D1;
- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 08/2023 për objektet dhe procesin teknologjik të prodhimit të armëve, pjesëve të armëve dhe municionit;
- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 03/2016 për leje për lëvizje me armë;
- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 24/2010 për procedurat e trashëgimisë për armë dhe municion në rast të vdekjes së pronarit të armës së zjarrit;
- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 08/2016 për kushtet minimale teknike për ruajtjen e armës, pjesëve të armës dhe municionit, ndër të tjera.

3.2. Veprat penale të armëve

Si kapitull i rëndësishëm i KPK-së konsiderohet edhe Kapitulli XXIX, në të cilën janë parashikuar veprat penale të armëve.¹⁹ Në këtë kapitull të KPK-së janë parashikuar gjashtë (6) vepra penale që kanë të bëjnë me armët. Ky kapitull i veprave penale ka këto karakteristika:

- Veprat penale të këtij kapitulli janë të parashikuara me dispozita “blanketë” ngase për përcaktimin e tipareve të figurës së këtyre veprave penale duhet aplikuar edhe dispozita ligjore të tjera që rregullojnë çështje të caktuara nga fusha e armëve;
- Këto vepra penale bëjnë pjesë në grupin e veprave penale të ashtuquajtura “*delicta communia*”, pasi kryes i tyre mund të jetë çdo person;²⁰
- Këto vepra penale mund të kryhen vetëm me dashje;

¹⁹ Shala, Afrim, *Hyrje në të drejtën penale*, Botimi i katërt, Prishtinë, 2023, f. 28.

²⁰ Po aty, f. 54.

- Për shumicën e këtyre veprave penale është parashikuar në mënyrë të shprehur edhe konfiskimi i armëve, mjeteve për transportin e armëve, mjeteve për prodhimin e armëve dhe mjeteve të tjera përmes të cilave është kryer vepra penale përkatëse;
- Në kuadër të këtij kapitulli gjenden edhe disa dispozita ligjore me karakter shpjegues, pasi me to shtjellohet domethënia e shprehjeve që janë përdorur në kuadër të elementeve përkatëse të figurës së veprës penale;²¹
- Për shkak të natyrës së tyre, për shumicën e këtyre veprave penale është parashikuar edhe dënimi me gjobë, në mënyrë kumulative ose si alternativë ndaj dënimit me burgim;
- Për dallim nga pjesa dërmuese e veprave penale të kapitujve tjerë të KPK-së, për shumicën e veprave penale të këtij kapitulli, është përcaktuar edhe maksimumi i posaçëm i dënimit me gjobë;
- Për shumicën e veprave penale të këtij kapitulli janë të parashikuara edhe format e cilësuar apo të rënda të veprave penale, etj.

VEPRAT PENALE NË KUADËR TË KËTIJ KAPITULLI JANË:

1. Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paaautorizuar e armëve apo materieve plasëse (neni 364 i KPK-së)

1. Kushdo që në kundërshtim të ligjit të zbatueshëm në lidhje me armët apo materiet plasëse, importon, eksporton, blen, furnizon, transporton, prodhon, këmben, ndërmjetëson ose shet armë apo materie plasëse, dënohet me gjobë deri në shtatë mijepesëqind (7.500) euro dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë, më shumë se katër (4) materie plasëse apo më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

21 Shala, Afrim, *Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore*, Gjilan, 2010, f. 31.

3. Për qëllime të këtij neni, shprehja “prodhim” i armëve përfshin shndërrimin apo modifikimin e ndonjë sendi në armë ose të një arme në një lloj tjetër të armës, apo deaktivizimin ose riaktivizimin e ndonjë arme.
4. Armët, mjetet për transportimin e armëve dhe mjetet për prodhimin e armëve konfiskohen.

Sipas paragrafit 1 të nenit 364 të KPK-së, veprimet kryese të kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe përbëhen nga: importimi, eksportimi, blerja, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e armëve apo lëndëve plasëse.

Për të ekzistuar kjo formë e veprës penale duhet që veprimet kryese të ndërmerren në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm lidhur me armët apo lëndët plasëse, ndërsa për këtë formë të veprës penale është parashikuar dënim me gjobë deri në shtatë mijepesëqind (7.500) euro dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë, më shumë se katër (4) lëndë plasëse apo më shumë se katërqind (400) fishekë, dhe për të cilën është parashikuar dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Paragrafi 3 i nenit të lartcekur është dispozitë ligjore me karakter shpjegues, pasi për qëllime të këtij neni aty shpjegohet se shprehja “prodhim” i armëve do të thotë shndërrimi apo modifikimi i një sendi në armë ose i një arme në një lloj tjetër të armës, apo deaktivizimi ose riaktivizimi i armës.

Kurse në paragrafin 4 të nenit të lartcekur është parashikuar edhe konfiskimi i detyrueshëm i armëve, mjeteve për transportimin e armëve dhe mjeteve për prodhimin e armëve.

2. Fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë të zjarrit apo në municion (neni 365 i KPK-së)

1. Kushdo që fshin, heq apo ndryshon shenjat në armë të zjarrit apo municion ose kushdo që e shënjon një armë të zjarrit apo municion me shenja të rrejshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që prodhon armën e zjarrit apo municionin dhe nuk e shënjon armën e zjarrit apo municionin në kohën e prodhimit sipas ligjit të zbatueshëm lidhur me shënjimin e armëve, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
4. Për qëllime të këtij neni, shprehja “shenjë” do të thotë një shenjë identifikuese e cila vendoset në armën e zjarrit apo në municion nga prodhuesi ose nga organi kompetent shtetëror.
5. Arma e zjarrit apo municioni konfiskohen. Mjeti i cili përdoret për fshirjen, heqjen apo ndryshimin e shenjës apo për shënjimin e rrejshëm konfiskohet.

Sipas paragrafit 1 të nenit 365 të KPK-së, veprimet kryese të kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe përbëhen nga: fshirja, heqja apo ndryshimi i shenjave në armë të zjarrit apo municion ose vendosja e shenjave të rreme në armë zjarri apo municion. Për këtë formë të veprës penale është parashikuar dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni dhe konsiderohet se kryhet në rastet kur personi prodhon armën e zjarrit apo municionin dhe nuk vendos shenjat identifikuese në armën e zjarrit apo në municion në kohën e prodhimit sipas ligjit të aplikueshëm lidhur me shenjat e armëve. Për këtë formë të cilësuar të veprës penale është parashikuar dënim me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Ndërsa formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni. Kjo formë më e rëndë konsiderohet se kryhet në rastet kur veprat penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni përfshijnë më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë. Për këtë formë të cilësuar është parashikuar dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Paragrafi 4 i nenit të lartcekur është dispozitë ligjore me karakter shpjegues, pasi për qëllime të këtij neni aty shpjegohet se shprehja “shenjë” do të thotë shenjë identifikuese që vendoset në armën e zjarrit apo në municion nga prodhuesi ose nga organi kompetent shtetëror.

Kurse në paragrafin 5 të nenit të lartcekur është parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i armës së zjarrit, municionit, si dhe mjetit me të cilën është kryer vepra penale.

3. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve (neni 366 i KPK-së)

1. Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijepesëqind (7.500) euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.

Veprimet kryese të formës themelore të kësaj vepre penale përbëhen nga mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të armëve në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm lidhur me armët e tilla. Për këtë formë të veprës penale është parashikuar dënim me gjobë deri në shtatë mijesëqind (7.500) euro ose dënim me burgim deri në pesë (5) vjet.

Forma e cilësuar e kësaj vepre penale e parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni konsiderohet se është kryer në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, ndërsa për këtë formë të veprës penale është parashikuar dënim me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

Në paragrafin 3 të nenit të lartcekur është parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i armës.

4. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm (neni 367 i KPK-së)

1. Kushdo që përdor armë apo materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
2. Kushdo që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetë mijë (10.000) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Arma apo mjeti i rrezikshëm i përdorur në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.

Sipas paragrafit 1 të nenit 367 të KPK-së, veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale përbëhet nga përdorimi i armës ose lëndës plasëse në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm lidhur me armët apo lëndët plasëse të tilla. Për këtë formë të veprës penale është parashikuar dënim me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Forma e cilësuar e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni dhe vjen në shprehje në rastet kur personi përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, ndërsa për këtë formë të cilësuar është parashikuar dënim me gjobë deri në dhjetë mijë (10.000) euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Në paragrafin 3 të nenit të lartcekur është parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i armës apo mjetit të rrezikshëm.

5. Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave të rreme (neni 368 i KPK-së)

1. Kushdo që jep informata të rreme, qoftë gojarisht apo me shkrim, në cilëndo fazë të procedurës së aplikimit për leje, pëlqim apo licencë të mbajtjes së armës apo mjetit plasës, dënohet me gjobë deri në pesëmijë (5.000) euro ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që prodhon, posedon, shet ose blen leje, pëlqim apo licencë të rreme të mbajtjes së armës apo mjetit plasës, dënohet me gjobë deri në pesëmijë (5.000) euro ose me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo që mban lejen, licencën apo ndonjë autorizim tjetër për mbajtjen e armëve apo mjeteve plasëse dhe nuk ia tregon menjëherë lejen, licencën apo autorizimin tjetër policisë apo KFOR-it sipas kërkesës së tyre, dënohet me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) euro ose me burgim deri në tre (3) muaj. Nëse kryesi nuk e ka lejen apo licencën në posedim në kohën e kërkesës dhe ai nuk njofton policinë apo KFOR-in për vendndodhjen e lejes, licencës apo autorizimit tjetër, kryesi dënohet me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) euro ose me burgim deri në tre (3) muaj.
4. Leja, licenca apo autorizimi tjetër i rremë konfiskohet. Mjetet për prodhimin e lejes, licencës apo autorizimit tjetër të rremë konfiskohen.

Siç shihet edhe nga neni 368 i KPK-së, kjo vepër penale ka të bëjë me dhënien e informacioneve të rreme lidhur me lejet, pëlqimet dhe licencat e armëve, ndërsa në vete përmban formën themelore dhe dy (2) format e rënda apo të cilësuar.

Gjithashtu, edhe te kjo vepër penale është parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i lejes, licencës apo autorizimit të rremë, si dhe mjeteve për prodhimin e tyre.

6. Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale (neni 369 i KPK-së)

1. Kushdo që prodhon, siguron ose i mundëson personit tjetër që të sigurojë armë apo helme ose pajisje tjera të nevojshme për prodhimin e tyre, për të cilat e di se janë të destinuara për përdorimin ose kryerjen e veprës penale, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Kushdo që prodhon, siguron ose i mundëson personit tjetër që të sigurojë çelës të falsifikuar, kallauz ose pajisje tjera për përdorim në plaçkitje, për të cilat e di se janë të destinuara për përdorimin ose kryerjen e veprës penale, dënohet me burgim deri në një (1) vit.

Kjo vepër penale përmban dy (2) forma të kryerjes dhe atë: formën themelore që është parashikuar në paragrafin 1 dhe formën e lehtë që është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni.

Veprimet kryese të formës themelore të kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe përbëhen nga prodhimi, sigurimi ose mundësimi i personit tjetër që të sigurojë armë apo helme ose pajisje tjera të nevojshme për prodhimin e tyre, për të cilat e di se janë të destinuara për përdorimin ose kryerjen e veprës penale. Për këtë formë të veprës penale është parashikuar dënim me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.

Kurse formën e lehtë të kësaj vepre penale e kryen personi që prodhon, siguron ose i mundëson personit tjetër që të sigurojë çelës të falsifikuar, kallauz ose pajisje tjera për përdorim në grabitje, për të cilat e di se janë të destinuara për përdorimin ose kryerjen e veprës penale. Për këtë formë të veprës penale është parashikuar dënim me burgim deri në një (1) vit.

3.3. Kompetenca e gjykatave

Kompetenca e gjykatave në Kosovë për gjykimin e çështjeve penale janë të përcaktuara me dispozitat e KPP-së dhe me dispozitat e Ligjit për gjykatat.

Duke u bazuar në nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për gjykatat, me qëllim të ndarjes së çështjeve sipas natyrës së tyre, në kuadër të gjykatave themelore veprojnë këto departamente:

1. Departamenti Special
2. Departamenti për Çështje Administrative
3. Departamenti për Krime të Rënda
4. Departamenti i Përgjithshëm, dhe
5. Departamenti për të Mitur

Në anën tjetër, në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm, në secilën gjykatë themelore dhe degë të saj veprojnë:

1. Divizioni Civil

2. Divizioni Penal, dhe

3. Divizioni për Kundërvajtje

Në nenin 19, paragrafi 1 të Ligjit për gjykatat është parashikuar se “Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore i gjykon veprat penale të dënueshme mbi dhjetë (10) vite, si dhe veprat penale që konsiderohen krime të rënda sipas Kodit Penal apo Kodit të Procedurës Penale”, kurse në nenin 20, paragrafi 1 të këtij Ligji është parashikuar se “Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet, përveç nëse kjo është në kompetencën e një Departamenti tjetër të Gjykatës Themelore”.

Në anën tjetër, në nenin 22, paragrafi 1 të KPP-së janë renditur veprat penale të cilat konsiderohen **“krime të rënda”**, mirëpo në këtë listë të veprave penale nuk është e përfshirë asnjë vepër penale e armëve dhe gjithashtu këto nuk janë përcaktuar si të tilla as me dispozitat ligjore të KPK-së.

Andaj, në bazë kësaj që u theksua më lart, mund të konstatojmë se veprat penale të armëve nuk konsiderohen “krime të rënda” në kuptim të dispozitave ligjore të lartcekura.

Duke marrë parasysh këtë aspekt dhe duke marrë për bazë faktin se për asnjërën prej tyre nuk është parashikuar dënim me burgim mbi dhjetë (10) vjet, mund të konstatojmë se për gjykimin e lëndëve të tilla në shkallë të parë është kompetent **“Divizioni Penal”** në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm pranë gjykatave themelore dhe degëve të tyre.

Nëse si kryes të veprave penale të armëve paraqiten të miturit, atëherë për gjykimin e lëndëve të tilla në shkallë të parë, kompetent është **“Departamenti për të Mitur”** që vepron në kuadër të shtatë (7) gjykatave themelore në Kosovë.

Në shumë raste nga praktika gjyqësore është vërejtur se veprat penale të armëve i kanë paraprirë kryerjes së ndonjë vepre penale tjetër që konsiderohet “krim i rëndë” (p.sh., “vrasja”, nga neni 172 i KPK-së; “vrasja e rëndë”, nga neni 173 i KPK-së, etj.); atëherë, në situata të tilla, nëse zbatohet procedurë e përbashkët, kompetent për gjykimin e këtyre lëndëve në shkallë të parë është **“Departamenti për Krime të Rënda”** pranë Gjykatave Themelore.

Ndërsa në rastet kur zbatohet procedurë e përbashkët për vepër penale që është në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSK), atëherë kompetent për gjykimin e lëndëve të tilla në shkallë të parë është **“Departamenti Special”** që vepron në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kompetenca për gjykimin e lëndëve të tilla trajtohet në mënyrë të njëjtë edhe në Gjykatën e Apelit të Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, ndërsa në Gjykatën Supreme të Kosovës, vepron vetëm Dega Penale. Së këndejmi, lëndët e veprave penale të armëve, pavarësisht nëse zhvillohet procedurë e ndarë apo e përbashkët, gjykohen nga **“kolegji i përbërë nga tre (3) gjyqtarë të Degës Penale”**.²²

22 Për dallim nga organizimi i brendshëm i gjykatave themelore dhe i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duhet të theksohet se kolegji i përbërë nga tre (3) gjyqtarë të Degës Penale pranë Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrton dhe gjykon të gjitha çështjet penale, duke përfshirë këtu çështjet penale të gjykuara nga Departamenti për Krime të Rënda, Departamenti për të Mitur, Departamenti Special dhe Divizioni Penal i Departamentit të Përgjithshëm pranë gjykatave të lartcekura. Shala, Afrim, *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, Përmbledhje nga praktika e Gjykatës Supreme në çështje penale dhe civile, Gjykata Supreme e Kosovës, Prishtinë, 2023, f. 7., në dispozicion këtu: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/76246_Permbledhje%20nga%20praktika%20e%20Gjykates%20Supreme,%20ne%20ceshtjet%20penale%20dhe%20civile%202023.pdf

Lëndë të përzgjedhura nga praktika gjyqësore në Kosovë

LËNDA NR. 1

1. **Aktgjykim nr.2022:031617, datë 08.08.2022, nga Gjykata Themelore në Ferizaj, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr. 523/2022, datë 30.09.2022.**
2. **FJALË KYÇ:** Armë, dënim me gjobë, fishekë, kontroll, mbajtje, polici, pushkë gjahu, vërejtje gjyqësore.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri N.Z., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj për veprën penale *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”* nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së, pasi nga data e papërcaktuar deri më 30.12.2021, rreth orës 10:20 minuta, në shtëpinë e tij në një fshat të Komunës së Ferizajt, i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm lidhur me armët në Kosovë, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim një revole të tipit *“Zastava”*, model jugosllav, dhe 20 copë fishekë të pushkës së gjahut, të cilat u gjetën dhe sekuestruan gjatë kontrollit të kryer nga policia.
4. **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,** me aktgjykimin nr. 2022:031617, datë 08.08.2022, të pandehurin N.Z., e ka shpallur fajtor për këtë veprë penale dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro, si dhe ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të armës së tipit *“Zastava”*, model jugosllav, dhe 20 copë fishekë të pushkës së gjahut.
5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,** me aktgjykimin PAKR nr. 523/2022, datë 30.09.2022, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Nëse veprimet e lartcekura të të pandehurit N.Z., përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të nevojshme për të formuar figurën e veprës penale *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”* nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së, pasi avokati mbrojtës kishte pretenduar se dënimi i të

pandehurit është jo i drejtë, meqë i pandehuri e ka telefonuar policinë, duke e njoftuar se posedon një armë dhe po ashtu 20 copë fishekë pushke gjahu që ia kishte lënë i ati i ndjerë, i cili kishte pak kohë që kishte vdekur nga momenti kur i pandehuri kishte njoftuar policinë. I pandehuri kishte vepruar kështu me qëllimin më të mirë, pasi në shtëpi e kishte të birin e moshës së mitur dhe kishte frikë se ai mund të gjente armën dhe të lëndohej. Këtë e kishte bërë duke besuar se po vepronte në mënyrën e duhur dhe duke u nisur nga praktika për të cilën kishte dëgjuar në Gjermani se, në raste të tilla, nëse kryen njoftimin nuk je subjekt i ndjekjes penale. Arma kishte qenë pronë e të atit dhe i pandehuri ishte vënë në dijeni për ekzistencën e armës pasi i kishte vdekur babai. Prandaj, duke pasur parasysh këto rrethana, kishte propozuar që të pandehurit t'i shqiptohet vërejtje gjyqësore.

7. GJETJET KRYESORE: Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar se veprimet e të pandehurit i japin formë të gjitha tipareve subjektive dhe objektive të veprës penale *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”* nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së, meqë i pandehuri në datën dhe kohën e përshkruar hollësisht në dispozitivin e aktgjykimit, ka poseduar armën e tipit *“Zastava”*, model jugosllav, dhe 20 copë fishekë të pushkës së gjahut, ndërsa gjykata e shkallës së dytë e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e mbrojtjes që ndaj të pandehurit të shqiptohet vërejtja gjyqësore, pasi arsyet e lartcekura nuk ishin vlerësuar të mjaftueshme për sanksion të tillë.

8. PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMEVE: Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë theksohet se: *“Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me ligj, andaj kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPP-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, pasi ka vlerësuar se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, paragrafi 1 të KPK-së, meqë i pandehuri me datë dhe kohë e përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ka poseduar armën e tipit Zastava model jugosllav dhe 20 copë fishekë të pushkës së gjuetisë”*. Kurse, në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, theksohet se: *“Gjykata e shkallës së parë me rastin e aktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ka vlerësuar të gjitha rrethanat, ku si rrethana lehtësuese mori parasysh faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, nuk ka të dhëna se i njëjti të jetë i gjykuar për ndonjë vepër të ngjashme apo tjetër penale, ndërsa si rrethanë rënduese është vlerësuar fakti se tek i pandehuri përveç armës – revoles, i janë gjetur edhe 20 fishekë të një arme tjetër. Kjo Gjykatë, gjen se janë të pabazuara pretendimet ankimore të mbrojtjes për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore. Kjo për faktin, se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, duke iu dhënë rëndësinë e duhur në proporcion me peshën e veprës penale. Ndërsa, në ankesë, rrethanave që u referohet mbrojtja nuk janë të tilla, që do të krijonin kushtet për shqiptimin e ndonjë dënimi tjetër, meqenëse në rasti konkret dënimi me gjobë është brenda kufijve që parasheh vepra penale, për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri [sic].”*

LËNDA NR. 2

1. **Aktgjykim PKR.nr.133/2022, datë 12.07.2023, nga Gjykata Themelore në Gjiilan, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr. 667/2023, datë 25.01.2024.**
2. **FJALËKYÇ:** Dënim me gjobë, diabolë, kontroll, municion, pikë kufitare, polici, pushkë ajrore.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri S.M., është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjiilan për veprën penale *"Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse"*, nga neni 364, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, pasi më 10.07.2022, rreth orës 20:00, në pikën kufitare *"Dheu i Bardhë"*, Komuna e Kamenicës, i pandehuri, në kundërshtim me Ligjin për armët, ka importuar në mënyrë të paautorizuar municion, të tipit diabolë. Ndërsa pjesëtarët e policisë po vepronin në zbatim të Planit Operativ *"Ngritja e Vigjilencës dhe Masave të Sigurisë"* në hyrje të Kosovës, në pikën kufitare të lartpërmendur, ndaluan autobusin e Kompanisë Turistike *"TTT"*, me tabela 05-000-AA, dhe gjatë kontrollit të valixheve të pandehurit, gjetën dhe sekuestruan sasi municioni, saktësisht 10 (dhjetë) pako x 250 copë, për pushkë ajrore. Këtë municion i pandehuri nuk e kishte deklaruar dhe nuk kishte dokumente për blerjen.
4. **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,** me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin S.M., e ka shpallur fajtor për këtë veprë penale dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë pesëqindpesëdhjetë (550) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje njëqindetëdhjetë (180) ditë. Ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale brenda periudhës së verifikimit prej 1 (një) viti. Gjithashtu gjykata ka urdhëruar konfiskimin e municionit të lartpërmendur.
5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,** me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet e rëndësishme në këtë lëndë që është ngritur nga mbrojtja ka të bëjë me pyetjen nëse të ashtuquajturat *'diabola'* konsiderohen armë zjarri në kuptimin e dispozitave të aplikueshme ligjore.
7. **GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e lartcekur ligjore, gjykatat kompetente si më sipër kanë arsyetuar se veprimet e të pandehurit S.M., i përbëjnë të gjitha elementet e figurës së veprës penale për të cilën ishte akuzuar, pasi *"diabolat"* konsiderohen armë në kuptimin e dispozitave të aplikueshme ligjore.
8. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SË APELIT TË KOSOVËS:** *"Për sa i përket pretendimit të mbrojtjes se me aktgjykimin e ankimuar është shkelur ligji penal, duke pretenduar se nëse analizohet neni 3, paragrafi 2 i Ligjit nr.05/L-022 për Armët, atëherë municioni i lartcekur, nuk bien në domenin e veprës penale, për arsye se të*

njëjtat nuk janë lëndë plasëse, por hyjnë në grupin për rekreacion apo armë ajrore, sipas vlerësimi të kolegjit të kësaj gjykate këto pretendimet ankimore janë të pabazuar, nga fakti se veprimet e të akuzuarit konsumojnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, se për këtë vepër penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarit.

*Kjo për faktin se, LIGJI Nr. 05/L -022 PËR ARMË, Gazeta Zyrtare e Kosovës / Nr. 25 / 19 gusht 2015, në neni 2, te përkufizimet, ka përcaktuar se çka konsiderohen sipas këtij ligji armë dhe municion e më saktësisht në nenin 2, par. 1, pika 1.41. përcakton qartazi se; "Municion përfshin - fishekët, **diabollat** dhe predhat e tjera së bashku me fitilat dhe mbushësit e tyre. Ndërsa në pikën 1.41.3. është parashikuar se **diabolla** është predhë jo sferike e paraparë për qitje nga armë pneumatike.", andaj, pretendimi ankimor se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, duke konsideruar, sipas mbrojtjes, se nuk bien në domenin e veprës penale, për arsye se të njëjtat nuk janë lëndë plasëse, por hyjnë në grupin për rekreacion apo armë ajrore është i pabazuar dhe në këtë drejtim edhe kolegji penal i kësaj gjykate pajtohet me përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari me veprimet e veta ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor dhe gjykuar si në dispozitiv të aktgjyqimit të ankimuar [sic]."*

LËNDA NR. 3

- 1. Aktgjykim P.nr.214/2023, datë 01.06.2023, nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1. nr. 929/2023, datë 05.10.2023.**
- 2. FJALË KYÇ:** Dënim me burgim, dënim me gjobë, eksport, fishekë, furnizim, import, municion.
- 3. PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri ZH.J., shtetas i Kosovës dhe i Serbisë, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë për veprën penale "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse", nga neni 364, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, pasi më 21.02.2023, rreth orës 13:30, në fshatin Joshanicë, Komuna e Leposaviqit, në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm në lidhje me armët apo lëndët plasëse (Ligji nr. 05/L-022 për armë), me dashje kishte importuar municion të armëve të zjarrit, nga territori i Serbisë në territorin e Kosovës. Njësia e Policisë së Kosovës - Njësia e Ndërhyrjes së Shpejtë e Drejtorisë Rajonale të Kufirit - Veri, në pikën e kontrollit në Joshanicë, kishte ndaluar veturën "Renault Scenic", ngjyrë hiri, me targa regjistrimi AA-111-11, me drejtues të pandehurin. Me rastin e kontrollit të veturës, saktësisht te syza përballë ulësës së pasagjerit kishin gjetur dy qese najloni, të cilat përmbanin municion të armëve të zjarrit. Pas kontrollit më të detajuar në parkingun e objektit të Drejtorisë Rajonale në Mitrovicë

- Jug, u gjetën edhe paketime të tjera me municion, gjithsej 6299 fishekë dhe atë: 4249 fishekë të kalibrit 7.62 TT; 2000 fishekë të kalibrit PPU 32 auto; 25 fishekë të kalibrit PPU 90 dhe 25 fishekë të kalibrit PPU 61, të cilat kishin qenë të fshehura nën ulëse, si dhe nën tapetin e dyshemesë së veturës.

4. **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, me aktgjykimin e lartcekur e ka shpallur fajtor të pandehurin ZH.J., për veprën penale që i ishte vënë në ngarkim me aktakuzë dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje një (1) vit e gjashtë (6) muaj dhe dënim me gjobë pesëqind (500) euro. Gjithashtu, është urdhëruar konfiskimi i përhershëm i fishekëve të lartcekur dhe i automjetit me të cilin është kryer kjo veprë penale.
5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, me aktgjykimin e lartcekur e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
6. **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, me aktgjykimin Pml.nr.52/2024, datë 13.02.2024, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të avokatit mbrojtës të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimeve të lartcekura të gjykatave të shkallëve më të ulëta.
7. **ÇËSHTJA LIGJORE**: Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, avokati mbrojtës i të pandehurit kishte pretenduar se dënimi i shqiptuar me burgim ishte tejte i lartë, ngase i pandehuri që nga fillimi i procedurës kishte pranuar kryerjen e veprës penale dhe në fazën e hetimeve kishte ofruar me shkrim lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjë që prokuroria nuk e kishte pranuar. Mbrojtja kishte pretenduar se, duke aplikuar dispozitat e nenit 72, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3., të KPK-së, gjykata është dashur t'i vlerësojë këto rrethana lehtësuese dhe të shqiptojë dënim nën kufirin e zbutjes së dënimit, nën minimumin ligjor. Gjithashtu, duhet theksuar se pretendimet e njëjta janë ngritur edhe gjatë procedurës së apelit kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të cilat pretendimet si të tilla janë refuzuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë.
8. **GJETJET KRYESORE**: Gjkata Supreme e Kosovës, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, i ka refuzuar si të pabazuara pretendimet e avokatit mbrojtës të të pandehurit. Këto pretendime janë vlerësuar se u referohen vetëm aspekteve të shqiptimit të dënimeve, ndërsa nuk ndërlidhen me shkeljet ligjore.
9. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS**: *"Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e mësipërme nuk janë të bazuara. Vlen të theksohet se mbrojtësi në kërkesë aktgjykimet i kundërshton për shkak të shkeljes së ligjit penal, por nga përmbajtja e kërkesës del se i kundërshton për shkak të vendimit për dënim. Konform dispozitës së nenit 432 të KPP ndaj vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet në rast të shkeljes së ligjit penal, në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par. 1 i këtij kodi ose në rast të shkeljeve tjera të procedurës penale*

kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Pra, bazuar në këtë dispozitë, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të vendimit për dënim.

Vendimi mbi dënimin mund të kundërshtohet me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në kuadër të shkeljes së ligjit penal, vetëm në rast se gjykatat me rastin e marrjes së vendimit për dënim, kanë tejkaluar kompetencat ligjore e që paraqet shkelje të ligjit penal (neni 385, par. 1, nënpar. 1.5. i KPP). Gjykata i tejkalon kompetencat ligjore kur shqipton dënimin i cili nuk mund të shqiptohet nën minimumin e veçantë ose mbi maksimumin apo shqipton lloj tjetër të dënimit i cili nuk mund të shqiptohet për atë vepër penale. Në rastin konkret, gjykata nuk i ka tejkaluar autorizimet e veta ligjore, ngase për veprën penale për të cilën është shpall fajtor i dënuari parashihet dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) viti e deri në dhjetë (10) vite, ndërsa, gjykata i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 €.

Është fakt se sipas dispozitës së nenit 72, par. 1, nënpar. 1.3. të KPK, në rastet kur masa më e ultë e dënimit nuk tejkalon periudhën prej dy viteve, dënimi mund të zbutet deri në gjashtë muaj, por kjo nuk nënkupton se gjykata duhet ta zbusë dënimin nën minimumin e paraparë ligjor, ngase konform dispozitës së nenit 71 të KPP është në diskrecion të gjykatës që ta zbusë dënimin nën kufirin e paraparë me ligj. Kurse, a është adekuat apo ne proporcion me peshën e veprës penale dënimi i shqiptuar në kuadër të kësaj dispozite ligjore nga gjykata e shkallës së parë është çështje që mund të kundërshtohet me ankesë në gjykatën e shkallës së dytë dhe gjykata e shkallës së dytë ka diskrecion që ta ndryshoj vendimin në këtë drejtim, por vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë sa i përket caktimit të dënimit - llojit dhe lartësisë së dënimit nuk mund të kundërshtohet me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, prandaj pretendimet në këtë drejtim, kjo gjykatë i konsideron si të pabazuara [sic].”

LËNDA NR. 4

- 1. Aktgjykim PKR.nr.206/2021, datë 25.05.2023, nga Gjykata Themelore në Gjilan, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr. 483/2023, datë 21.09.2023.**
- 2. FJALË KYÇ:** Fishekë, dënim me gjobë, leje, karikator, pistoletë.
- 3. PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri R.M., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjilan për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, të parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së, pasi më 21.09.2021, rreth orës 11:30, në rrugën “Adem Jashari”, në Gjilan, i akuzuari në kundërshtim me ligjin për armët, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar armën e vet, pistoletë e prodhimit “Tisas”, modeli “Zigana Sport”, kalibër 9 mm, dhe një karikator me pesë (5) fishekë, në atë mënyrë që pasi e ndalon dhe e parkon

automjetin e vet në trotuar dhe nga bagazhi i automjetit merr çantën e krahut në të cilën kishte pistoletën, të njëjtën e vendos në krah dhe shkon përballë kafeterisë “AAA” dhe pas fjalosjes me të dëmtuarin R.B., dhe shokun e tij I.M., i akuzuari e fut dorën në çantë për të nxjerrë pistoletën dhe në këtë moment i dëmtuari së bashku me shokun e tij I., reagojnë shpejt dhe me forcë ia marrin çantën me pistoletë. Më pas çantën e dorëzojnë në polici, ku pistoletë dhe fishekët sekuestrohen nga policia.

4. **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin R.M., e ka shpallur fajtor për këtë vepër penale dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë katërqind (400) euro, si dhe i ka konfiskuar pistoletën dhe pesë (5) fishekët.
5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, me aktgjykimin e lartcekur, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE**: Njëra nga çështjet e rëndësishme ligjore në këtë lëndë që u ngrit nga mbrojtja ka të bëjë me atë se, a konsiderohet vepër penale *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*, e parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së, në rastin kur personi posedon lejen për armë dhe me këtë armë lëviz në vende të ndryshme, mirëpo nuk siguron leje të veçantë për bartjen e armës apo lëvizjen me armë.
7. **GJETJET KRYESORE**: Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykatat kompetente kanë arsyetuar se veprimet e tilla konsiderohen vepër penale, andaj edhe pretendimet e mbrojtjes janë refuzuar si të pabazuara.
8. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SË APELIT TË KOSOVËS**: *“Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimmuar, ka paraqitur arsyet për të gjitha faktet vendimtare që kanë të bëjnë me veprën penale nga neni 366, paragrafi 1 të KPK-së dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit sa i përket kësaj vepre penale. Provat në këtë çështje penale janë vlerësuar në mënyrën e duhur, ashtu siç parashihet me nenin 360, paragrafi 1 të KPP-së, kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale, dhe po ashtu, edhe për mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e kësaj vepre penale, **për me tepër edhe vetë i akuzuari ka pranuar se armën në posedim e ka pasur me leje, mirëpo nuk ka pasur leje të veçantë për bartjen e armës**, e që në fakt sipas ligjit për armët, përveç sigurimit të lejes për poligon, i njëjti është dashur të marrë edhe leje të veçantë për lëvizje me armë, prandaj edhe për këtë vepër penale, gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkluzionet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë [sic].”*

LËNDA NR. 5

1. **Aktgjykim PKR.nr.35/2022, datë 08.04.2022, nga Gjykata Themelore në Gjiilan, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr. 289/2022, datë 10.06.2022.**
2. **FJALË KYÇ:** Armë me gaz, dënim me gjobë, kafeteri, muzikë live, vend i ngjarjes, zyrtarë policorë.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri B.V., shtetas i Kosovës, më 25.02.2022, rreth orës 21:45, në kafeterinë “AAA”, në një fshat të Komunës së Gjiilanit, kishte mbajtur në pronësi, pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm në lidhje me armët, armën e markës “Ekolfirat-Kompakt” (armë me gaz) e kalibrit 9 mm. Gjatë kontrollit të kafeterisë nga ana e zyrtarëve policorë u gjetën dhe u sekuestruan: arma me gaz; 29 gëzhoja të armës me gaz; në tualetin e kafeterisë u gjetën 4 gëzhoja të armës (Luger) 9 mm, ndërsa jashtë lokalit në tarracë u gjetën 2 gëzhoja të armës (Luger) 9 mm dhe 3 gëzhoja 7.62 mm. Nga provat e siguruar nga vendi i ngjarjes, ishte vërtetuar se i pandehuri B.V., në kundërshtim me ligjin në lidhje me armët kishte përdorur armën e lartcekur, duke gjuajtur disa herë në brendësi të kafeterisë gjatë një ahengu që kishte organizuar i pandehuri me rreth 50 persona dhe muzikë live.
4. **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin B.V., e ka shpallur fajtor për veprat penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së dhe “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367, paragrafi 1 i KPK-së.
5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, me aktgjykimin e lartcekur, e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë vetëm për sa i përket dënimit të shqiptuar, duke i shqiptuar të pandehurit B.V., dënim unik me gjobë njëmijepesëqind (1.500) euro, ndërsa në pjesët tjera, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet apo pyetjet e rëndësishme ligjore që është trajtuar në aktgjykimet e lartcekura ka të bëjë me faktin nëse arma e ashtuquajtur “armë me gaz” konsiderohet armë në kuptimin e dispozitave të aplikueshme ligjore.
7. **GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen apo pyetjen ligjore të ngritur më sipër, bazuar në aktgjykimet e lartcekura, rezultojnë se edhe arma e ashtuquajtur “armë me gaz” konsiderohet armë në kuptimin e dispozitave të aplikueshme ligjore, andaj edhe posedimi i saj pa autorizim dhe në kundërshtim me dispozitat e aplikueshme ligjore konsiderohet veprë penale e përcaktuar si “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 i KPK-së.
8. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS THEMELORE NË GJILAN:** “Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprat penale për të cilat akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 të KPP-së. Në këtë aspekt,

gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejt natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike. Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari B.V. i ka kryer veprat penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, paragrafi 1 të KPK-së dhe “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367, paragrafi 1 të KPK-së, si në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikat I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi [sic].”

LËNDA NR. 6

1. **Aktgjykim P.nr.295/2018, datë 03.09.2021, nga Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Malishevë, aktgjykim i formës së prerë.**
2. **FJALË KYÇ:** Armë, dënim me gjobë, leje e vlefshme, plumb, poligon, sekuestrim.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri H.M., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, për veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” të parashikuar me nenin 375, paragrafi 1 të KPK-së,²³ pasi në Malishevë, në shtëpinë e tij, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët apo materiet plasëse, pas pjesëmarrjes në një organizim nga Shoqata e Shenjëtarisë për gjuajtje me armë dhe me t’u kthyer nga poligoni i shenjëtarisë, i gëzuar për ahengun e syneit që do të organizonte i vëllai, nxjerr nga brezi armën e markës “Beretta”, për të cilën kishte leje të vlefshme dhe shtie nëntë (9) herë në ajër. Më pas arma u sekuestrua nga zyrtarët policorë të Stacionit Policor në Malishevë.
4. **GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË,** me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin H.M., e ka shpallur fajtor për këtë vepër penale dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje njëqindeshtatëdhjetë (170) ditë. Ky dënim, me pëlqimin e të pandehurit, është zëvendësuar në dënim me gjobë, në shumë prej tremijekatërqind (3.400) euro. Gjithashtu, është urdhëruar konfiskimi i armës së lartpërmendur.
5. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet e rëndësishme ligjore që është ngritur në praktikën tonë gjyqësore ka të bëjë me gjendjen faktike kur “personi posedon leje të vlefshme për mbajtjen e armës së zjarrit, mirëpo atë e përdor në kundërshtim me dispozitat e aplikueshme ligjore”. Atëherë, a konsiderohet se ka kryer dy (2) vepra penale si vijon: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, të parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së dhe “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” të parashikuar me nenin 367, paragrafi 1 të KPK-së apo vetëm këtë të fundit?

23 Kodi nr. 04/L-82 Kodi Penal i Kosovës, datë 20.04.2012.

- 6. GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e lartcekur, në praktikën tonë gjyqësore është përqafuar pikëpamja juridike se në këto raste kemi të bëjmë vetëm me veprën penale *“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”* të parashikuar me nenin 367, paragrafi 1 të KPK-së. E tillë është situata në rastin konkret, ku i pandehuri H.M., ishte akuzuar dhe shpallur fajtor vetëm për këtë veprë penale, pasi ai kishte pasur leje të vlefshme për mbajtjen e armës, mirëpo përdorimin e armës e kishte bërë në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore.
- 7. PJSË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS THEMELORE NË GJAKOVË**
- DEGA NË MALISHEVË: *“I pandehuri H.M., deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, të njëjtën e pranoi në mënyrë vullnetare dhe kërkoi nga gjykata që mundësisht ta dënnojë më burg dhe të njëjtin ta shndërrojë në dënim më gjorbë.... Gjykata ka aprovuar deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën, elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë [sic].”*

LËNDA NR. 7

- 1. Aktgjykim PKR.nr.23/2023, datë 22.02.2023, nga Gjykata Themelore në Gjiilan, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr. 180/2023, datë 24.11.2023.**
- 2. FJALË KYÇ:** Armë, dënim me kusht, konfiskim, leje e vlefshme, organ kompetent, përdorim, pistoletë.
- 3. PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri I.H., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjiilan, për veprën penale *“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”* nga neni 367, paragrafi 1 i KPK-së, pasi në ditën kritike kishte përdorur armën, pistoletë e tipit *“ZIG 14 Tisas Turkiye RKS 2020”*, për posedimin e së cilës kishte leje të vlefshme të lëshuar nga organet kompetente.
- 4. GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,** me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin I.H., e ka shpallur fajtor për kryerjen e kësaj veprë penale dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje tetë (8) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afat prej dy (2) vjetësh, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë veprë penale tjetër. Gjithashtu, është urdhëruar konfiskimi i armës, pistoletë e tipit *“ZIG 14 Tisas Turkiye RKS 2020”*.

5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit I.H., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet apo pyetjet ligjore të rëndësishme që në këtë rast është ngritur edhe nga avokati mbrojtës i të pandehurit ka të bëjë me çështjen e konfiskimit të armës së tipit pistoletë. Avokati mbrojtës e konsideron të padrejtë konfiskimin, pasi i pandehuri I.H., kishte pasur leje të vlefshme të lëshuar nga organet kompetente për posedimin e kësaj arme.
7. **GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e konfiskimit, në rastin konkret, por edhe në lëndë të tjera nga praktika jonë gjyqësore është përqafuar qëndrimi se arma duhet të konfiskohet, pavarësisht faktit se i pandehuri kishte pasur leje të vlefshme të lëshuar nga organet kompetente për posedimin e saj, pasi arma kishte qenë mjet për kryerjen e veprës penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367, paragrafi 1 i KPK-së. Në paragrafin 3 të këtij neni është parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i armës apo mjetit të rrezikshëm.
8. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SË APELIT TË KOSOVËS:** *“Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit I. H., aktgjykimi i ankimuar kundërshtohet edhe përkitazi me vendimin për konfiskim, me arsyetim se është e vërtetë se ditën kritike i pandehuri e ka përdorur armën, mirëpo, pasi në rastin konkret armën në fjalë e ka poseduar me leje të organeve kompetente, kërkon që arma në fjalë t’i kthehet të akuzuarit. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e cekura si më lartë nuk qëndrojnë, ngase, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 367, paragrafi 3 të KPK-së, të pandehuri i ka konfiskuar edhe armën, si mjet të kryerjes së veprës penale, ngase, me armën në fjalë, është kryer vepra penale e lartcekur, andaj edhe konfiskimi i armës është i obligueshëm dhe atë pavarësisht fakteve dhe rrethanave se a është poseduar leja apo jo nga organet kompetente për armën në fjalë, për çka, edhe kjo gjykatë ankesën e mbrojtësit të akuzuarit e refuzoi si të pabazuar [sic].”*

LËNDA NR. 8

1. Aktgjykim PKR.nr.156/2019, datë 11.01.2022, nga Gjykata Themelore në Gjilan, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr. 121/2022, datë 27.04.2022, aktgjykime këto, të ndryshuara nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin PML.nr.249/2022, datë 07.07.2022.
2. **FJALË KYÇ:** Armë zjarri, karikator, konfiskim, legalizim i armës, Ministria e Punëve të Brendshme, organ kompetent, pezullim, polici, shkelje e ligjit penal, vendim.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri D.S., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjilan, për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose

posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së, pasi, nga koha e papërcaktuar e deri më 15.09.2019, ka siguruar në mënyrë të paautorizuar armën e zjarrit, pistoletë të tipit “Zoraki”, model 914-B, kalibër 9 mm, dhe një (1) karikator. Arma është konfiskuar nga policia në datën e lartcekur.

4. **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin D.S., e ka shpallur fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë pesëqind (500) euro, si dhe ka urdhëruar konfiskimin e armës së lartcekur së bashku me karikator.
5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit D.S., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
6. **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, me aktgjykimin e lartcekur, e ka aprovuar si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit D.S., ndërsa i ka ndryshuar aktgjykimet e lartcekura të gjykatave të shkallëve më të ulëta, duke e refuzuar akuzën ndaj të pandehurit, lidhur me veprën penale për të cilën ishte shpallur fajtor.
7. **ÇËSHTJA LIGJORE**: Njëra nga çështjet apo pyetjet ligjore të rëndësishme që në këtë lëndë është ngritur edhe nga avokati mbrojtës i të pandehurit në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, kishte të bënte me faktin nëse vendimi i organeve kompetente, përkatësisht i Ministrisë së Punëve të Brendshme, mund të pezullojë zbatimin e ligjit penal, për sa i përket veprave penale të armëve.
8. **GJETJET KRYESORE**: Në lidhje me çështjen lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se në këtë rast është shkelur ligji penal në dëm të të pandehurit (të dënuarit), pasi ka ekzistuar një ndalesë e nxjerrë nga Ministria Punëve të Brendshme, me të cilën, për shkak të shpalljes së afatit për legalizimin e armëve, është pezulluar zbatimi i nenit 374 i KPK-së (ligjit që është aplikuar në atë kohë).
9. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS**: “Sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPK-së, për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, pretendimi kryesor në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ishte se me shpalljen e tij fajtor, në dëm të tij është shkelur ligji penal, sepse ka ekzistuar një ndalesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me të cilën për shkak të shpalljes së afatit për legalizimin e armëve, është pezulluar zbatimi i nenit 374 i KPK²⁴ (të ligjit i cili në atë kohë është aplikuar).

Gjykata Supreme e Kosovës, duke e vlerësuar këtë pretendim konstatoi se në shkresat e lëndës gjendet vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, nr.536/2018 i datës 23.11.2018, me të cilin është vendosur që të shpallet afati kohor për fillimin e procesit të legalizimit të

24 Kodi nr. 04/L-82 Penal i Kosovës, datë 20.04.2012.

armëve, në periudhën prej 17.12.2018 deri 17.06.2019 dhe gjatë këtij afati do të pezullohet zbatimi i nenit 374 i Kodit Penal të Kosovës, kurse më datën 25.06.2018 nga Ministria është vazhduar afati i legalizimit të armëve për tre (3) muaj deri më datën 17.09.2019.

Nga shkresat e lëndës rezulton se vepra penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor është kryer prej kohës së pacaktuar deri më datën 15.09.2019. Andaj, i dënuari pa autorizim e ka mbajtur armën para skadimit të afatit për legalizimin e tij, ndërsa në këtë periudhë, sipas vendimit të cekur më lartë, është pezulluar zbatimi i nenit 374 të KPK-së. Edhe pse në aktgjykimin e shkallës së dytë është theksuar se i dënuari armën e ka mbajtur pa autorizim një kohë të pacaktuar e deri në ditën e konfiskimit të armës (më datën 15.09.2019) që paraqet mbajtje pa leje të saj, gjegjësisht vepër penale, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me vendimin e Ministrit, është pezulluar zbatimi i ligjit, gjegjësisht dispozita për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, ashtu që nuk ka ekzistuar mundësia ligjore për shpalljen e të dënuarit fajtor për këtë vepër penale, pasi në rastin konkret kanë ekzistuar rrethanat që e kanë përjashtuar ndjekjen penale. Pasi me aktgjykimet e kundërshtuara është bërë shkelja e ligjit penal nga neni 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale,²⁵ andaj, edhe këto aktgjykim u ndryshuan, ashtu që u refuzua akuza, konform nenit 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të këtij Kodi [sic].”

LËNDA NR. 9

1. **Aktgjykim** PKR.nr.588/2021, datë 13.02.2023, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.147/2023, datë 25.04.2023.
2. **FJALË KYÇ:** Armë, dënim me burgim, dënim me gjobë, konfiskim, leje e vlefshme, përdorim, organ kompetent.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri SH.K., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, për veprat penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së dhe “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 367, paragrafi 1 i KPK-së, pasi kishte përdorur armën e tipit “Ekol Special”, të kalibrit 9mm, të cilën e kishte poseduar pa leje të vlefshme të lëshuar nga organet kompetente.
4. **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin SH.K., e ka shpallur fajtor për kryerjen e këtyre veprave penale dhe i ka shqiptuar dënime si në vijim: për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë katërqind

25 Kodi nr. 04/ L-123 i Procedurës Penale, datë 13.12.2012.

(400) euro, ndërsa për veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 367, paragrafi 1 i KPK-së, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje tre (3) muaj, si dhe ka urdhëruar konfiskimin e armës së lartcekur.

5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokates mbrojtëse të të pandehurit D.S., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE**: Njëra nga çështjet apo pyetjet ligjore që është ngritur nga avokatët mbrojtës të të pandehurve në disa raste nga praktika jonë gjyqësore ka të bëjë me faktin “nëse personi përdor armën të cilën e mban pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm të armëve”, atëherë, a konsiderohet se ka kryer vetëm një vepër penale apo dy vepra penale, siç është situata në rastin konkret.
7. **GJETJET KRYESORE**: Në lidhje me çështjen apo pyetjen e lartcekur, “nëse personi e përdor armën të cilën e mban pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm të armëve”, atëherë, varësisht nga rrethanat e rastit përkatës, konsiderohet se ka kryer dy (2) vepra penale dhe atë: veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 i KPK-së dhe veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 i KPK-së.
8. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SË APELIT TË KOSOVËS**: “Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPP-së, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe shkelje të ligjit penal, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare. Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtëses së të akuzuarit Sh.K., lidhur me vendimin për dënimin e shqiptuar dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe me shkelje të ligjit penal,²⁶ se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë...[sic].”

LËNDA NR. 10

1. Aktgjykim PKR.nr.11/2023, datë 03.04.2023, nga Gjykata Themelore në Gjilan, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr. 312/2023, datë 18.10.2023.

²⁶ Duke u bazuar në nenin 394, paragrafi 1 lidhur me nenin 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 të KPP-së, përveç pjesëve për të cilat është paraqitur ankesë, Gjykata e Apelit e Kosovës e shqyrton sipas detyrës zyrtare aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë edhe nëse është shkelur ligji penal në dëm të të pandehurit, në kontekst të verifikimit nëse “vepra për të cilën ndiqet i akuzuari nuk është vepër penale”.

- 2. FJALË KYÇ:** Dënim me gjobë, fishekë, gëzhjojë, kontroll, policia, sekuestrim.
- 3. PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri G.D., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjiilan, përveç veprave të tjera penale, edhe për veprën penale: *"Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve"* nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së, pasi me 10.12.2022, gjatë intervalit kohor 20:15-21:00, në Gjiilan, në banesën e tij, pa autorizim dhe pa leje të vlefshme, e në kundërshtim të ligjit të aplikueshëm për armët, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim: gjashtë (6) fishekë 9 mm; dy (2) fishekë 7.65 mm dhe një (1) gëzhjojë 7.65 mm. Pas kontrollit të ekzekutuar nga Policia e Kosovë këto janë gjetur dhe sekuestruar.
- 4. GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,** me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin G.D., e ka shpallur fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë katërqind (400) euro, si dhe ka urdhëruar konfiskimin e fishekëve dhe gëzhhojës.
- 5. GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,** me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit G.D., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, kurse aktgjykimet e gjykatave kompetente të shkallëve më të ulëta janë vërtetuar edhe nga **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, me aktgjykimin Pml. nr.607/2023, datë 30.11.2023.
- 6. ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet apo pyetjet ligjore që është ngritur nga mbrojtja në disa raste nga praktika jonë gjyqësore ka të bëjë me faktin *"nëse vetëm posedimi i paautorizuar dhe në kundërshtim me ligjin i fishekëve"* përbën veprën penale *"Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve"* nga neni 366 i KPK-së, apo duhet patjetër të ekzistojë edhe një armë, në kuptimin e armës së zjarrit, në rastin konkret, pistoletë.
- 7. GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen apo pyetjen e lartcekur, duke u bazuar në nenin 113, paragrafi 40 të KPK-së lidhur me nenin 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.41 të Ligjit nr. 05/L-022, datë 23.07.2015, në praktikën tonë gjyqësore është përqafuar qëndrimi juridik se vepër penale e përcaktuar si *"Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve"* nga neni 366 i KPK-së, konsiderohet edhe *"posedimi i paautorizuar dhe në kundërshtim me ligjin i fishekëve"*, pasi edhe fishekët konsiderohen armë, në kuptimin juridiko-penal.
- 8. PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS THEMELORE NË GJILAN:** *"Gjykata pasi analizoi të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha një nga një, si dhe ndërlidhur me njëra tjetrën, duke u bazuar në nenet 8 dhe 360 të KPP-së, konstatoi këtë gjendje faktike: Se ditën kritike ... policia kanë shkuar në vend të ngjarjes, kanë bërë fotografimin e vendit të ngjarjes, me ç'rast edhe kanë sekuestruar gjashtë (6) copë fishekë 9 mm, dy (2) copë fishekë 7.65 mm dhe një (1) gëzhjojë 7.65 mm ... dhe në këtë mënyrë ka kryer veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366, paragrafi 1 të KPK-së [sic]."*

LËNDA NR. 11

1. **Aktgjykimi PKR.nr.71/2021, datë 15.09.2021, nga Gjykata Themelore në Gjiilan, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.437/2021, datë 30.11.2021, si dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.39/2022, datë 14.02.2022.**
2. **FJALË KYÇ:** Armë, eksport, import, shitje e paautorizuar.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri R.D., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjiilan, për veprën penale *"Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse"*, të parashikuar me nenin 364 paragrafi 1 të KPK-së, pasi në fund të qershorit të vitit 2019, pa autorizim ka shitur armën e zjarrit, pushkën e gjahut të markës *"Canne Cromate"*, prodhim italian, kalibër 12 Ga, me 62 fishekë.
4. **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,** me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin R.D., e ka shpallur fajtor për këtë veprë penale dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje (1) vit e dy (2) muaj dhe dënim me gjobë dyqind (200) euro.
5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,** me aktgjykimin e lartcekur, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme në këtë lëndë që është ngritur nga mbrojtja ka të bëjë me atë se, a konsiderohet që është kryer kjo veprë penale në rastet kur bëhet fjalë vetëm për një armë, meqë kjo veprë penale do të konsiderohej e kryer kur kemi të bëjmë me më shumë se një armë dhe kryhet si veprimtari e përsëritur tregtare apo në formë biznesi.
7. **GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykatat kompetente kanë arsyetuar se veprimet e tilla konsiderohen veprë penale, andaj edhe pretendimet e mbrojtjes janë refuzuar si të pabazuara.
8. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS:** Gjykata Supreme e Kosovës duke shqyrtuar pretendimet e paraqitura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka konstatuar faktin se gjykatat e dy instancave gjyqësore në arsyetimin e aktgjykimit të tyre kanë paraqitur arsyet për të gjitha faktet vendimtare që kanë të bëjnë me veprën penale nga neni 364, paragrafi 1 i KPK-së dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit për sa i përket kësaj veprë penale. *"[M]irëpo sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi në fjalë nuk ishte i bazuar, meqë, neni 364 i KPK-së është i përbërë nga katër paragrafë, kurse në paragrafin e parë është përcaktuar forma themelore e kësaj veprë penale, me ç'rast inkriminon ndër të tjera edhe veprimin e shitjes së armëve, kurse me paragrafin e dytë është paraparë forma kualifikuese e saj në të cilën inkriminohen veprimet ku përfshihet sasi më e madhe e armëve. Nga kjo rrjedh se gjykata e shkallës së*

dytë me të drejtë ka konstatuar se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar elementet e veprës penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo mjeteve plasëse” nga neni 364, paragrafi 1 të KPK-së. Ndonëse dispozita ligjore përfshin disa mënyra të veprimit, për t’u konsumuar vepra penale, megjithatë veprimet e të dënuarit janë përshkruar dhe konkretizuar në dispozitivin e aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë, ku është theksuar fakti se i njëjti kishte bërë shitjen e armës së gjuetisë dhe për të cilin veprim ishte shpallur fajtor dhe ishte gjykuar, ashtu që nga kjo rrjedh se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal [sic].”

LËNDA NR. 12

1. **Aktgjykim** PKR.nr.111/2022, datë 12.10.2022, nga Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr. 601/2022, datë 06.12.2022, si dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.28/2022, datë 06.02.2022.
2. **FJALË KYÇ:** Armë, dënim me gjobë, posedim, vlefshmëri e lejes.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri P.B., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, të parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së, pasi nga 31.07.2018 gjer më 22.12.2020, rreth orës 15:00, në Gjakovë në Rr. “UÇK”, pa autorizim ka mbajtur në pronësi dhe posedim armë dhe municion, në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të Ligjit të Kosovës për armët, që me ligj kategorizohen si armë zjarri të ndaluara. Arma në rastin konkret ishte 1 (një) armë “Sig Sauer P22 Elite”. Në datën e lartcekur, i pandehuri ishte paraqitur në Stacionin Policor në Gjakovë dhe i kishte njoftuar se për armën në fjalë i kishte skaduar leja më 30.07.2018, pra rreth 2 (dy) vjet e gjysmë më parë, dhe se nuk kishte bërë kërkesë për vazhdimin e lejes. Andaj, në mungesë të lejes së vlefshme arma dhe karikatori u sekuestruan nga zyrtarët policorë.
4. **GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,** me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin R.M., e ka shpallur fajtor për këtë vepër penale dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë gjashtëqind (600) euro, si dhe ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të revoles së tipit “SIG-Sauer P-22 Elite”.
5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,** me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme në këtë lëndë që është ngritur nga mbrojtja ka të bëjë me atë se, a konsiderohet vepër penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, e parashikuar me nenin 366, paragrafi 1

të KPK-së, në rastet kur personi ka poseduar leje për armë, mirëpo ajo leje ka skaduar dhe poseduesi nuk ka bërë kërkesë për vazhdimin e lejes për armën e tij.

7. **GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykatat kompetente kanë arsyetuar se veprimet e tilla konsiderohen vepër penale dhe se fakti që i pandehuri nuk ka bërë kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë së lejes për armën e tij do të thotë se nuk ka poseduar leje fare, andaj edhe pretendimet e mbrojtjes janë refuzuar si të pabazuara.
8. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS:** *Duke shqyrtuar pretendimet konkrete të paraqitura në kërkesën e avokatit mbrojtës të të dënuarit, është vërtetuar fakti se i dënuari ka pasur leje të vlefshme për armë shenjëtarie për armën e markës "SIG Sauer" modeli "P220 Elite", nga 31.07.2013 deri më 30.07.2018. Mirëpo, nga dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe shkresat e lëndës del se nga 31.07.2018 deri më 22.12.2020 ka mbajtur armën pa autorizim, meqë kishte skaduar vlefshmëria e saj, dhe atë në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., i Ligjit nr. 05/L-022 për armët, përkatësisht se nga skadimi i lejes së armës bazuar në numrin e kartelës, del se nuk ka pasur leje të vlefshme për armë. Duke vlerësuar pretendimet përkitazi me shkeljen e ligjit penal, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore me të drejtë kanë konstatuar se në veprimet e të akuzuarit janë formësuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së. Dispozita e lartcekur e KPK-së është normë "blanketë" dhe i referohet Ligjit nr. 05/L-022 për armët, konkretisht dispozitës së nenit 37, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. duke përcaktuar se: "...leja e lëshuar revokohet në rast të skadimit të lejes kur e njëjta nuk është vazhduar...". Kështu që duke marrë parasysh dispozitën në fjalë del se i akuzuari që nga 30.07.2018, gjegjësisht data e skadimit të lejes, nuk ka poseduar leje të vlefshme për mbajtjen e armës, meqë vetë poseduesi i armës, në këtë rast i dënuari, ka detyrimin që me rastin e skadimit të afatit për lejen e armës të aplikojë për t'u pajisur me leje të re.*

LËNDA NR. 13

1. **Aktgjykim P.nr. 951/2022, datë 16.08.2021 nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1194/2021, datë 09.11.2021, si dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.105/2022, datë 16.03.2022.**
2. **FJALË KYÇ:** Armë, dënim me burgim, kërcënim, mjet i rrezikshëm, përdorim i armës, plumb, shkrepe.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri F.H., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, për veprën penale "Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm", të parashikuar me nenin 367, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së. Më 18.02.2021, në shtëpinë e tij në Prishtinë, ku i pandehuri banon me të dëmtuarin, të

atin SH.H., dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij, i pandehuri ndaj të dëmtuarit ka përdorur armën e tipit *"Ekol Special 99"*, në mënyrë kërcënuese. I pandehuri dhe i dëmtuari kishin pasur mosmarrëveshje që i kishin paraprirë mosmarrëveshjes në ditën kritike, kur i pandehuri kishte ushtruar dhunë në familje kundër të dëmtuarit SH.H. Pas fjalosjes, i pandehuri e merr revolen duke e drejtuar nga i të dëmtuari në mënyrë kërcënuese. Ndërkohë që e përgatit armën për gjuajtje dhe afrohet në drejtim të të dëmtuarit, i pandehuri rrëshqet në papuçet e të dëmtuarit dhe revolva shkrepet dhe qëllon kolltukun në dhomën e pritjes ku ishte edhe i dëmtuari.

4. **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin F.H., e ka shpallur fajtor për këtë veprë penale dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje tre (3) vjet e gjashtë (6) muaj dhe dënim me gjobë dymijë (2000) euro, si dhe ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të revoles së tipit *"Ekol Special 99"*.
5. **GJYKATA E AELIT E KOSOVËS**, me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE**: Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme në këtë lëndë që është ngritur nga mbrojtja ka të bëjë me atë se, kur konsiderohet se arma është përdorur në mënyrë kërcënuese, përkatësisht pretendohet se arma nuk është përdorur në mënyrë kërcënuese dhe kërkohet që vepra penale të ricilësohet sipas paragrafit 1 të nenit 367 të KPK-së, si dispozitë më e favorshme për të pandehurin.
7. **GJETJET KRYESORE**: Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykatat kompetente kanë arsyetuar se me veprimet e tilla të të pandehurit konsiderohet se është kryer vepra penale sipas nenit 367 paragrafi 2 të KPK-së, meqë arma është përdorur në mënyrë kërcënuese.
8. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS**: *Duke shqyrtuar pretendimet konkrete të paraqitura në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit është vërtetuar fakti se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale "Përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm" nga neni 367, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së. Meqë ishte konfirmuar fakti se i pandehuri F.H., kishte përdorur revolen e tij në mënyrë kërcënuese pas një mosmarrëveshjeje me tani të dëmtuarin SH.H., dhe se kishte shkrepet një plumb, gjë që nuk kontestohet as nga vetë i pandehuri dhe është vërtetuar edhe përmes provave të administruara nga ana e dy gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për t'u realizuar elementet e veprës penale për të cilën i pandehuri ishte shpallur fajtor dhe i ishte shqiptuar dënim, përkatësisht nga dispozita e nenit 367, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, është e nevojshme të plotësohen në mënyrë kumulative të dy (2) elementet përbërëse të saj. Së pari, të përdoret përkatësisht të shkrepet revolva, i cili element nuk ishte kontestues pasi nga arma e tipit *"Ekol Special 99"* ishte shkrepet një plumb. Së dyti, përdorimi i armës duhet të realizohet në mënyrë kërcënuese, i cili element rrjedh se është realizuar nga mosmarrëveshjet e krijuara në raportin mes të pandehurit dhe*

të dëmtuarit. Andaj me realizimin në mënyrë kumulative të këtyre dy elementeve plotësisht realizohet vepra penale dhe në këtë kontekst nuk kërkohet ndonjë pasojë eventuale.

LËNDA NR. 14

1. **Aktgjykim** PKR.nr.69/2022, datë 17.06.2022, nga Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.413/2022, datë 08.09.2022, aktgjykime këto, të ndryshuara nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.471/2022, datë 12.12.2022.
2. **FJALË KYÇ:** Armë, dënim me gjobë, dënim plotësues, konfiskim i armës, përdorim i armës.
3. **PËRMbledhje e Lëndës:** I pandehuri G.H, shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Pejë, për veprat penale *"Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve"*, të parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së dhe *"Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm"*, të parashikuar me nenin 367, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, pasi më 13.03.2022, rreth orës 14:00, në fshatin Qungur, Komuna e Pejës, me qëllim të kërcënimit përdor armën automatike AK-47, ndaj të dëmtuarve M.H., dhe M.H. Në ditën kritike, si pasojë e një mosmarrëveshjeje të atëçastshme mes të pandehurit dhe të dëmtuarve, i pandehuri merr armën nga shtëpia e tij dhe del në ballkon duke ekspozuar armën në drejtim të të dëmtuarve, si dhe duke iu drejtuar me fjalët *"hajdeni se ja u q.. nënën"*, me ç'rast si pasojë e veprimeve të tij të dëmtuarve u shkakton frikë dhe ankth.
4. **GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin G.H., e ka shpallur fajtor për këto dy vepra penale dhe i ka shqiptuar dënim unik burgimi në kohëzgjatje nëntëdhjetë (90) ditë dhe dënim me gjobë pesëqind (500) euro, si dhe ka urdhëruar që të pandehurit t'i konfiskohen në mënyrë të përhershme një armë automatike AK-47, një pistoletë e prodhimit të panjohur dhe pa numër serie, një karikator, 39 fishekë të kalibrit 7.65 mm dhe 6 fishekë të kalibrit 9 mm.
5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtës të të pandehurit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme në këtë lëndë që është ngritur nga mbrojtja ka të bëjë me atë se, a konsiderohet se është kryer vepra penale *"Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm"*, e parashikuar me nenin 367, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, në rastet kur personi vetëm e ka ekspozuar armën gjatë një mosmarrëveshjeje, por nuk ka shkrepur armën.
7. **GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykatat kompetente kanë arsyetuar se veprimet e tilla konsiderohen vepër penale dhe se fakti që i pandehuri nuk ka shkrepur armën, por vetëm ka bërë ekspozimin e armës gjatë mosmarrëveshjes përbën

tiparet e veprës penale të përdorimit të armës, mirëpo me këto konstatime nuk është pajtuar Gjykata Supreme e Kosovës.

- 8. PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS:** Për dallim nga dy gjykatat e instancave më të ulëta gjyqësore, Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin e dhënë ka aprovuar si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës i të dënuarit. Pra, Gjykata Supreme e Kosovës ka ndryshuar aktgjykimet e kundërshtuara dhe ka liruar nga akuza të pandehurin për veprën penale *“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”*, të parashikuar me nenin 367, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, meqë ka konstatuar se ligji penal është shkelur në dëm të të pandehurit kur i njëjti ishte shpallur fajtor dhe i ishte shqiptuar dënimi përkatës. Në aktgjykim thuhet *“[N]ga shkresat e lëndës del se në rastin konkret i dënuari nuk ka përdorur armën e tipit AK-47, por të njëjtën vetëm e ka marrë duke e ekspozuar nga ballkoni i shtëpisë së tij dhe u është drejtuar të dëmtuarve me fjalët “hajdeni se ja u q.. nënën”. Andaj, sipas përshkrimit të lartcekur dhe vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin konkret dispozita e nenit 367, paragrafi 2 e KPK-së, inkriminon rastet e përdorimit të armës në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, kurse i pandehuri nuk ka shkrepur fare me armën e tij dhe përdorimi i armës sipas konsiderohet vetëm shkrepja me armë me qëllim të kërcënimit ose frikësimit, për më tepër, intenca e ligjvënësit është inkriminimi i shkrepjes së armës dhe jo ekspozimi i saj, andaj pjesa e kërkesës e paraqitur për këtë bazë është aprovuar si e bazuar [sic].”* Së këndejmi, zgjidhja e lëndës ka rezultuar me lirim të pandehurit nga akuza për këtë vepër penale.



LËNDA NR. 15

1. Aktgjykim PS.nr.5/2020, datë 15.12.2022, nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, dhe aktgjykimi APS.nr.17/2023, datë 15.12.2022 nga Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti Special.
2. **FJALË KYÇ:** Armë, dënim me burgim, import, krim i organizuar, posedim.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** Të pandehurit A.F., P. F., A. F., P. F., D. F., XH. S., dhe K.S., shtetas të Kosovës, janë akuzuar nga Prokuroria Speciale e Kosovës, për veprën penale *“Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”* nga neni 277, paragrafi 1 të KPK-së lidhur me veprën penale *“Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”* nga neni 364, paragrafi 2 i KPK-së, pasi duke vepruar në bashkëkryerje, me dashje të drejtpërdrejtë, me marrëveshje reciproke, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, në shkelje të ligjit të aplikueshëm për armët (Ligji nr. 05/L-022), në mënyrë të paautorizuar kanë importuar [nga Maqedonia e Veriut], furnizuar, transportuar, prodhuar, ndërmjetësuar ose shitur armë dhe fishekë në sasi të mëdha dhe atë:

1.1. gjatë periudhës 01.07.2013 deri 23.11.2013 kanë kryer veprimet si më poshtë:

- më 21.09.2013, i akuzuari A.F., pas marrëveshjes me telefon me të pandehurin M. B., bashkë me djalin e axhës të akuzuarin D.F., me veturën *"Golf 5"*, me targa regjistrimi 01-111-OO, kanë shkuar në Maqedoninë e Veriut dhe kanë blerë 153 pistoleta të tipit *"Ekol Special"*, *"Ekol Tuna"* dhe *"Ekol Jackal Dual"* dhe 1500 fishekë të kalibrit 8 mm dhe 9 mm, për t'i importuar në Kosovë. Pastaj në anën maqedonase të njëjtat armë i janë dorëzuar të akuzuarit XH.S., i cili duke përdorur si mjet transporti kalin e tij ka transportuar atë ngarkesë duke e kaluar kufirin në rrugë ilegale, ku gjatë gjithë kohës ishte në kontakt me të pandehurin M.B. Pasi të akuzuarit A.F., dhe D.F., kanë kaluar në territorin e Kosovës, armët përsëri i janë dorëzuar të njëjtëve në afërsi të restorantit "XXX" në Elez Han. Pastaj i akuzuari A.F., përmes telefonit në ora 21:35 ka kërkuar nga vëllezërit e tij, të akuzuarit P, dhe P1, të shkojnë edhe ata në Elez Han me veturën tjetër *"Golf 2"*, me targa regjistrimi 01-111-YY. Duke iu përgjigjur thirrjes së të akuzuarit A., vëllezërit P, dhe P1 kanë shkuar në Elez Han dhe të gjithë janë takuar në parkingun e restorantit të lartshënuar dhe, pasi i kanë vendosur armët në veturën *"Golf 2"*, pas një kohe të shkurtër të akuzuarit D., P, dhe P1, janë nisur në drejtim të Prishtinës me veturën *"Golf 5"*, kurse i akuzuari A., i vetëm, tani me veturën *"Golf 2"* është nisur pas tyre. Mirëpo, në fshatin Llugaçji, Komuna e Lipjanit, është ndaluar nga zyrtarët policorë dhe gjatë kontrollit të dokumentacionit, i njëjti ka ikur nga vendi i ngjarjes duke lënë pas veturën. Në veturë janë gjetur 72 pistoleta të modeleve të lartshënuara dhe 30 kuti me nga 50 fishekë të kalibrave 8 mm dhe 9 mm,
- më 23.11.2013, në pronat e të akuzuarit A. F., dhe vëllezërve të tij, në lagjen *"Kodra e Trimave"* në Prishtinë, me rastin e kontrollit policor janë gjetur gjithsej 81 pistoleta të modeleve të lartshënuara dhe atë 17 pistoleta janë gjetur në objektin përcjellës, ndërsa 64 pistoleta në fuoristradën e llojit *"Suzuki"*, me targa 01-111-ZZZ, që ishte në shfrytëzim të të akuzuarve SH.H., dhe F. H. Këto armë dhe municione i kishin sjellë nga Maqedonia e Veriut në Kosovë pas kontakteve të drejtpërdrejta dhe telefonike me të akuzuarit A.F., dhe M. F. Kurse të akuzuarit A. F., dhe K. S., kanë realizuar detyra të caktuara nga të akuzuarit e lartshënuar lidhur me blerjen dhe shitjen e armëve personave të ndryshëm,

1.2. Të akuzuarit A. F., A.F., P.F., A. S., dhe M. SH., gjatë periudhës nga fillimi i vitit 2018 deri më 24.07.2019 në Ferizaj, Prishtinë dhe në vende të tjera në territorin e Kosovës, në mënyrë të paautorizuar kanë importuar armë dhe municion të kalibrave të ndryshme, ashtu që i pandehuri K.I., në rolin e furnizuesit nga Maqedonia e Veriut ka siguruar furnizimin me armë dhe municion për të akuzuarit A. F., dhe M. SH., të cilët kishin porositur armë (revole) me gaz nga i pandehuri K. I., i cili armët varësisht nga porosia i sillte kryesisht deri në kufirin e Kosovës, pastaj ndërmjetësuesi i tij, përkatësisht i akuzuari A.S., me veturën e tij të tipit *"Golf 4"* i transportonte armët te të akuzuarit A. F., në Prishtinë dhe M.SH., në Ferizaj sipas porosisë, ku më pas i akuzuari A. F., në bashkëpunim edhe me vëllezërit e të akuzuarit P, M., dhe A. F., në punëtorinë e tyre në Prishtinë kanë bërë modifikimin e armëve, nga armë me

gaz në armë të rregullta, të cilat më pas ua shitnin të akuzuarve R.M., N.M., dhe I. R., e të cilët pastaj ato armë të importuara kundërligjshëm ua shitnin personave të ndryshëm, ashtu që:

- më 31.05.2019, me rastin e kontrollit nga ana e policisë në automjetin "Golf 5", ngjyrë hiri, me targa 665-KS-431 të cilin e drejtonte i akuzuari A.S., në hyrje të Ferizajt, i janë gjetur dhe sekuestruar 10 pistoleta të armëve me gaz të tipit Ekol Special 99,
- më 24.07.2019, në shtëpitë dhe oborrit pronë e të akuzuarve F., në lagjen "Kodra e Trimave" në Prishtinë, janë gjetur dhe sekuestruar armë dhe pjesë të armëve të modifikuara, vegla pune për modifikim të atyre armëve, mjete për gdhendjen e shenjave dhe numrave të serisë së armëve. Më saktësisht, në punëtorinë e shtëpisë së të akuzuarit A.F., zyrtarët policorë kanë gjetur dhe sekuestruar: fishekë të kalibrave të ndryshëm, tyta të modifikuara me gjatësi të ndryshme, punto trapani të plota dhe të thyera, kuti me goditje për stampimin e numrave në metal, pjesë metalike të armëve, brusha për pastrim të armëve, ndërsa të groposura në dheun e oborrit të shtëpisë së të akuzuarit A. F., zyrtarët policorë kanë gjetur dhe sekuestruar 25 pistoleta armë me gaz të tipit "Ekol Jackal Dual" dhe "Zoraki 906-B".

4. **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurit i ka shpallur fajtorë për veprën penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi "*Importi, eksporti, furnizimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse*" nga neni 364, paragrafi 2 lidhur me nenet 31 dhe 77 të KPK dhe secilit i ka shqiptuar dënim me gjobë dhe dënim me burgim, si dhe ka urdhëruar konfiskimin e armëve të lartcekura.
5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, me aktgjykimin e lartcekur, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e paraqitura nga PSK-ja dhe avokati mbrojtësi i të dënuarit A. F., dhe për këtë pjesë e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Kurse me aprovimin e ankesave të paraqitura nga avokatët mbrojtës të të dënuarve P.F., A.F., P. F., dhe A.S., vetëm përkitazi me vendimin për dënim. Ndërsa të pandehurit M.SH., dhe D. F., në bazë të nenit 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së janë liruar nga akuza.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme në këtë lëndë që është ngritur nga mbrojtja ka të bëjë me atë se, a konsiderohen veprimet e të pandehurve veprën penale në bashkëkryerje dhe vazhdimësi e përcaktuar si "*Importi, eksporti, furnizimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse*" nga neni 364, paragrafi 2 lidhur me nenet 31 dhe 77 të KPK-së, apo nëse sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Kosovës me veprimet e të pandehurve janë realizuar elementet e veprës penale "*Pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar*" nga neni 277, paragrafi 1 të KPK-së lidhur me veprën penale "*Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse*" nga neni 364, paragrafi 2 të KPK-së.

7. GJETJET KRYESORE: Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykatat kompetente kanë arsyetuar se me veprimet e të pandehurve janë realizuar elementet e veprës penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi të përcaktuar si *"Importi, eksporti, furnizimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armëve apo mjeteve plasëse"* nga neni 364, paragrafi 2 lidhur me nenet 31 dhe 77 të KPK-së, dhe me këtë kanë theksuar faktin se nuk është aprovuar cilësimi juridik nga PSK-ja.

8. PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË:

Duke vlerësuar provat, gjykata e shkallës së parë ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, duke i shpallur të pandehurit fajtorë për veprën penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi *"Importi, eksporti, furnizimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armëve apo mjeteve plasëse"* nga neni 364, paragrafi 2 lidhur me nenet dhe 77 të KPK-së, me arsyetimin si në vijim:

"[S]a i përket veprës penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277, par. 1 të KPK, ligjvënësi përcakton se "kushdo që me dashje dhe me dijeni qoftë të qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për të kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim prej së paku katër (4) vjet, aktivisht merr pjesë në veprimtaritë kriminale të grupit duke ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuojë në realizimin e veprimtarive kriminale të grupit.

Ndërsa, në nenin 120 të KPK te Përkufizimet e termeve, termi Grupi kriminal i organizuar përkufizohet si - bashkimi i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar të tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore. Në të njëjtin nen termi bashkim i strukturuar përkufizohet si - bashkim i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të veprës penale, por nuk është e nevojshme që anëtarët e këtij bashkimi të kenë role formalisht të përcaktuara, vazhdimësi të anëtarësisë së tyre apo strukturë të ndërtuar.

Bazuar në elementet e veprës penale të krimit të organizuar, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje penale nuk është plotësuar elementi i pjesëmarrjes së personave me dashje për kryerjen e veprimtarisë kriminale të grupit të organizuar dhe strukturuar, kjo për faktin se, për të ekzistuar krimi i organizuar, duhet të përmbushen katër karakteristika mandatore, pa të cilat nuk mund të ekzistojë krimi i organizuar si dhe së paku dy nga karakteristikat alternative të cilat e formojnë krimin e organizuar. Këto katër karakteristika bazë të krimit të organizuar janë: **1)** përfshirja e tre apo më shumë personave si grup i organizuar kriminal; **2)** për periudhë të gjatë ose të pacaktuar kohore; **3)** të dyshuar apo të dënues për vepra penale të rënda (për të cilat përcaktohet dënimi me 4 (katër) vite burgim apo më shumë dhe **4)** me qëllim të përfitimit material apo të pushtetit.

Përpos karakteristikave mandatore për të ekzistuar krimi i organizuar, grupi i ekspertëve të KE, ka përcaktuar edhe karakteristikat alternative e të cilat duhet së paku dy nga to të plotësohen, si karakteristika alternative konsiderohen: 1) të ketë një rol ose detyrë të veçantë për secilin anëtar të grupit; 2) përdorin ndonjë formë disipline ose kontrolli të brendshëm; 3) përdorin dhunë ose forma tjera frikësuese; 4) ushtrojnë ndikim te politika, mediat, administrata publike, organet e zbatimit të ligjit; 5) përdorin strukturë tregtare ose të ngjashme me biznesin; 6) janë të përfshirë në pastrim parash; 7) operojnë në nivel transnacional.

Këto karakteristikat që duhet të plotësohen për ekzistimin e veprës penale të krimit të organizuar, i kanë akceptuar dhe instrumentet me të rëndësishme ndërkombëtare në definimin e krimit të organizuar.

Është e rëndësishme se në këtë çështje penale përkatësisht në veprimet e të akuzuarve janë plotësuar disa nga këto karakteristika, nuk ka dilemë se në rastin konkret kemi të përfshirë në këtë vepër penale më shumë se tre persona, por nuk kemi të bëjmë me grup kriminal të organizuar, por me disa njerëz kryesisht vëllezër të cilët kanë vepruar në vazhdimësi, herë pas here kanë ndërmarrë veprime në drejtim të kryerjes së veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor. Për të ekzistuar krimi i organizuar grupi prej tre e më shumë personave duhet të jetë grup kriminal i organizuar e jo një përbërje e thjeshtë prej tre e më shumë personave. Pastaj, grupi kriminal i organizuar është përcaktuar si grup i strukturuar i tre e më shumë personave i cili ekziston për një periudhë të caktuar kohore me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale, ndërsa në rastin konkret, gjykata, nga provat e administruara ka ardhur në përfundim se nuk kemi pasur një grup mirëfilli të organizuar me një strukturë udhëheqëse, ku definitivisht është ditur se kush është lideri i grupit, kush jep urdhrë, kush janë zbatuesit e këtyre urdhrave dhe cilat janë detyrat e ndara për çdo njërin anëtar të grupit; cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara, ndëshkimet në rast të mosbindjes së urdhrave, nëse ka frikësime, kërcënime, shantazhe apo ndonjë shprehje dhune, vrasje etj., ndërsa pretendimet e prokurorisë më shumë gjasojnë në marrëveshje e komunikime përbrenda të akuzuarve. Nga provat e administruara (përgjimi i telekomunikimeve të të akuzuarve) ndërmjet vete shihet qartë se në raste të caktuara jo vetëm A. F., por edhe vëllezërit tjerë japin udhëzime në drejtim të kryerjes së veprës penale. Pra, nuk ka ekzistuar ndonjë disiplinë, kontroll brenda grupit kriminal të organizuar, që të jep të kuptojmë se në rast të mos zbatimit të urdhrave të dhëna nga udhëheqësi i grupit do të ketë pasoja, që është karakteristikë e grupit kriminal të organizuar dhe krimit të organizuar. Të akuzuarit kryesisht janë vëllezër të cilët në periudha të ndryshme kanë bashkëpunuar me njerëz të tjerë të ndryshëm, por jo se këta i ka ndërlidhur fakti i strukturës së organizuar, urdhër-dhënies dhe zbatimit të urdhrave, të akuzuarit kanë vepruar për një periudhë kohore të limituar të përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, mirëpo nuk mund të thuhet se kanë vepruar për një periudhë të gjatë kohore e cila mund të cilësohet si ndërmarrësi kriminale në drejtim të kryerjes së veprave të natyrave të ndryshme kriminale. Vërtet të akuzuarit kanë

vepruar me qëllime përfitimi material, por nga hetimi financiar tek asnjëri nuk janë gjetur shuma të mëdha parash të deponuara në bankë, ata kanë pasur marrëveshje ndërmjet vete për furnizim, transportim dhe shitje të armëve.

Pra, gjykata nuk vërtetoi se të njëjtit kanë vepruar në formën dhe mënyrën e paraparë me ligj për ekzistimin e krimit të organizuar, nuk vërtetoi se të akuzuarit kanë marrë pjesë aktivisht në aktivitetin e grupit të organizuar kriminal, ngase të njëjtit nuk kanë qenë të vetëdijshëm se pjesëmarrja e tyre do t'i kontribuonte kryerjes së krimeve të rënda si pjesë e grupit, andaj konform nenit 360 par. 2 të KPP-së për të akuzuarit bëri rikualifikimin ligjor të veprës penale duke i shpallur fajtor vetëm për vepër penale bazë të kryer në bashkëkryerje [sic].”

LËNDA NR. 16

1. **Aktvendim 2021:296596, datë 11.08.2022, Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, aktvendim i formës së prerë.**
2. **FJALË KYÇ:** Armë, leje e vlefshme, paaautorizuar, pushim i procedurës.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri E.B, shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paaautorizuar të armëve”, të parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 i KPK-së, pasi më 09.11.2021, rreth orës 00:20, në magjistralen Ferizaj-Prishtinë, ishte gjetur në posedim të armëve në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr. 05/L-022 për armët. Policia kishte ndaluar në trafik veturën e tipit “Audi” dhe gjatë kontrollit të personave, tek i pandehuri ishte gjetur një pistoletë e llojit “Beretta” dhe 9 fishekë (Luger) të kalibrit 9 mm. Këto u sekuestruan nga policia.
4. **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,** duke vendosur sipas kërkesës për hedhjen e aktakuzës të paraqitur nga ana e avokatit mbrojtës të të dënuarit, me aktvendimin e lartcekur e ka hedhur aktakuzën dhe ka pushuar procedurën penale pa e dërguar çështjen në shqyrtim gjyqësor, pasi ka vlerësuar që veprimet e të pandehurit nuk përbëjnë vepër penale, si dhe ka urdhëruar që arma dhe fishekët e sekuestruar t’i kthehen pronarit. Ky aktvendim ka marrë formën e prerë, pasi nuk është ankimuar nga ana e prokurorit të shtetit.
5. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme në këtë lëndë që është ngritur nga mbrojtja ka të bëjë me atë se, a konsiderohet se i pandehuri ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paaautorizuar të armëve”, të parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së, nëse me rastin e kontrollit nga ana e policisë nuk e posedon me vete lejen për mbajtjen e armës.
6. **GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se fakti që i pandehuri nuk kishte me vete lejen e armës me rastin kontrollit nuk

nënkupton se nuk posedon leje të tillë, andaj edhe si rezultat i kësaj nuk kemi të bëjmë me veprën penale për të cilën ishte akuzuar.

7. PJESË NGA ARSYETIMI I AKTVENDIMIT TË GJYKATËS THEMELORE NË FERIZAJ:

Legjislacioni në vendin tonë ka parashikuar fazë të shqyrtimit të aktakuzës pas seancës fillestare, ku është dhënë mundësia që çështja të përmbillet pa shqyrtim gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh të dhënat e siguruara gjatë seancës fillestare, përkatësisht deklarin e të pandehurit se është i pajisur me lejen përkatëse për armën të cilën policia ia kishte gjetur me rastin e ndalimit, mirëpo lejen e armës nuk e ka pasur me vete në ditën kritike. Pas seancës fillestare, avokati mbrojtës i të pandehurit ka paraqitur kërkesë për hedhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës në këtë çështje penale duke ia bashkëngjitur edhe lejen e vlefshme të lëshuar nga ana e MPB-së. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të kërkesës për hedhjen e aktakuzës dhe marrjen e informacioneve shtesë nga ana e MPB-së, kishte konfirmuar faktin se i pandehuri kishte leje të vlefshme për këtë lloj të armës dhe atë prej 17.05.2019 deri 17.05.2024, andaj edhe kishte vendosur të hedhë aktakuzën dhe të pushojë procedurën penale.

LËNDA NR. 17

1. **Aktgjykim PS.nr.56/2020, datë 28.10.2022, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin APS.nr. 9/2023, datë 19.04.2023, aktgjykime këto, të ndryshuara nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.446/2023, datë 29.11.2023.**
2. **FJALË KYÇ:** Armë, detyrim, figurë e veprës penale, përdorim, konsumim, shkelje e ligjit penal.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri A.A., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Speciale e Kosovës, për veprën penale “Detyrimi”, nga neni 267, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së²⁷ (pika I. e dispozitivit) dhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”, nga neni 328, paragrafi 1 të KPK-së (pika III. e dispozitivit).
4. **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,** me aktgjykimin e lartcekur e ka shpallur fajtor të pandehurin për veprat penale të theksuara më lart, ndërsa këtë aktgjykim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke i refuzuar si të pabazuara ankesat e paraqitura.
5. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme që është ngritur nga avokati mbrojtës i të pandehurit ka të bëjë me atë nëse veprimet e të pandehurit A.A., i përbëjnë elementet e figurës së veprës penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në

27 Rregullore (UNMIK) nr. 2003/25, mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, datë 06.07.2003.

shfrytëzim të paautorizuar të armëve”, nga neni 328, paragrafi 1 i KPK-së, duke qenë se “përdorimi i armës së zjarrit me qëllim të frikësimit dhe kërcënimit” është konsumuar me veprën penale “Detyrimi”, nga neni 267, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së.

- 6. GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës nuk është pajtuar me qëndrimet juridike të gjykatave të instancave më të ulëta, duke konstatuar se në këtë rast “përdorimi i armës së zjarrit me qëllim të frikësimit dhe kërcënimit” është konsumuar me veprën penale “Detyrimi”, nga neni 367, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së.

- 7. PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS:** “Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë konstatoi se në këtë çështje penale është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit A.A., sa i përket veprës penale nga pika III. e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, andaj edhe pretendimet e mbrojtësit të tij në këtë drejtim, janë vlerësuar si të bazuara, për arsytet që do të paraqiten në vijim [...] Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se i dënuari A.A., nuk është dashur që të shpallet fajtor për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”, nga neni 328, paragrafi 1 të KPK-së (pika I. e dispozitivit), pasi veprimi kryes i kësaj vepre penale “përdorimi i armëve me qëllim të frikësimit dhe kërcënimit të të dëmtuarit H.K., që konsistojnë në vendosjen e granatave të dorës dhe bombolës së gazit” është konsumuar me veprën penale nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga përshkrimi i veprimeve kryese të veprës penale nga pika I. e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që “i akuzuari A.A., sipas kërkesës dhe premtimit nga të akzuarit B.K. dhe Sh.Z., se do t’i ndërtohet një shtëpi dhe do t’i jepet një shumë e parave, më datat e lartë - theksuara në pronën e të dëmtuarit H.K, saktësisht në zyrat e kompanisë së tij në Prishtinë, ka vendosur dy herë radhazi granata dore e bombola gazi të cilat kanë shpërthyer, me qëllim të kërcënimit të rëndë të të dëmtuarit H.K, për tu tërhequr nga prona e tij e privatizuar....”.

Nga ky përshkrim faktik i veprimeve kryese shihet se veprimi i të dënuarit A.A., që ndërlidhet me përdorimin e armëve të lartcekura me qëllim të kërcënimit, është pjesë përbërëse e figurës së kësaj vepre penale, andaj edhe si të tilla nuk mund që të njëjtat të paraqiten edhe si elemente të figurës së veprës penale nga pika III. e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Në këtë rast, veprimi kryes që i referohet përdorimit të armëve të lartcekura me qëllim të kërcënimit të të dëmtuarit është konsumuar te vepra penale nga pika I. e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, andaj edhe rrjedhimisht veprimet kryese të të dënuarit A.A. nga pika III. e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë kanë mundur që të cilësohen si vepër penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”, nga neni 328, paragrafi 2 të KPK-së, e që kjo vepër penale me këtë cilësim juridik është përfshirë në amnisti, duke u

bazuar në nenin 2, paragrafi 1 lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.5. të Ligjit nr. 04/L-209 për Amnistinë, i datës 11.07.2013.

Në këtë mënyrë, duke e shpallur fajtor të dënuarin A.A., për veprën penale të lartcekur, gjykatat e instancave më të ulëta e kanë shkelur ligjin penal në dëm të të dënuarit, andaj, edhe Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në nenin 362, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. lidhur me nenin 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ricilësuar veprën penale dhe duke refuzuar akuzën, për shkak të përfshirjes në amnisti të kësaj veprë penale. [sic]"

LËNDA NR. 18.

1. **Aktgjykim P.nr. 199/2019, datë 13.05.2020, nga Gjykata Themelore në Gjakovë, aktgjykim i formës së prerë**
2. **FJALË KYÇ:** Armë, Facebook, leje e vlefshme, lirim nga akuza, posedim, postim.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri V.P., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, për veprën penale *"Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve"* nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së, me pretendimin se i njëjti e kishte postuar në rrjetin social *"Facebook"* armën, të cilën e kishte poseduar në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të Ligjit për armët, e cila me ligj kategorizohet armë zjarri e për të cilën armë ka poseduar leje të vlefshme personi tjetër, G.P.
4. **GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,** me aktgjykimin e lartcekur e ka liruar nga akuza të pandehurin, duke konsideruar se në këtë rast nuk bëhet fjalë për vepër penale.
5. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme që është trajtuar në këtë rast ka të bëjë me pyetjen se çka konsiderohet *"posedim"* i armës së zjarrit në kuptimin e veprës penale të lartcekur.
6. **GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e lartcekur, Gjykata Themelore në Gjakovë, ka konstatuar se jo çdo pushtet faktik mbi armën e zjarrit konsiderohet *"posedim"* në kuptim të veprimeve kryese të veprës penale të lartcekur.
7. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS THEMELORE NË GJAKOVË:** *Me posedim të armës në kuptimin e veprës penale të lartcekur nuk mund të kuptohet çdo rast kur një person i caktuar ndodhet në posedim faktik të armës, për të cilën nuk ka leje për mbajtje të lëshuar nga organi kompetent, por me këtë shprehje duhet kuptuar një raport i tillë i kryesit ndaj armës, nga i cili manifestohet një raport i caktuar i pushtetit të kryesit ndaj një objekti të tillë, përkatësisht ai atë objekt (armën) duhet ta mbajë si të tijën. Pra, në rastin konkret i akuzuari nuk ka pasur sjellje si pronar të armës, por gjatë shqyrtimit gjyqësor me provat e administruara, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari V.P., vetëm e kishte mbajtur*

në posedim armën për të cilën leje kishte pasur pronari-dëshmitari G.P., në prezencën e tij për 5-10 minuta, ku kishte bërë fotografi dhe të njëjtat i kishte postuar në "Facebook". Pra, armën për të cilën pretendohet me akuzë se e kishte mbajtur i akuzuari, ai e kishte mbajtur 5-10 minuta, aq kohë sa i kishte bërë fotografitë në shtëpinë e tij në prezencën e pronarit G.P., ku pastaj pronari të njëjtën e ka kthyer në banesën e tij, dhe asnjëherë tjetër i akuzuari nuk ka qenë në posedim të kësaj arme. Prandaj, gjykata vlerëson se mbajtja në posedim për aq kohë sa është theksuar më lart, nuk manifeston sjellje të të akuzuarit si posedues apo si pronar ndaj saj dhe gjykata nuk e ka vërtetuar faktin e i njëjti armën e ka mbajtur si të tijën. Prandaj, me këtë rast gjykata konsideron se me këtë veprim nuk janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën ishte akuzuar. Andaj, pas analizimit të të gjitha provave ka konstatuar se veprimet e të akuzuarit, përkatësisht mbajtja në posedim e armës nga ana e të akuzuarit V.P., për kohën e lartshënuar në prezencë të pronarit G.P., e për të cilën i njëjti ka poseduar leje të vlefshme, ku i akuzuari V.P., kishte bërë fotografi dhe të njëjtat i kishte postuar në "Facebook", të cilat i vihen në ngarkim të akuzuarit, nuk përbëjnë vepër penale, prandaj mori aktgjykim lirues për shkak se me këto veprime nuk janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën ishte akuzuar.

LËNDA NR. 19

1. **Aktgjykim** PKR.nr.261/2018, datë 31.05.2023, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.395/2023, datë 08.11.2023, dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin PML.nr. 131/2024, datë 24.04.2024.
2. **FJALË KYÇ:** Armë artizanale, posedim, pushkë gjahu, sekuestrim.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri E.M., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, ndër të tjera, për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 374, paragrafi 1 i KPK-së, pasi i njëjti nga data e pacaktuar e deri në datën e arrestimit, ka mbajtur në posedim armën, pushkë gjahu, e punuar me dorë (artizanale), me diametër tyte 16, pa numër serie, modeli dhe prodhuesi të panjohur, në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm për armë të tilla, e sekuestruar nga zyrtarët policorë.
4. **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,** me aktgjykimin e lartcekur e ka shpallur fajtor të pandehurin E.M., dhe e ka sekuestruar armën e lartcekur.
5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS dhe GJYKATA SUPREME E KOSOVËS,** me aktgjykimet e lartcekura e kanë vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme që është trajtuar në këtë rast ka të bëjë me pyetjen se a konsiderohet armë në kuptimin e veprës penale të lartcekur pushka e gjahut, e punuar me dorë (artizanale) me diametër tyte 16.

7. GJETJET KRYESORE: Në lidhje me çështjen e lartcekur, Gjykata Themelore në Prishtinë, ka konstatuar se edhe pushka e gjahut e punuar me dorë (artizanale) konsiderohet armë në kuptimin e veprës penale të lartcekur.

8. PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË:

"Nga provat e administruara është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit E.M., ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 374, paragrafi 1 i KPK-së, pasi i njëjti ka poseduar pa autorizim armën me të cilën është tentuar privimi nga jeta i tani të dëmtuarit, duke i shkaktuar lëndime të rënda të dëmtuarit D.M., me pushkë gjahu, e punuar me dore (artizanale) e kalibrit 16 bore, pa numër serie, modeli dhe prodhuesi të panjohur, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët. I akuzuari edhe në shqyrtimet gjyqësore ka pranuar se ka poseduar armën që e ka rregulluar gjyshi i tij. Gjykata ka konstatuar se elementet e veprës penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 374, paragrafi 1 i KPK-së, janë: "Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet", ndërsa sipas nenit 113, paragrafi 40 të KPK-së, armë konsiderohet "çdo send ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave, të cilat lirohen gjatë djegies së materieve shpërthyes, elektrike, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, hedhë predha në formë të një plumbi të vetëm, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që krijohet dhe përdoret për të shkaktuar lëndime trupore ose dëm fizik, qoftë edhe psikologjik, si dhe secili send tjetër, qëllimi kryesor i të cilit është kryerja e sulmit fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose ndaj pasurisë. Armë po ashtu përfshin municionin, pjesët dhe përbërësit e armëve, si dhe armët nukleare, biologjike dhe kimike. Këto në vijim janë armë: 40.1. armët e zjarrit; 40.2. armët e koleksionit; 40.3. armët pneumatike (ajrore); 40.4. armët që përdoren për shpërndarjen e gazit irritues; 40.5. armët shpërthyes; 40.6. armët me shigjeta; 40.7. armët e ftohta; 40.8. armët për sinjalizim akustik dhe të dritës; 40.9. armët elektrohok; 40.10. armët me rrymë [sic]."

LËNDA NR. 20

- 1. Aktgjykim** PKR.nr.384/2015, w 23.01.2023, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin APS.nr. 18/2023, datë 26.05.2023, dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin PML.nr.373/2023, datë 02.10.2023.
- 2. FJALË KYÇ:** Armë zjarri, dënim me burgim, dënim me gjobë, fishekë, import, masa të fshehta vëzhgimi dhe hetimi, municion, përfitime personale, pistoletë me gaz, pushkë gjahu.

- 3. PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** Të pandehurit SH.B., B.B., dhe F.B., shtetas të Kosovës, janë akuzuar nga Prokuroria Speciale e Kosovës, për veprën penale *"Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse"*, nga neni 372, paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, pasi të njëjtit, për përfitime personale, në bashkëkryerje dhe në mënyrë të paautorizuar, kanë zhvilluar veprimtarinë e furnizimit dhe shpërndarjes së armëve të zjarrit dhe të municionit përkatës. Të akuzuarit R.S., dhe V.M., (ndaj të cilëve është veçuar procedura), kanë sjellë nga Serbia në Kosovë, sasi të madhe të armëve dhe atë: një (1) pushkë gjahu, model rus; njëzetegjashtë (26) pistoleta me gaz, modele të ndryshme, si dhe tremijepesëqind (3.500) copë fishekë të kalibrit 9 mm, me qëllim që t'ua shesin të akuzuarve të lartcekur. Këto armë dhe ky municion janë gjetur në bagazhin e veturës *"Audi 80"* dhe nën ulësen e pasme të veturës së R. S., nga zyrtarët policorë me rastin e ndalimit të tyre në një fshat të Komunës së Prishtinës, më 05.12.2013, rreth orës 21:50, ku kishin lënë takimin e tyre për shitblerjen e armëve dhe dorëzimin e tyre të akuzuarve të lartcekur, të cilët aty ishin me veturën *"Mercedes 190"*. Të akuzuarit u ndaluan nga policia, meqë ishin nën masa të fshehta vëzhgimi dhe hetimi, ndërsa gjatë kontrollimit të automjeteve në fjalë, u sekuestruan armët dhe municioni. Gjithashtu, te të akuzuarit B.B., e F.B., u gjetën paratë të cilat i kishin me vete për blerjen e atyre armëve, të cilat para u sekuestruan.
- 4. GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,** me aktgjykimin e lartcekur i ka shpallur fajtorë të pandehurit e lartcekur, për veprën penale për të cilën janë akuzuar dhe secilit prej tyre i ka shqiptuar dënim me gjobë dhe dënim me burgim, si dhe ka urdhëruar konfiskimin e armëve, municionit, veturave dhe parave të lartcekura.
- 5. GJYKATA E APELIT E KOSOVËS dhe GJYKATA SUPREME E KOSOVËS,** me aktgjykimet e lartcekura e kanë vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke i refuzuar si të pabazuara pretendimet e avokatëve mbrojtës të të pandehurve.
- 6. ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme që është ngritur nga avokatët mbrojtës të të pandehurve ka të bëjë me atë nëse në veprimet e të pandehurve janë realizuar elementet e figurës së veprës penale për të cilën janë akuzuar dhe shpallur fajtorë, pasi në rastin konkret nuk ka pasur blerje të armëve dhe nuk është bërë asnjë pagesë për shitblerjen e armëve.
- 7. GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykatat kompetente kanë arsyetuar dhe konstatuar se me veprimet e të pandehurve janë përmbushur të gjitha elementet e figurës së veprës penale për të cilën janë akuzuar dhe shpallur fajtor, pavarësisht faktit që në rastin konkret nuk ka pasur blerje të armëve dhe nuk është bërë pagesa për shitblerjen e armëve.
- 8. PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS:** *"Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve: SH.B., B.B., dhe F.B., konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal. Dispozitivi i këtyre aktgjykimeve është i*

qartë dhe i kuptueshëm, si dhe nuk është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin e këtyre aktgjykimeve. Përkundrazi, dispozitivi i këtyre aktgjykimet është në harmoni me pjesën e arsyetimit dhe me provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë. Në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur të gjitha faktet dhe rrethanat të cilat përbëjnë elementet e figurës së veprës penale "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse", nga neni 372, paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës për të cilën janë shpallur fajtorë të dënuarit: SH.B., B.B., dhe F.B. Nga dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet se janë përshkruar në mënyrë të qartë të gjitha veprimet kryesë të të dënuarve në fjalë, të cilat veprime përfshijnë periudhën kohore prej 09.09.2013 deri 05.12.2013, kur është realizuar aksioni i zyrtarëve të Policisë së Kosovës, ku me atë rast edhe janë sekuestruar armët, municioni, veturat dhe paratë, si dhe janë arrestuar të dënuarit B.B., dhe F.B. Fakti se në këtë rast të dënuarit B.B., dhe F.B., nuk kanë arritur t'i blejnë armët dhe nuk është bërë asnjë pagesë për shitblerjen e armëve është i parëndësishëm, ngase të njëjtit ishin arrestuar në momentin e ndalimit të tyre, duke e pasur parasysh se ishin nën masa vëzhgimi dhe hetimi. Kurse, në anën tjetër, veprimet e tyre, në bashkëkryerje edhe me të dënuarin SH.B., kishin filluar qysh nga 09.09.2013, ashtu që të njëjtit në vazhdimësi dhe me marrëveshje paraprake, për përfitime personale, kanë zhvilluar veprimtarinë e furnizimit me armë nga të pandehurit R.S., dhe V.M., dhe këtë me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes së armëve dhe municioneve për to [sic]."

LËNDA NR. 21

1. **Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda PKR. nr.24/2020 të datës 14.07.2020, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR. nr.336/2020 të datës 11.12.2020 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.41/2021 i datës 03.03.2021.**
2. **FJALËT KYÇE:** Armë, municion, leje për armë, pistoletë, konfiskim.
3. **PËRMBLEDHJA E RASTIT:** I pandehuri R.A është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Pejë, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374, paragrafi 1 të KPRK-së, sepse me datë 27.02.2018 rreth orës 13:55 në Pejë në kafiterinë "Don Caffè" që gjendet në Sheshin e Heronjve, me dashje e shkel nenin 22, par.2 dhe 3 të Ligjit për Armët nr.05/L-022, në atë mënyrë që pasi vërehet me armë në brez duke lëvizur në vende publike nga qytetarët, është lajmëruar policia e cila në bazë të asaj informate e identifikon të pandehurin i cili në atë moment po qëndronte në lokalin në fjalë ku kishte edhe mysafirë të tjerë e që tek i njëjti gjendet dhe sekuestrohet pistoleta e tipit

HS, modeli XDM 9 e kalibrit 99 mm, me nr.serik H199692 me karikator dhe 11 copë fishekë.

4. **GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA:** me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin e ka shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej katërqind (400) euro, si dhe është shqiptuar dënimi plotësues duke i konfiskuar pistoletën e tipit HS, modeli XDM 9 e kalibrit 99 mm, me nr.serik H199692 me karikator dhe 11 copë fishekë.
5. **GJYKATA E AELIT E KOSOVËS - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** me aktgjykimin e lartë cekur, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE,** Njëra prej çështjeve të rëndësishme ligjore në këtë rast që është ngritur ka të bëjë me atë se a konsiderohen veprimet e të pandehurit si vepër penale në rastet kur nuk i përmbahet kushteve të lejes për posedimin e armës, gjegjësisht lejen e armës të cilën e posedonte për përdorim në poligonin e shenjtërisë a mund të e posedoj edhe jashtë poligonit të shenjtërisë përkatësisht në vende publike dhe se kjo shkelje a konsiderohet vepër penale sipas dispozitave të ligjit në fuqi.
7. **GJETJET KRYESORE,** Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykatat e të tri instancave gjyqësore kanë konsideruar se në veprimet e të akuzuarit janë realizuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.
8. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS:** Me rastin e vlerësimit të pretendimeve të shkeljeve të ligjit penal, Gjykata Supreme e Kosovës, konstatoi se me dispozitën e nenit 374 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se: *"Kushdo që mban në pronësi, kontroll ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla",* kurse baza e shkeljes është formësuar përmes normës blankete konkretisht në nenin 22, par.2 dhe 3 të Ligjit për Armët, në të cilën është përcaktuar se: *"armët mund të barten nga vendbanimi deri në poligon për qitje ose vendi për riparim me leje për lëvizje me armë të autorizuar nga policia".* Nga përmbajtja e kësaj dispozite është kufizuar se armët mund të barten nën kushte të caktuara dhe atë nga vendbanimi deri tek vendi për qitje dhe anasjelltas, kurse në rastin konkret i dënuari këtyre kushteve nuk i është përmbajtur përkitazi me mënyrën e mbajtjes, pasi që nga provat e administruara del se armën ishte duke e mbajtur në kafiteri. Duke trajtuar pretendimin se në rastin konkret kemi të bëjmë me veprime të kundërvajtjes sipas dispozitës së nenit 71 par.2 të Ligjit për Armët, duhet theksuar faktin se dispozita në fjalë ka paraparë gjobë për mos respektim të afateve kohore, kurse në rastin konkret shkelja konsiston në faktin se i dënuari nuk kishte mbajtur armën sipas destinimit të përcaktuar, përkatësisht nuk i është përmbajtur kushteve për bartjen e armës nga vendbanimi i tij deri në poligonin për qitje dhe anasjelltas. Pretendimet përkitazi me faktin se në veprimet e të dënuarit nuk manifestohet elementi i dashjes dhe se në veprimet e të dënuarit nuk janë konsumuar elementet e veprës penale, por të kundërvajtjes dhe

fakti i lajthimit faktik të të dënuarit, dalin të jenë pretendime të pabazuara. Në veprimet e të dënuarit manifestohet dashja dhe atë dashja direkte për kryerjen e veprës penale dhe se kjo manifestohet përmes elementit subjektiv i cili vërtetohet përmes veprimeve objektive të të dënuarit e që në rastin konkret ndërlidhen me faktin se i dënuari kishte pasur njohuri se lejohej ekskluzivisht bartja e armës prej vendbanimit të tij deri në poligonin për qitje dhe anasjelltas dhe jo edhe në ambiente tjera. Në këtë mënyrë, në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar, dhe në asnjë rrethanë nuk bëhet fjalë për lajthim faktik, siç pretendohet në kërkesë. Në rastin konkret, përveç faktit që leja e bartjes së armës kishte afat të skaduar për më tepër se një muaj edhe nën supozimin se ky afat do të ishte i vlefshëm, megjithatë i dënuari duhet të ketë qenë në dijeni se leja mbulonte vetëm kohën e lëvizjes prej vendbanimit të tij deri në poligon të qitjes dhe anasjelltas dhe jo edhe bartjen e armës në vende publike.

LËNDA NR. 22

1. Aktgjykim PS.nr.35/2022, datë 28.07.2023, nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special.
2. **FJALË KYÇ:** Dënim me burgim, grup kriminal, narkotikë, substanca psikotrope.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** Të pandehurit B.I., M.I., U.Q., dhe A.Z., janë akuzuar për veprën penale “Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar” nga neni 277, paragrafi 1 i KPK-së, lidhur me veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267, paragrafi 2 i KPK-së, lidhur me veprën penale “Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike” nga neni 268, paragrafi 1 i KPK-së. Ndërsa, i pandehuri B.I., është akuzuar edhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së.
- I. **Të akuzuarit B.I., dhe SH.I.:** janë shpallur fajtorë, pasi nga koha e pacaktuar e deri më 24.12.2021 në fshatin Bec, Komuna e Gjakovës, përkatësisht në shtëpitë e tyre familjare, në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi, të akuzuarit B.I., Sh. I., dhe i akuzuari në arrati F.M., pa autorizim kanë prodhuar, kultivuar, përgatitur dhe nxjerrë në qarkullim (për shitje) substancë narkotike dhe atë:
 - I akuzuari B.I., përmes një shtetasi gjerman me emrin e njohur A. B., fillimisht siguron farat për mbjelljen e narkotikut të llojit “*Cannabis sativa*” (marihuanë), ku së bashku me të vëllain SH. I., dhe të akuzuarin në arrati F.M., mbjellin dhe kultivojnë narkotikun në parcelën afër shtëpive të tyre (të të akuzuarve B. dhe S.I.) në fshatin Bec dhe në një parcelë tjetër të pidentifikuar. Më pas, thajnë dhe përpunojnë substancën narkotike në objektet përcjellëse të shtëpive të tyre, dhe

përfundimisht nxjerrin në qarkullim (shitje) këtë substancë narkotike brenda dhe jashtë Kosovës;

- Të akuzuarit, substancën narkotike të kultivuar e kanë nxjerrë në qarkullim (shitje) dhe atë përmes të akuzuarve: F.M., (i akuzuar në arrati); M.I.; U.Q.; e A.Z.; të cilët pa autorizim janë furnizuar me lëndë narkotike nga të akuzuarit B.I., e SH.I., e më pas të njëjtën lëndë narkotike e kanë poseduar pa autorizim më qëllim të shitjes;
- Më 24.12.2021, me rastin e kontrollit të shtëpive e objekteve përcjellëse të të akuzuarve, janë gjetur: te B.I., në paketime të ndryshme substancë narkotike në peshë neto prej 8,714.00 gramë, 1 (një) peshore me mbishkrim *"Foraco"* me mbetje të pluhurit të bardhë, 17 (shtatëmbëdhjetë) bimë të llojit *"Cannabis sativa"* (marihuanë), 1 (një) peshore digjitale me mbishkrim *"First"*, 130 (njëqind e tridhjetë) fara të *"Cannabis sativa"* (marihuanë), 1 (një) palë gërshërë për krasitjen e bimëve narkotike, pajisje për ndriçim artificial të përdorura në kultivimin e bimës narkotike; ndërsa te SH.I., substancë narkotike në peshë prej 1,083.9 gram, 5 (pesë) palë gërshërë për krasitjen e bimëve narkotike, 1 (një) peshore digjitale për matje, 10 (dhjetë) fara të *"Cannabis sativa"* (marihuanë). Të gjitha këto janë sekuestruar nga policia me rastin e kontrollit;
- Pas ekzaminimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, konstatohet se te substanca bimore në provat materiale të ekzaminuara ka rezultuar prezencë e *"Cannabis sativa"* (marihuanë) që përmban *"tetrahidrokanabinol"* (HTC), ndërsa ekzaminimi i farave bimore dhe mbetjeve të substancës me ngjyrë të gjelbër ka treguar prezencë të *"Cannabis sativa"* (marihuanë), ku mbetjet e pluhurit të gjetura në peshoren *"Foraco"* kanë treguar prezencë të narkotikut të llojit *"kokainë"*.

Me këto veprime të akuzuarit kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi të përcaktuar si *"Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike"* nga neni 268 paragrafi 4 lidhur me nenin 31 e 77 të KPK-së.

- II. **I akuzuari B.I.:** është shpallur fajtor, sepse nga koha e pacaktuar e deri më datën 24.12.2021, në vazhdimësi, në fshatin Bec, Komuna e Gjakovës, përkatësisht në objektin përcjellës të shtëpisë së tij (garazh), në dollap metali, ka mbajtur në pronësi, kontroll e posedim të pa autorizuar 10 (dhjetë) fishekë të kalibrit 7.62X54mm, me mbishkrimin 19/67, dhe 1 (një) fishek të kalibrit 7.62X39mm, me mbishkrimin 88, të cilat janë gjetur dhe sekuestruar me rastin e kontrollit të shtëpisë së të akuzuarit nga Policia e Kosovës.

Me këto veprime i akuzuari ka kryer në vazhdimësi veprën penale *"Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve"* nga neni 366 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

- III. **I akuzuari M.I.:** është shpallur fajtor, sepse nga koha e pacaktuar e deri më 24.12.2021, në vazhdimësi, në Gjakovë, përkatësisht në lokalën e tij *"Secret Shisha"*

Bar”, pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes, shpërndarjes dhe ofrimit për shitje substancën narkotike të llojit “*Cannabis sativa*” (marihuanë) dhe “*kokainë*”, duke i ndarë sasi të marihuanës dhe kokainës në sasi më të vogla dhe atë në doza me shuma të caktuara, duke përfshirë në sasi 5 (pesë) euro, 10 (dhjetë) euro dhe 50 (pesëdhjetë) euro, lëndën narkotike “*Cannabis sativa*” e cila pa autorizim është prodhuar, kultivuar, përgatitur dhe nxjerrë në qarkullim (shitje) nga të akuzuarit B.I., SH.I., dhe i akuzuari në arrati F. M., dhe lëndën narkotike “*kokainë*”, ku mbetjet e saj janë gjetur gjatë kontrollit tek i akuzuari B.I., në mënyrën specifike të përshkruar nën pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me këto veprime i akuzuari ka kryer në vazhdimësi veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

IV. I akuzuari U.Q.: është shpallur fajtor, sepse nga koha e pacaktuar e deri më 24.12.2021, në vazhdimësi, në Gjakovë, përkatësisht në fshatin Bec, Komuna e Gjakovës, pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes, shpërndarjes dhe ofrimit për shitje substancën narkotike të llojit “*Cannabis sativa*” (marihuanë) dhe “*kokainë*”, ku:

- Narkotikun e llojit “*Cannabis sativa*” (marihuanë) të prodhuar, kultivuar, përgatitur dhe nxjerrë në qarkullim (shitje), në mënyrë të paautorizuar, nga të akuzuarit B.I., SH.I., dhe i akuzuari në arrati F.M., të cilët ia kanë ofruar për shitje (ia kanë shitur) narkotikun të akuzuarit A.Z., i cili e ka blerë narkotikun nga këta të akuzuar në fshatin Bec e më pastaj është drejtuar për Prishtinë, ku me rastin e shitjes së narkotikut i akuzuari U.Q., ka marrë pjesë në shitje të narkotikut së bashku me të akuzuarit B.I., SH.I., dhe F.M. Pra, këta të fundit më parë edhe e kishin kultivuar këtë lëndë narkotike, ndërsa U.Q., ka marrë pjesë në shitjen e narkotikut;
- Narkotikun e llojit “*kokainë*”, me rastin e kontrollit të shtëpive e objekteve përcjellëse të të akuzuarve B.I., e SH.I., në shtëpinë e B.I., janë gjetur mbetje të “*kokainës*”, ndërsa i akuzuari U.Q., e ka siguruar (blerë) paraprakisht nga i akuzuari B.I., dhe e ka vënë në posedim të tij me qëllim të shpërndarjes, vënies në posedim apo dispozicion të L.N., e të cilët narkotikun e siguruar (blerë) nga B.I., në raste të caktuara e kanë konsumuar bashkë U.Q., dhe L.N.

Me këto veprime i akuzuari ka kryer në vazhdimësi veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

V. I akuzuari A.Z.: është shpallur fajtor, sepse nga koha e pacaktuar e deri më 24.12.2021, në vazhdimësi, në Gjakovë, përkatësisht në fshatin Bec, Komuna e Gjakovës, ka takuar (kontaktuar) të akuzuarin B.I., me qëllim të sigurimit të narkotikut të llojit “*Cannabis sativa*” (marihuanë) dhe pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes, shpërndarjes dhe ofrimit për shitje substancën narkotike të llojit “*Cannabis sativa*” (marihuanë), ku:

Për sigurimin e narkotikut "*Cannabis sativa*" (marihuanë) të prodhuar, të kultivuar, përgatitur dhe nxjerrë në qarkullim (shitje), në mënyrë të paautorizuar, nga të akuzuarit B.I., SH.I., dhe i akuzuari në arrati F.M., i akuzuari A.Z., disa herë ka takuar (kontaktuar) të akuzuarin B.I., për sigurimin e narkotikut. Më 9.12.2021, paraprakisht B.I., i ka thënë "[a] ke gjetur ndonjë myshteri të ri, ti e ke çmimin e prerë, veç më thuaj" e ku i akuzuari A., i përgjigjet "[p]o vij po i marr qata dy këlysh", pastaj ka shkuar me automjetin e tij në fshatin Bec, Komuna e Gjakovës (në shtëpinë e të akuzuarit B.), ka siguruar narkotik të llojit "*Cannabis sativa*" (marihuanë) me qëllim të shitjes, shpërndarjes dhe ofrimit për shitje, ku me rastin e sigurimit të narkotikut nga i akuzuari B., të pranishëm kanë qenë edhe të akuzuarit U.Q., SH.I., dhe F.M.

Me këto veprime i akuzuari ka kryer në vazhdimësi veprën penale "*Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge*" nga neni 267, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

4. GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI SPECIAL, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurit i ka shpallur fajtorë dhe u ka shqiptuar dënimet si vijon:

B.I., për veprën penale nën pikën I., të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje 4 vjet e 6 muaj burgim si dhe dënimin me gjobë 7,000.00 euro, të cilën i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi; për veprën penale nën pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me gjobë 1,000.00 euro, të cilën i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Andaj, në përputhje me nenin 76 të KPK-së, të akuzuarit i vërteton-shqipton dënimin unik me gjobë 8,000.00 euro.

SH.I., për veprën penale nën pikën I., të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje 4 vjet burgim dhe dënimin me gjobë 5,000.00 euro.

M.I., për veprën penale nën pikën III., të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje 3 vjet burgim dhe dënimin me gjobë 5,000.00 euro,

U.Q., për veprën penale nën pikën IV., të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje 3 vjet burgim dhe dënimin me gjobë 5,000.00 euro,

A.Z., për veprën penale nën pikën V., të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje 2 vjet e 6 muaj burgim dhe dënimin me gjobë 5,000.00 euro.

Në përputhje me nenin 269, 270 dhe 271 të KPP-së janë konfiskuar sendet-pasuria e përdorur apo e destinuar për kryerjen e veprës penale, sendet-pasuria e rezultuar-përfutur nga vepra penale, të sekuestruara sipas urdhrit PP.nr.174 /2021, datë 19.01.2022 nga Gjykata Themelore -Departamenti për Krime të Rënda në Mitrovicë

dhe atë: veturë “Mercedes” me targa 03-195-EQ, e përdorur në kryerjen e veprës penale nga i akuzuari SH.I., veturë “Mercedes” me targa 07-621-DJ, e përdorur në kryerjen e veprës penale nga i akuzuari B.I., veturë “Volkswagen” me targa 07-591-DJ, e përdorur në kryerjen e veprës penale nga i akuzuari B.I., veturë “Smart” me targa 04-401-IS, në pronësi (e blerë) nga i akuzuari B.I., dhe telefon “Nokia” me IMEI 356394020760200, telefon “iPhone” me IMEI 352061068658430, telefon “iPhone” me ngjyrë hiri i modelit A1688(S6), telefon “Samsung” me ngjyrë të zezë i modelit S9+ dhe telefon “Samsung” me ngjyrë të zezë, lënda narkotike, municioni i armës dhe mjetet e kryerjes së veprës penale.

5. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme në këtë lëndë që është ngritur nga mbrojtja ka të bëjë me atë se, a konsiderohet se me veprimet e tyre, në vazhdimësi dhe bashkëkryerje, të pandehurit kanë kryer veprën penale “*Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike*” nga neni 268 paragrafi 4 lidhur me nenin 31 e 77 të KPK-së, apo sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Kosovës se me veprimet e të pandehurve janë realizuar elementet e veprës penale “*Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar*” nga neni 277 paragrafi 1 të KPK-së, lidhur me veprën penale “*Blerja, posedimi, shpërndarja, shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge*” nga neni 267 paragrafi 2 të KPK-së.
6. **GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se me veprimet e të pandehurve janë realizuar elementet e veprës penale në bashkëkryerje dhe vazhdimësi “*Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike*” nga neni 268 paragrafi 4 lidhur me nenin 31 e 77 të KPK-së, por nuk janë realizuar elementet e krimit të organizuar ashtu siç ishte paraqitur aktakuza nga Prokuroria Speciale e Kosovës.
7. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI SPECIAL:** Duke vlerësuar provat, gjykata e shkallës së parë ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, duke i shpallur të pandehurit fajtorë për veprën penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi “*Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike*” nga neni 268 paragrafi 4 lidhur me nenin 31 e 77 të KPK-së, me arsyetimin si në vijim: “Gjykata, në këtë çështje penale ka vërtetuar gjendjen faktike sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë në përshkrim të shkurtër se të akuzuarit nga periudha kohore e pacaktuar e deri më 24.12.2021 në fshatin Bec të Komunës së Gjakovës, respektivisht në shtëpitë e tyre familjare, të akuzuarit B. I., Sh.I. dhe i akuzuari në arrati F. M., pa autorizim kanë prodhuar, kultivuar, përgatitur e nxjerr në qarkullim-për shitje substancë narkotike. Substancën e kultivuar narkotike të llojit “*Kanabis Sativa-Marihuanë*”, fillimisht i akuzuari B.I i ka siguruar farat për mbjelljen e këtij narkotiku, farat i ka siguruar nga një person me shtetas gjerman e më pas së bashku me të akuzuarit Sh. I. e F.M. (i cili gjendet në arrati) e kanë kultivuar këtë narkotik, e kanë vënë në qarkullim me qëllim shitjeje edhe përmes të akuzuarve po të këtij rasti penal, të akuzuarve U.Q. e M. I. Me

rastin e kontrollit të shtëpive të të akuzuarve B. e Sh. I., është gjetur në shtëpitë e tyre sasi e konsiderueshme e narkotikut, vegla-pajisje për kultivim e përpunim të narkotikut, fara për mbjellje të narkotikut, peshore për peshimin e narkotikut dhe peshore me mbetje të pluhurit të bardhë "Kokainë".

Prokuroria Speciale, me rastin e ngritjes së aktit akuzues, të akuzuarit e kësaj çështjeje penale i ka akuzuar për veprën penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 paragrafi 1 të KPK, lidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja, shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 të KPK e lidhur me veprën penale prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 268 paragrafi 1 të KPK.

Po ashtu i akuzuari B.I., është akuzuar edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPK, ku për këtë veprë penale, gjykata nuk ka bërë ri-cilësim të veprës penale por ka vetëtuar se gjendja faktike në raport me këtë veprë penale është provuar sikurse ajo e pretenduar me aktin akuzues.

Gjendja e lart-theksuar faktike të përshkruar në përshkrim të shkurtër në këtë arsyetim të aktgjykimit, por edhe gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, është gjendje të cilën e ka vërtetuar gjykata me rastin e procedimit të kësaj çështjeje penale dhe provave të saj. Bazuar në këtë gjendje faktike, gjykata ka bërë ri-cilësimin juridik të veprës penale, nga ai cilësim i veprës i cili është parashtuar me aktin akuzues (respektivisht pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar) në veprën-veprat penale për të cilën-cilat janë shpallur fajtorë të akuzuarit.

Gjykata, konsideron se gjetjet gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e kanë vërtetuar veprën penale pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 i KPK, por në rastin konkret ka vërtetuar se të akuzuarit: 1) B.I. dhe Sh.I., kanë kryer veprën penale në vazhdimësi e në bashkëkryerje prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 268 paragrafi 4 lidhur me nenin 31 e 77 të KPK; 2) M.I., ka kryer veprën penale në vazhdimësi blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPK; 3) U.Q., ka kryer veprën penale në vazhdimësi blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPK dhe 4) A.Z., ka kryer veprën penale në vazhdimësi blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata, sa i përket ri-cilësimit të veprës penale për shkak të mos gjetjes së veprës penale të krimit të organizuar, do të elaborojë më poshtë.

Përtë ekzistuar vepra penale e krimit të organizuar, nevojitet të përmbushen disa parakushte apo karakteristika, të cilat karakteristika janë të akceptuara edhe në përkufizimin ligjor

të veprës penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga nen 277 të KPK.

Pra, për të ekzistuar krimi i organizuar, duhet të përmbushen katër karakteristika mandatore, pa të cilat nuk mund të ekzistojë krimi i organizuar si dhe së paku dy nga karakteristikat alternative të cilat e formojnë krimin e organizuar. Këto katër karakteristika bazë të krimit të organizuar janë: **1)** përfshirja e tre apo më shumë personave si grup i organizuar kriminal; **2)** për periudhë të gjatë ose të pacaktuar kohore; **3)** të dyshuar apo të dënuar për vepra penale të rënda (për të cilat përcaktohet dënimi me 4 katër vjet burgim apo më shumë) dhe **4)** me qëllim të përfitimit material apo të pushtetit.

Përpos karakteristikave mandatore për të ekzistuar krimi i organizuar, grupi i ekspertëve të KE, ka përcaktuar edhe karakteristikat alternative e të cilat duhet së paku dy nga to të plotësohen. Ku si karakteristika alternative konsiderohen: **1)** të ketë një rol ose detyrë të veçantë për secilin anëtar të grupit; **2)** përdorin ndonjë formë disipline ose kontrolli të brendshëm; **3)** përdorin dhunë ose forma tjera frikësuese; **4)** ushtrojnë ndikim te politika, mediat, administrata publike, organet e zbatimit të ligjit, etj.; **5)** përdorin strukturë tregtare ose të ngjashme me biznesin; **6)** janë të përfshirë në pastrim parash; **7)** operojnë në nivel transnacional.

Pra, këto janë karakteristikat-elementet kyçe që duhet të plotësohen për ekzistimin e veprës penale të krimit të organizuar, të cilat karakteristika-elemente i kanë akceptuar dhe instrumentet me të rëndësishme ndërkombëtare në definimin e krimit të organizuar, instrumentet e theksuara dhe në referencë të këtij aktgjykimi.

Me rëndësi është të theksohet se këto elemente a janë plotësuar në rastin konkret, respektivisht në veprimet e të akuzuarve në këtë çështje penale. Në raport me faktin se a janë plotësuar këto elemente në veprimet e të akuzuarve, gjykata do të elaborojë më poshtë:

- Nuk ka dilemë se në rastin konkret kemi të përfshirë në këtë vepër penale më shumë se tre persona, por nuk kemi të bëjmë me grup-kriminal të organizuar, por kemi të bëjmë me disa të akuzuar të cilët në bashkëkryerje e në vazhdimësi i kanë kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtorë. Pra në veprimet e tyre të ndërmarra në drejtim të kryerjes së veprës penale nuk është vërtetuar se këta të akuzuar kanë qenë grup i organizuar kriminal me strukturë të organizuar, strukturë të organizuar kriminale në drejtim të kryerjes së veprave penale për të cilat akuzohen. Për të ekzistuar krimi i organizuar, grupi prej tre e më shumë personave duhet të jetë grup kriminal i organizuar e jo një përbërje e thjeshtë prej tre e më shumë personave, pra jo si në rastin konkret ku të akuzuarit kanë pasur bashkëpunim ndërmjet vete në kryerjen e veprës penale apo veprave penale për të cilat janë shpallur fajtorë, ku këtë bashkëpunim e ka lidhur më shumë interesi në kryerjen e veprës penale, lidhje e tyre familjare e shoqërore e jo organizimi i tyre në stadin e një grupi të organizuar kriminal për të kryer vepra penale të rënda ashtu si kërkohet nga instrumentet ndërkombëtare të cilat e definojnë dhe sanksionojnë krimin e organizuar. Instrumentet ndërkombëtare të cilat po ashtu

janë të inkorporuar në legjislacionin tonë penal, respektivisht janë kërkesa të nenit 277 të KPK;

- *Grupi kriminal i organizuar është përcaktuar si grup i strukturuar i tre e më shumë personave i cili ekziston për një periudhë të caktuar kohore me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale, ndërsa në rastin konkret, gjykata, nga provat e administruara ka ardhur në përfundim se nuk kemi pasur një grup mirëfilli të organizuar me një strukturë udhëheqëse, ku definitivisht është ditur se kush është lideri i grupit, kush jep urdhër, kush janë zbatuesit e këtyre urdhrave dhe cilat janë detyrat e ndara për çdonjërin anëtar të grupit;*
- *Nga provat e administruara nuk vërtetohet se kush është lideri i grupit i cili jep urdhra dhe se anëtarët e tjerë i binden urdhrave të tij. Prokuroria Speciale me aktin akuzues të saj, të pandehurit i ka akuzuar për veprën penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 paragrafi 1 të KPK, që nënkupton se të gjithë të pandehurit janë të akuzuar për pjesëmarrje në krim të organizuar, por asnjëri nga ta nuk është i akuzuar për organizim dhe udhëheqje të krimit të organizuar ashtu si e kërkon paragrafi 2 i po këtij neni, e që nënkupton se të gjithë janë pjesëmarrës në krim të organizuar, mirëpo se kush e udhëheq këtë krim të organizuar nuk e ka potencuar fare në akt akuzues (pra askush nuk është akuzuar për rolin organizativ e të kontrollit të krimit të organizuar). Marrë në konsideratë se kërkesë-kriter i instrumenteve ndërkombëtare e po ashtu edhe i legjislacionit tonë është se për të ekzistuar krimi i organizuar duhet të ekzistojë organizata kriminale me udhëheqje, anëtarësi e me role të ndara-përcaktuara, andaj edhe në aktin akuzues prokuroria është dashur t'i qartësojë këto kërkesa ligjore, t'i provojë me prova dhe në fund gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor t'i vërtetojë si të mirëqena. Prokuroria me provat e parashtruara me aktin akuzues nuk ka vërtetuar këto fakte, respektivisht strukturën organizative të grupit kriminal të organizuar e as ekzistencën e këtij grupi, ku edhe me aktin akuzues të gjithë të akuzuarit i ka akuzuar për pjesëmarrje në krim të organizuar, por pa definuar strukturë organizative, pa definuar rolin e çdo të akuzuari brenda krimit të organizuar, pa definuar udhëheqjen e krimit të organizuar, pra pa i identifikuar elementet e kërkuara në paragrafin 1 e 2 të nenit 277 të KPK, për organizimin, themelimin, mbikëqyrjen e menaxhimin dhe pjesëmarrjen në krim të organizuar;*
- *Të akuzuarit kanë vepruar për një periudhë kohore të limituar dhe atë përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, mirëpo nuk mund të thuhet se kanë vepruar për një periudhë të gjatë kohore për ta ushtruar veprimtarinë kriminale, respektivisht nuk kanë vepruar për një periudhë kohore e cila mund të cilësohet si ndërmarrësi kriminale në drejtim të kryerjes së një vepre të një natyre të caktuar apo veprave të natyrave të ndryshme kriminale, me qëllimin e përfitimit material;*
- *Nga të lartë-theksuarat, me plot kuptim, gjykata ka vërtetuar se në rastin konkret nuk kemi pasur të bëjmë me ndonjë grup të organizuar kriminal, por me disa të akuzuar të cilët disa kanë vepruar së bashku por pa ndonjë organizim të mirëfillt në formë të*

krimet të organizuar. Andaj, gjykata ka bërë ri-cilësimin e veprës penale nga cilësimi juridik i bërë nga organi akuzës në veprat penale për të cilat janë shpallur fajtorë të akuzuarit, respektivisht vepra penale të narkotikëve por jo krim i organizuar [sic]."

LËNDA NR. 23

1. **Aktgjykim** PKR.nr.69/2021, datë 04.04.2022, nga Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.250/2022, datë 12.07.2022, dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin PML.nr. 405/2022, datë 22.11.2022.
2. **FJALË KYÇ:** I paraburgosur, marihuanë, pranim i fajësisë, substancë narkotike, zyrtar korrektues.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** I pandehuri SH.C., shtetas të Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Pejë, për veprën penale *"Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge"* nga neni 267 paragrafi 1 i KPK-së lidhur me nenin 275 paragrafi 2 nënparagrafi 1.8 të KPK-së, sepse, më 26.07.2020, rreth orës 15:50, në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, në qelinë e tij, pa autorizim e me qëllim të shpërndarjes është gjetur në posedim të substancës narkotike të llojit marihuanë, në atë mënyrë që kërkon nga zyrtari korrektues F.G., që t'i marrë disa gjëra ushqimore dhe të njëjtat t'i dërgojë te i paraburgosuri B.S. Zyrtari korrektues pranon t'i marrë këto gjëra por ato paraprakisht kontrollohen edhe në prani të zyrtarëve tjerë. Ndër këto ishte edhe një pako me cigare të llojit *"Rothmans"*, ndërsa një nga cigaret rezultoi të ishte e mbushur me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë neto prej 0.1 g.
4. **GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin e ka shpallur fajtor për veprën penale *"Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge"* nga neni 267 paragrafi 1 i KPK-së lidhur me nenin 275 paragrafi 2 nënparagrafi 1.8 të KPK-së dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë 200 (dyqind) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje 1 (një) vjet, duke urdhëruar konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike.
5. **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e avokatit mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme që është ngritur në këtë lëndë ka të bëjë me atë se, a konsiderohet se janë realizuar tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale *"Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge"* nga neni 267 paragrafi 1 i KPK-së lidhur me nenin 275 paragrafi 2 nënparagrafi 1.8 të KPK-së kur bëhet fjalë për sasi të vogël të substancës

narkotike, përkatësisht sasi prej 0.1 g, apo nëse veprimi i të pandehurit do të duhej të vlerësohej si vepër penale e rëndësisë së vogël.

7. **GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se në veprimet e të pandehurit janë realizuar tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale *"Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge"* nga neni 267 paragrafi 1 i KPK-së lidhur me nenin 275 paragrafi 2 nënparagrafi 1.8 të KPK-së dhe duke marrë parasysh mënyrën e të vepruarit dhe vendin e veprimit rezulton se nuk bëhet fjalë për vepër penale të rëndësisë së vogël.
8. **PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS:** *Për sa i përket pretendimeve të paraqitura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, se në rastin konkret nuk janë realizuar elementet e veprës penale për të cilin i pandehuri është shpallur fajtor dhe se për shkak të peshës së vogël të substancës narkotike dhe mundësisë së ndikimit të saj në shëndetin e personave të tjerë, vepra penale do të duhej të cilësohet si vepër penale e rëndësisë së vogël dhe me këtë i pandehuri do të duhej të lirohet nga akuza, Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin e saj fillimisht ka cituar dispozitën e nenit 11 të KPK-së, dhe pastaj në mënyrë të hollësishme ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë realizuar elementet e veprës penale për të cilën i pandehuri ishte shpallur fajtor dhe ishte dënua. Sipas arsyetimit të aktgjykimin të Gjykatës Supreme e Kosovës konstatohet se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet që veprimet e të pandehurit të cilësoheshin si vepër penale e rëndësisë së vogël, pasi në rastin konkret rrezikshmëria nuk mund të konsiderohet e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës penale, ngase për këtë vepër penale dënimi është mjaft i lartë, përkatësisht 3-15 vjet burgim. Për më tepër, vepra penale është kryer brenda institucionit korrektues, që është përcaktuar si formë e veçantë e inkriminimit në kuadër të këtij kapitulli të veprave penale. Përtej kësaj, shpërndarja e lëndës narkotike, ndonëse në sasi të vogël, megjithatë paraqet rrezikshmëri dhe pasoja të dëmshme për shëndetin e gjithashtu nuk janë realizuar as kushtet e tjera të përcaktuara të veprave penale e rëndësisë së vogël që ndërlidhen me shkallën e përgjegjësisë, karakteristikat dhe rrethanat personale të kryesit të kësaj vepre penale.*

LËNDA NR. 24

1. **Aktgjykim** PKR.nr.848/2020, datë 17.05.2021, nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special.
2. **FJALË KYÇ:** Armë, bashkëkryerje, dënim me burgim, eksport, import, krimi i organizuar, ndihmë, posedim.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** Të pandehurit M.D., A.K., shtetas të Kosovës, janë akuzuar nga Prokuroria Speciale e Kosovës, për veprën penale *"Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar"* nga neni 283 paragrafi 1 i KPK-së lidhur me veprën penale *"Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e*

paautorizuar e armëve” nga neni 372 paragrafi 2 i KPK-së. Gjithashtu, të akuzuarve M.D., e A.K., secilit veç e veç, i është vënë në ngarkim vepra penale *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”* nga neni 374 paragrafi 1 i KPK-së. Të akuzuarit janë shpallur fajtorë si vijon:

I. Të akuzuarit M.D., dhe A.K.,

Sepse, duke vepruar në bashkëkryerje me A.V., kundër të cilit procedura penale është zhvilluar në SHBA, me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë të dobisë pasurore, kanë kryer veprën penale të trafikimit me armë, të cilësuar si e rëndë, me ndihmën e të akuzuarit D.P. Gjatë muajve prill/maj 2017, në territorin e SHBA-së, agjenti nën mbulim i Agjencisë Amerikane Anti-Drogë (Drug Enforcement Administration, shkurt DEA), ka lidhur marrëveshje me A.V., për blerjen e 15 (pesëmbëdhjetë) armëve automatike kinse për narko-bandat në Meksikë, me çmim 900 dollarë/copë dhe për këtë i ka paguar shumën 13.500 dollarë. Nga këto të holla, A.V., më 23.05.2017, përmes *“Money Gram”* i ka dërguar të akuzuarit M.D., 2.000 (dymijë) dollarë si parapagesë, e pastaj më 04.06.2017 ka ardhur në Kosovë, dhe:

- I.1. - më 11.06.2017, i akuzuari M.D., me A.V., duke drejtuar veturën me targa çeke, me dokumente personale çeke, ka kaluar nga Shqipëria në Kosovë duke sjellë dërgesën e parë të armëve,
- I.2. - pesë ditë më vonë, më 16.06.2017, i akuzuari M. D., së bashku me A.V., nga auto-salloni *“Muriqi Rent”* në Pejë, ka marrë me qira makinën e tipit *“BMW X5”* (fuoristradë), me ngjyrë të gjelbër, me të cilën ka planifikuar të dorëzojë dërgesën e parë, ashtu që
- I.3. - dy ditë më vonë, më 18.06.2017, në orën 14:30, me këtë makinë të akuzuarit M.D., A.K., së bashku me A.V., kanë shkuar në *“BBB”* që të takohen me *“blerësin e armëve”* (agjentin nën mbulim), i cili ishte duke e zbatuar masën e fshehtë të blerjes së simuluar në koordinim me policinë amerikane, me ç’rast të akuzuarit M.D., dhe A.K., kanë mbetur të presin në makinë, ndërsa A.V., ka hyrë në kafeteri dhe është takuar me atë person,
- I.4. - pasi personi i prezantuar si blerës është pajtuar me propozimin e A.V., që dorëzimi të kryhet në të njëjtën ditë në parkingun e marketit *“XXX”* afër Klinës, gjysmë ore më vonë, të akuzuarit M.D., dhe A.K., së bashku me A.V., kanë shkuar të vëzhgojnë me makinë parkingun e marketit *“XXX”* duke lëvizur me shpejtësi të ngadaltë,
- I.5. - të njëjtën ditë, rreth orës 18:15, pas marrëveshjes paraprake me pjesëtarin e Policisë së Kosovës që po vepronte si agent nën mbulim, duke e zbatuar masën e fshehtë të blerjes së simuluar në koordinim me policinë amerikane, i akuzuari A.K., me A.V., kanë mbërritur në parking të marketit *“XXX”* në Klinë me veturë të tipit *“BMW X5”*, me ngjyrë të gjelbër. Këtë veturë paraprakisht e

kishte marrë me qira i akuzuari M.D., nga auto-salloni “Muriqi Rent” në Pejë. Nga bagazhi i veturës i kanë nxjerrë 6 (gjashtë) armë të gjata “AK-47” dhe një karikator të zbrazët për armë të gjata, të vendosura në një çantë të plastikës, dhe të njëjtat ia kanë dorëzuar agjentit nën mbulim, i cili i ka futur në bagazhin e makinës së tipit “Pasar” me targa 334-KS-587, e pastaj të gjithë janë larguar,

- I.6. - pasi i akuzuari M.D., nën mbikëqyrjen e A.V., e ka siguruar pjesën tjetër të armëve, më 27.06.2017, rreth orës 19:00, në vendin e lartshënuar, të akuzuarit A.K., dhe D.P., kanë ardhur me makinën “Audi A3”, me targa 03-944-EJ, me ngjyrë hiri të mbyllur, pronë e të akuzuarit D.P., të cilën e ka drejtuar A.K., janë ndalur në parking, pastaj i akuzuari A.K., nga bagazhi i makinës i ka nxjerrë 8 (tetë) pushkë automatike “AK-47” me nga një karikator, një mjet anti-tank dore (zollë) me një projektil 64 mm në të, si dhe 3 (tre) karikatorë të zbrazët, të gjitha të vendosura në një qese të zezë dhe të njëjtat i ka futur në bagazhin e makinës së tipit “Audi A4” me targa 05-136-BM të agjentit nën mbulim, ndërsa i akuzuari M.D., tërë ngjarjen e ka mbikëqyrë nga restoranti disa metra më larg. Pastaj i akuzuari A.K., përsëri ka hyrë në makinë dhe është nisur, ndërsa i akuzuari D.P., ka hyrë në restorant për t’iu bashkangjitur të akuzuarit M.D., por disa çaste më vonë të gjithë janë arrestuar,
- me këtë kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje me A.V., të përcaktuar si *“Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve”* nga neni 372 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPK-së,

II. I akuzuari D.P.

Sepse, më 27.06.2017, me dashjen për të ndihmuar të akuzuarin A.K., për transportimin e armëve (të precizuara si në dispozitivin nën pikën I.6) nga Peja në Klinë, ka vënë në dispozicion makinën e tij të tipit “Audi A3”, me ngjyrë hiri të mbyllur, me targë regjistrimi 03-944-EJ, si mjet transporti, ashtu që nga Peja në Klinë kanë shkuar bashkë me të akuzuarin A.K., makinën e ka drejtuar A.K., dhe, rreth orës 19:00 kur edhe kanë mbërritur në parkingun e marketit “Nora”, ka dalë nga makina, është përshëndetur me *“blerësin e armëve”* dhe pas ngarkimit të armëve nga makina e tij në makinën e *“blerësit të armëve”*, ka vazhduar për në restorant për t’iu bashkangjitur të akuzuarit M.D., dhe disa çaste më vonë të gjithë janë arrestuar,

- me këtë ka dhënë ndihmë për kryerjen e veprës penale *“Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve”* nga neni 372 paragrafi 2 lidhur me nenin 33 të KPK-së.

4. GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI SPECIAL, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurit i ka shpallur fajtorë për veprën penale në bashkëkryerje dhe vazhdimësi, të përcaktuar si *“Importi, eksporti, furnizimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose*

shitja e paautorizuar e armëve apo mjeteve plasëse” nga neni 372 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPK-së dhe u ka shqiptuar dënimet vijuese: të akuzuarin M.D., dënim me gjobë 7.000 (shtatë mijë) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje 6 (gjashtë) vjet; të akuzuarin A.K., për veprën penale si në pikën I të aktakuzës, në bashkëkryerje me A.V., për veprën penale *“Importi, eksporti furnizimi, transportimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve”* nga neni 372 paragrafi 2 i KPK-së, dënim me gjobë 3.000 (tremijë) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje 4 (katër) vjet e 8 (tetë) muaj, kurse për veprën penale nga pika II e dispozitivit të aktakuzës, *“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armës”* nga neni 374 paragrafi 1 i KPK-së, dënim me gjobë 500 (pesëqind) euro; të akuzuarin D.P., dënim me gjobë 3 (tremijë) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje 2 (dy) vjet. Tutje, të akuzuarve u është shqiptuar dënim plotësues duke urdhëruar konfiskimin e përhershëm të sendeve-armëve të sekuestruara të precizuara si në formularët e provave, si objekt i veprës penale apo mjete për kryerjen e veprës penale, dhe atë: tetë pushkë automatike AK-47 me nga një karikator, tre karikatorë të zbrazët, një mjet anti-tank i dorës (zollë) me një projektil 64 mm, gjashtë pushkë automatike AK-47 dhe një karikator i zbrazët për armë të gjata; nga i akuzuari A.K., një pushkë ajrore, pa numër serie; nga i akuzuari D.P., një makinë ngjyrë hiri, e tipit “Audi A3”; nga i akuzuari M.D., shuma e parave prej 1.653,93 (një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre euro e nëntëdhjetë e tre cent).

5. **GJYKATA E AELIT E KOSOVËS**, me aktgjykimin e lartcekur, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e paraqitura nga PSK-ja dhe avokatët mbrojtës të të dënuarve dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.
6. **ÇËSHTJA LIGJORE:** Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme që është ngritur në këtë lëndë ka të bëjë me atë se, a konsiderohen veprimet e të pandehurve vepër penale në bashkëkryerje dhe vazhdimësi e përcaktuar si *Importi, eksporti, furnizimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armëve apo mjeteve plasëse* nga neni 372 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPK-së apo nëse sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Kosovës me veprimet e të pandehurve janë realizuar elementet e veprës penale *“Pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar”* nga neni 283 paragrafi 1 i KPK-së lidhur me veprën penale *“Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”*, nga neni 372 paragrafi 2 i KPK-së.
7. **GJETJET KRYESORE:** Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se në veprimet e të pandehurve nuk janë realizuar tiparet e veprës penale *“Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”* dhe ka konsideruar se në veprimet e të pandehurve janë realizuar elementet e veprës penale, në bashkëkryerje dhe vazhdimësi, të përcaktuar si *“Importi, eksporti, furnizimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armëve apo mjeteve plasëse”* nga neni 372 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPK-së, pasi nuk janë konfirmuar elementet e nevojshme që kjo çështje të trajtohet si vepër penale e krimit të organizuar dhe nuk është provuar cilësimi juridik i dhënë në aktakuzën e paraqitur nga PSK-ja, përkundër faktit se kjo çështje penale

ka qenë mjaft interesante pasi bëhet fjalë për vepër penale të trafikimit me armë në disa shtete duke filluar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përmes Çekisë dhe duke përfunduar në Kosovë.

8. PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

– DEPARTAMENTI SPECIAL: Në përmbyllje të aktgjykimit thuhet: “[S]a i përket veprës penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par. 1 të KPK, ligjvënësi përcakton se kushdo që me dashje dhe me dijeni qoftë të qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për të kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim prej së paku katër (4) vjet, aktivisht merr pjesë në veprimtaritë kriminale të grupit duke ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuojë në realizimin e veprimtarive kriminale të grupit.

Ndërsa në nenin 120 të KPK te Përkufizimet e termeve, termi “Grupi kriminal i organizuar” përkufizohet si - bashkimi i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, i tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore. Në të njëjtin nen termi Bashkim i strukturuar përkufizohet si - bashkim i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të veprës penale, por nuk është e nevojshme që anëtarët e këtij bashkimi të kenë role formalisht të përcaktuara, vazhdimësi të anëtarësisë së tyre apo strukturë të ndërtuar.

Bazuar në elementet e veprës penale të krimit të organizuar, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje penale nuk është plotësuar elementi kryesor i pjesëmarrjes së paku i tre personave të kenë vepruar një kohë të caktuar me dashje për kryerjen e veprimtarisë kriminale të grupit të organizuar dhe strukturuar, kjo për faktin se A V për veprimet inkriminuese në Kosovë, ishte gjykuar jo nga gjykata federale por nga gjykata e Rrethit të New York-ut për vepër penale “**Conspiracy**” e jo krim të organizuar. Pra gjykata nuk vërtetoi se të njëjtit kanë vepruar në formën dhe mënyrën e paraparë me ligj për ekzistimin e krimit të organizuar, nuk vërtetoi se të akuzuarit kanë marrë pjesë aktivisht në aktivitetin e grupit të organizuar kriminal, ngase të njëjtit nuk kanë qenë të vetëdijshëm se pjesëmarrja e tyre do t’i kontribuonte kryerjes së krimeve të rënda si pjesë e grupit, andaj konform nenit 360 par.2 të KPP për të akuzuarit M dhe A bëri rikualifikimin ligjor të veprës penale duke i shpallur fajtor vetëm për vepër penale bazë të kryer në bashkëkryerje Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve nga neni 372 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPK, të cilën vepër e kanë bërë me dije dhe me dashje, përkatësisht kanë qenë të vetëdijshëm për qëllimin e furnizimit, transportimit apo shitjes së armëve dhe pasojën e ndaluar të veprimeve të tyre të kundërligjshme, por këtë qëllim e kanë dashur. [sic]”

**LËNDA NR. 25**

1. **Aktgjykim PKR.nr.136/2022, datë 21.07.2022, nga Gjykata Themelore në Prishtinë** - Departamenti për Krime të Rënda, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.535/2022, datë 24.03.2023, aktgjykime këto, të ndryshuara nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.262/2023, datë 13.07.2023.
2. **FJALË KYÇ:** Dënim me burgim, narkotikë, pa autorizim, substanca psikotrope.
3. **PËRMBLEDHJE E LËNDËS:** Të pandehurit I.S., dhe M.S., janë akuzuar për veprën penale në bashkëkryerje, të përcaktuar si *"Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge"* nga neni 267 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të KPK-së, sepse në bazë të marrëveshjes paraprake, me dashje e me qëllim të shitjes, më 01.10.2020, rreth orës 22:00, nga Serbia me veturën e tipit "Golf IV", ngjyrë hiri, pronë e A.O., të cilën e ka drejtuar i pandehuri M.S., pa autorizim kanë importuar substanca narkotike. Ndërsa, më 02.10.2020, rreth orës 15:40, gjatë një kontrolli nga ana e pjesëtarëve të policisë në shtëpinë dhe objektet përcjellëse, pronë e M.G., që është vjehrra e të pandehurit I.S., pronë kjo që e ka shfrytëzuar i pandehuri I.S., dhe gjendet në fshatin Gushtericë e Ulët, Komuna e Graçanicës, pas katër orë kontrolli në një hapësirë tip "bunker" që e kishin bërë në bodrumin e shtëpisë, nën pllaka, janë gjetur dhe sekuestruar: katër qese najloni me kërpudha narkotike që përmbajnë narkotik të llojit psilocinë, me peshë 76,31 g, 62,26 g, që përmbajnë psilocinë dhe gjurmë të amfetaminës, dhe 95,06 g amfetaminë dhe psilocinë, tre kavanoza qelqi me substancë narkotike, 3,4 g metilendioksimetafetaminë, me peshë 153,19 g, dy kavanoza qelqi me epruvetë me substancë narkotike të llojit amfetaminë të përzier me kafeinë me vëllim 21 ml, dhe substancë narkotike e llojit marihuanë me peshë të përgjithshme prej 3,40 g, dhe para të gatshme (4305 €) të cilat ishin të fshehura së bashku me substancat narkotike.
4. **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurit i ka shpallur fajtorë, për veprën penale në bashkëkryerje, të përcaktuar si *"Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge"* nga neni 267 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe secilit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje 3 (tre) vjet dhe dënim me gjobë 1000 (njëmijë) €. Tutje, gjykata u ka shqiptuar dënimin plotësues, duke urdhëruar konfiskimin e sa vijon: katër qese najloni me kërpudha që përmbajnë narkotik të llojit psilocinë, me peshë 76,31 g, 62,26 g, që përmbajnë narkotik të llojit psilocinë dhe gjurmë të amfetaminës dhe 95,06 g amfetaminë dhe psilocinë, tre kavanoza qelqi me substancë narkotike, 3,4 g metilendioksimetafemitsminë, me peshë 153,19 g, dy kavanoza qelqi me epruvetë me substancë narkotike të llojit amfetaminë të përzier me kafeinë me vëllim 21 ml, dhe substancë narkotike e llojit

marihuanë me peshë të përgjithshme prej 3,40 g, dhe para të gatshme në shumë prej 4305 €.

5. ÇËSHTJA LIGJORE: Njëra nga çështjet ligjore të rëndësishme në këtë lëndë që është ngritur nga mbrojtja ka të bëjë me atë se, a konsiderohen veprimet e të pandehurve vepër penale, përkatësisht theksohet fakti se gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin penal në dëm të të pandehurve pasi nuk është vërtetuar se kishin kryer veprimet inkriminuese për të cilat ishin shpallur fajtorë dhe ishin dënuar.

6. GJETJET KRYESORE: Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se me veprimet e të pandehurve janë realizuar elementet e veprës penale në bashkëkryerje dhe për këtë arsye të njëjtit i ka shpallur fajtorë. Gjithashtu edhe gjykata e shkallës së dytë i kishte refuzuar si të pabazuara ankesat e avokatëve mbrojtës të të dënuarve dhe kishte vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Mirëpo, Gjkata Supreme e Kosovës me rastin e shqyrtimit të kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë ka konstatuar se dy gjykatat e instancave më të ulëta gjyqësore kanë shkelur ligjin penal në dëm të të pandehurve, andaj edhe i ka liruar të pandehurit nga akuza duke i shpallur të pafajshëm.

7. PJESË NGA ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

– DEPARTAMENTI SPECIAL: Duke vlerësuar provat, Gjkata Supreme e Kosovës ndryshoi aktgjykimet e kundërshtuara dhe aktgjykimet dënuese të nxjerra nga dy instancat më të ulëta gjyqësore i ndryshoi dhe të pandehurit i liroi nga akuza për këtë vepër penale, meqë nuk ishin vërtetuar veprimet inkriminuese të të pandehurve, me arsyetimin si në vijim: *“Gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore aktgjykimet e tyre dënuese i mbështesin në prova materiale dhe në dëshminë e dëshmitarit – zyrtarit të policisë së Kosovës i cili kishte qenë në ndërrim natën kur të pandehurit kanë kaluar pikën kufitare nga Serbia në Kosovë. Por në këtë rast shtrohet një çështje e rëndësishme se në fakt çka vërtetuan provat e administruara nga aspekti subjektiv, përkatësisht a vërtetuan faktin se ishin pikërisht të pandehurit që kishin bërë importimin e lëndës narkotike nga Serbia në Kosovë.*

Konstatimet e gjykatës së shkallës së parë e të vërtetuara edhe nga gjykata e shkallës së dytë përkitazi me veprimet e të pandehurve nuk janë të qëndrueshme, dhe për më tepër, as të bazuara në provat që gjenden në shkresat e lëndës, meqë provat materiale vetëm se kanë vërtetuar anën objektive të veprës penale dhe atë se: bëhej fjalë për lëndë narkotike të sasisë dhe llojit të përcaktuar (raporti i ekspertimit), se lënda narkotike ishte gjetur në shtëpinë e M.G. në fshatin Gushtericë, Komuna e Graçanicës (procesverbali i kontrollit dhe fotografitë e vendit të ngjarjes). Kurse nga dëshmia e dëshmitarit – zyrtarit policor nuk është vërtetuar asnjë fakt i rëndësishëm pos se të pandehurit kishin kaluar pikën kufitare në Merdare dhe i cili nuk është kontestuar as nga vetë të pandehurit, por dëshmitari nuk kishte shprehur ndonjë dyshim për importim të lëndës narkotike, meqë edhe nuk ishte bërë as kontrolli i ashtuquajtur e vijës së dytë që bëhet nga tjetër njësi në rast të dyshimit.

Por nga faktet e lartë cekura nuk kanë vërtetuar me asnjë provë anën subjektive, përkatësisht përfshirjen e të pandehurve në kryerjen e veprës penale dhe atë se: në veturën që e drejtonte i pandehuri M. S., kishte lëndë narkotike, meqë po të dyshohej në diçka të tillë si është e mundur të lejohet kalimi i saj nga pika kufitare në Merdare deri në fshatin Gushtericë, Komuna e Graçanicës. Edhe nën supozimin se policia hetimore kishte dyshime se të pandehurit kishin importuar lëndën narkotike dhe ishin nën përcjellje të tyre, atëherë rrjedh një pyetje e thjeshtë se si u lejua që kjo sasi e lëndës narkotike të dërgohej deri në shtëpinë e M.G., në fshatin Gushtericë, Komuna e Graçanicës, dhe për më tepër, si u lejuar që të fshihej në bunker në dyshemenë e bodrumit të shtëpisë dhe pastaj e njëjta të kërkohej për katër orë deri në zbulimin e saj.

Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga përshkrimi i theksuar më lart dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton se në rastin konkret nuk është provuar me asnjë provë se në veprimet e të pandehurve janë realizuar [asnjë nga] tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në fjalë dhe i cili konkluzion rezulton nga analiza e dispozitës së nenit 267 par.3 të KPK-së e cila ka përcaktuar se: "Kushdo që pa autorizim eksporton ose importon substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge..."

Përshkrimin e veprës penale duhet interpretuar në tërësinë e saj, përkatësisht në të gjitha elementet e saj dhe jo në mënyrë fragmentare, andaj, fillimisht është e rëndësishme të përcaktohen elementet e kësaj vepre penale dhe më pas të konstatohet se a janë përmbushur apo jo elementet e kërkuara dhe atë: së pari duhet të përcaktohet fakti se a importuan të pandehurit lëndët narkotike dhe në fakt ky është elementi themelor i kësaj vepre penale, kurse faktet tjera se lënda ishte narkotike është fakt i pakontestueshëm dhe i panevojshëm për trajtim të mëtejshëm.

Gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar edhe mbrojtjen e të pandehurve, por, nuk ka dhënë arsye se pse nuk i besoi versionit të mbrojtjes së tyre. Në këtë pikë janë të rëndësishme të potencohen tri aspekte: së pari, të njëjtit natyrshëm e kanë mohuar kryerjen e kësaj vepre penale që është më se e pritshme kur bëhet fjalë për një vepër të kësaj natyre, së dyti, është e rëndësishme të potencohet fakti se të njëjtit ishin konsistentë në mbrojtjen e tyre, dhe për më tepër, paraqitën argumente të tyre përkitazi me lëvizjen e shpeshtë të tyre në relacionin Serbi- Kosovë, ndonëse për të pandehurin I.S., kjo paraqet një rrethanë normale duke marrë për bazë se i njëjti është edhe shtetas i Kosovës dhe rrethanën përkitazi me gjendjen shëndetësore dhe qëndrimin në spital të bashkëshortes së tij e konfirmuan edhe përmes raporteve mjekësore. Megjithatë, përtej këtyre aspekteve, del se në mbrojtjen e të pandehurve ishte bërë një qasje e njëanshme dhe tërësisht jo objektive; mjafton të theksohet fakti se mbrojtja e tyre ishte hedhur poshtë në tërësi si e paqëndrueshme ndonëse në shumë aspekte vërtetohet edhe me provat materiale të administruara, pra nuk është bërë një bashkëdyzim mes mbrojtjes së të pandehurve dhe provave materiale.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se nga provat e administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk është vërtetuar se autorët e veprës penale ishin të pandehurit dhe siç është theksuar në këtë çështje penale nuk ka pasur as edhe një provë të vetme. Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës vëren se ndikim të rëndësishëm në ndërtimin e rastit paraqet personaliteti i të pandehurve, pra vetë faktin se të njëjtit ishin të dënuar më parë për vepra të kësaj natyre dhe kjo padyshim se ishte rrethanë me ndikim edhe në epilogun e dy instancave më të ulëta gjyqësore e që kjo konsiderojmë se shkeli parimin e prezumimit të pafajësisë, siç është konstatuar në disa raste nga ana e GJEDNJ e që ndër to, do t'i referohemi rastit Allenet De Ribemont kundër Francës, aktgjykimi i datës 10.02.1995, seria A, NO 308, ku theksohet se: "e rëndësishme është se prezumimi i pafajësisë nga neni 6/2 të KEDNJ, nuk përfshin ndalesën që gjykata të informohet me të dhënat mbi çështjet gjyqësore të të pandehurit nga evidenca e të dënuarve. Në parim gjykatat nacionale mund të informohen mbi të gjitha rrethanat, të cilat janë të ndërlidhura me personalitetin e të pandehurit dhe që mund të kenë ndikim në matjen e dënimit, por jo në vërtetimin e përgjegjësisë penale", siç në fakt është vepruar në rastin konkret ku pikërisht e kaluara e tyre ka qenë edhe bazë për fajësinë e tyre. Ngjashëm edhe në rastin tjetër për të kuptuar më mirë shkallën e shtrirjes së këtij prezumimi kjo gjykatë në rastin Nollenbockhoff kundër Gjermanisë -aktgjykimi i GJEDNJ, të datës 25.08.1987, seria A 123 shprehet: "I pandehuri ka vdekur pasi është marrë aktgjykimi dënues kundër të cilit është ushtruar ankesë. Trashëgimtarët e tij kanë kërkuar nga shteti kompensimin e shpenzimeve të mbrojtjes gjatë procedurës, mirëpo gjykata gjermane kërkesëpadinë e tillë e ka refuzuar me arsyetimin se gjykata e shkallës së dytë sigurt se do ta kishte vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë". Pra, rrjedhimisht në të dy këto raste është konstatuar se me një qëllim të tillë është shkelur prezumimi i pafajësisë të cilin e garanton neni 6/2 i GJEDNJ [sic]."

Të dhëna statistikore

5

Në këtë pjesë të përmbledhjes janë paraqitur disa të dhëna të rëndësishme statistikore në lidhje me lëndët e veprave penale të armëve gjatë viteve 2020-2023, të cilat janë trajtuar nga gjykatat themelore në Kosovë.

Tabela nr. 1

Neni 364 i KPK-së
IMPORTI, EKSPORTI, FURNIZIMI, TRANSPORTIMI, PRODHIMI, KËMBIMI,
NDËRMJETËSIMI OSE SHITJA E PAAUTORIZUAR E ARMËVE APO MATERIEVE
PLASËSE

Viti	Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuar	Lëndë në punë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të mbetura	Aktgjykim fajësues	Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Mënyrë tjetër
2020	14	8	22	11	11	9	1	0	1
2021	11	13	24	12	12	10	1	0	1
2022	12	6	18	5	13	5	0	0	0
2023	13	10	23	8	15	6	0	2	0
Gjithsej	50	37	87	36	51	30	2	2	2

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 1, shihet që gjatë viteve 2020-2023, në gjykatat themelore të Kosovës janë ngritur 37 aktakuza për veprën penale "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo mjeteve plasëse" të parashikuar me nenin 364 të KPK-së, ndërsa janë zgjidhur 36 lëndë të tilla.

Nga 36 lëndët e zgjidhura, rezulton se në 30 lëndë të pandehurit janë shpallur fajtorë me aktgjykim fajësues; në 2 lëndë të pandehurit janë liruar nga akuza me aktgjykim lirues; në 2 lëndë është refuzuar akuza me aktgjykim refuzues, kurse në 2 lëndë është vendosur në mënyrë tjetër.

Tabela nr. 2

Neni 366 i KPK-së

MBAJTJA NË PRONËSI, KONTROLL OSE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE

Viti	Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuar	Lëndë në punë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të mbetura	Aktgjykim fajësues	Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Mënyrë tjetër
2020	673	697	1370	715	655	668	3	4	40
2021	655	824	1479	843	636	804	8	14	17
2022	636	808	1444	728	716	713	4	1	10
2023	716	749	1465	539	926	520	3	2	14
Gjithsej	2680	3078	5758	2825	2933	2705	18	21	81

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 2, shihet që gjatë viteve 2020-2023, në gjykatat themelore të Kosovës janë ngritur 3078 aktakuza për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” të parashikuar me nenin 366 të KPK-së, ndërsa janë zgjidhur 2825 lëndë të tilla.

Nga 2825 lëndët e zgjidhura, rezulton se në 2705 lëndë të pandehurit janë shpallur fajtorë me aktgjykim fajësues; në 18 lëndë të pandehurit janë liruar nga akuza me aktgjykim lirues; në 21 lëndë është refuzuar akuza me aktgjykim refuzues, kurse në 81 lëndë është vendosur në mënyrë tjetër.

Nga tabela e lartcekur, shihet se në fillim të vitit 2024, janë bartur si lëndë të pakryera 2933 lëndë që kanë të bëjnë me veprën penale të lartcekur.

Tabela nr. 3
Neni 367 i KPK-së
PËRDORIMI I ARMËS APO MJETIT TË RREZIKSHËM

Viti	Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuar	Lëndë në punë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të mbetura	Aktgjykim fajësues	Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Mënyrë tjetër
2020	143	75	218	94	124	88	1	1	4
2021	124	64	188	81	107	77	2	1	1
2022	107	35	142	49	93	47	1	1	0
2023	93	49	142	44	98	39	1	0	4
Gjithsej	467	223	690	268	422	251	5	3	9

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 3, shihet që gjatë viteve 2020-2023, në gjykatat themelore të Kosovës janë ngritur 690 aktakuza për veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” të parashikuar me nenin 367 të KPK-së, ndërsa janë zgjidhur 268 lëndë të tilla, kurse në fund të vitit 2023, kanë mbetur të pazgjidhura edhe 422 lëndë të tilla.

Nga 268 lëndët e zgjidhura, rezulton se në 251 lëndë të pandehurit janë shpallur fajtorë me aktgjykim fajësues; në 5 lëndë të pandehurit janë liruar nga akuza me aktgjykim lirues; në 3 lëndë është refuzuar akuza me aktgjykim refuzues, kurse në 9 lëndë është vendosur në mënyrë tjetër.

Tabela nr. 4**Neni 368 i KPK-së****LEJET, PËLQIMET DHE LICENCAT E RREME TË ARMËVE
DHE DHËNIA E INFORMATAVE TË RREME**

Viti	Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuar	Lëndë në punë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të mbetura	Aktgjykim fajësues	Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Mënyrë tjetër
2020	3	1	4	3	1	2	0	0	1
2021	1	1	2	1	1	1	0	0	0
Gjithsej	4	2	6	4	2	3	0	0	1

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 4, shihet që gjatë viteve 2020-2021, në gjykatat themelore të Kosovës janë ngritur 2 aktakuza për veprën penale “Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave të rreme” të parashikuar me nenin 368 të KPK-së; 4 lëndë janë bartur si të pakryera nga vitet e mëparshme, ndërsa gjatë viteve 2020-2021 janë zgjidhur 4 lëndë të tilla.

Nga 4 lëndët e zgjidhura, rezulton se në 3 lëndë të pandehurit janë shpallur fajtorë me aktgjykim fajësues; kurse në 1 lëndë është vendosur në mënyrë tjetër.

Është me rëndësi të theksohet se gjatë viteve 2022 dhe 2023, nuk rezulton të jetë ngritur ndonjë aktakuzë për këtë vepër penale.

Tabela nr. 5**KAPITULLI XXIX****VEPRAT PENALE TË ARMËVE GJYKATAT THEMELORE TË KOSOVËS 2020 - 2023**

Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuar	Lëndë në punë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të mbetura	Aktgjykim fajësues	Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Mënyrë tjetër e vendosjes
833 Fillimi i vitit 2020	3340	4173	3133	1040	2989	25	26	93

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 5, shihet që gjatë viteve 2020-2023, në gjykatat themelore të Kosovës janë ngritur 3340 aktakuza për vepra penale nga *Kapitulli XXIX – Veprat penale të armëve*, ndërsa janë zgjidhur 3133 lëndë të tilla.

Nga 3133 lëndët e zgjidhura, rezulton se në 2989 lëndë ose në 93.6% të lëndëve të zgjidhura, të pandehurit janë shpallur fajtorë me aktgjykim fajësues; në 25 lëndë, të pandehurit janë liruar nga akuza me aktgjykim lirues; në 26 lëndë është refuzuar akuza me aktgjykim refuzues, kurse në 93 lëndë është vendosur në mënyrë tjetër.²⁸

Është me rëndësi të theksohet se nga të dhënat e siguruar, gjatë viteve 2020-2023, nuk rezulton të jetë ngritur ndonjë aktakuzë për veprën penale *“Fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë të zjarrit apo në municion”* të parashikuar me nenin 365 të KPK-së apo për veprën penale *“Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale”* të parashikuar me nenin 369 të KPK-së.

28 Të dhënat e paraqitura në këto tabela janë siguruar nga Departamenti i Statistikave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Konkluzione

6.1. Shqyrtime të përgjithshme

Në mënyrë tradicionale, në KPK është përfshirë një kapitull i posaçëm i veprave penale të armëve. Kjo për shkak të faktit se armët zakonisht paraqesin mjete të rrezikshme dhe si të tilla nuk mundësohet që qytetarët t'i posedojnë në mënyrë të lirshme. Posedimi i tyre është i kushtëzuar me marrjen e lejeve përkatëse nga organet kompetente. KPK-ja ka përcaktuar format themelore të inkriminimit ligjor, kurse me qëllim të qartësisimit se çfarë konsiderohet “armë”, në dispozitën e nenit 113, paragrafi 1, nën-paragrafi 40 të KPK-së janë përkufizuar, përcaktuar dhe kategorizuar armët dhe llojet e tyre. Kurse pjesët përbërëse të veprave penale të armëve janë përcaktuar përmes normave “blanketë” të cilat mbështeten në Ligjin nr. 05/L-022 për armët, si dhe në Udhëzimet Administrative të nxjerra nga Ministria e Punëve të Brendshme. Po ashtu, në dispozitat ligjore janë përfshirë disa aspekte të rëndësishme të veprimtarive me armë duke filluar nga importi, eksporti, mbajtja, përdorimi dhe prodhimi i tyre. Këto inkriminime ligjore janë sistemuar përmes dispozitave përkatëse ligjore.

Në këtë kapitull përfshihen gjashtë vepra penale: *Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse* (neni 364), *Fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë të zjarrit apo në municion* (neni 365), *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* (neni 366), *Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm* (neni 367), *Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave të rreme* (neni 368) dhe *Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale* (neni 369).

Karakteristikë themelore të këtyre veprave penale përbën fakti se pjesa dërrmuese e këtyre veprave penale kanë të bëjnë me mbajtjen në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve dhe përdorimin e tyre, kurse veprat tjera të përcaktuara në këtë kapitull paraqiten më rrallë në praktikën gjyqësore. E veçantë e këtyre veprave penale paraqet fakti se ato mund të kryhen edhe nga personat të cilët posedojnë leje për armën, mirëpo nuk u përmbahen lejeve përkatëse të lëshuara apo nuk respektojnë skadimin e lejeve për afatin e përcaktuar.

Nga analizimi dhe studimi i detajuar i këtyre lëndëve nga praktika gjyqësore konstatohet lehtësisht një panoramë të qartë të lëndëve të gjykuara, ku pasqyrohet jo vetëm efektiviteti i ushtrimit të ndjekjes penale, por dhe dënimi dhe vënia përpara përgjegjësisë penale i një numri të konsiderueshëm personash. Përndryshe, të gjitha veprat penale të përcaktuara në

këtë kapitull kanë të paraparë konfiskimin e detyrueshëm të armëve dhe për shkak se kjo normë është paraparë në formë imperative, ajo zbatohet me përpikëri nga ana e gjykatave.

KPK-ja, përveç kapitullit të veçantë për veprat penale të armëve, po ashtu ka përcaktuar një numër prej 30 (tridhjetë) vepra penale të tjera që trajtohen në formë të cilësuar kur vepra penale është kryer duke përdorur apo pasur me vete armë. Për shkak se vepra penale është kryer në rrethana të tilla, atëherë vetë rrethana se kryesi i veprës penale me vete ka pasur apo ka përdorur armën, cilësohet si formë e cilësuar e veprës penale, përkatësisht përcaktohet dënim më i rëndë dhe kjo më së miri shquan faktin se arma si mjet i rrezikshëm i jep atribut të veçantë veprës penale, duke shkaktuar rrezikshmëri apo edhe frikë më të madhe se zakonisht kur vepra penale kryhet në mungesë të kësaj rrethane. Në shumicën e rasteve, vepra penale e armëve është konsumuar nga një kryes i vetëm, mirëpo në praktikën gjyqësore paraqiten raste edhe të bashkëpunimit dhe atë në forma të ndryshme, qoftë në bashkëkryerje apo edhe në kuadër të krimit të organizuar.

Përkundër faktit se zbatuesit e ligjit në sistemin tonë gjyqësor, përkatësisht prokurorët dhe gjyqtarët, në përgjithësi njohin mjaft mirë normat ligjore të përcaktuara në legjislacionin penal dhe analizojnë me kujdes elementet e veprës penale, duke përfshirë aspektin objektiv dhe subjektiv të veprave penale sipas këtij kapitulli në fushën e prodhimit/mbajtjes/trafikimit të armëve të zjarrit, municioneve luftarake, pjesëve përbërëse të tyre, dhe lëndëve plasëse, në shumicën e lëndëve nga praktika gjyqësore gjenden të pasqyruara normat e Konventës dhe të Protokollit të Kombeve të Bashkuara që trajtojnë prodhimin e paligjshëm të armëve të zjarrit. Në pjesën dërrmuese të ushtrimit të ndjekjes penale për të grumbulluar prova të ligjshme janë përdorur mjete të posaçme të hetimit, siç është blerja e simuluar, e cila ka rezultuar e suksesshme, për sekuestrimin e një numri të madh armësh zjarri apo municionesh të ndryshme dhe njëkohësisht ka shërbyer për të kërkuar dhe realizuar përgjegjësinë penale nga një numër i madh i të pandehurve përkatësisht të dënuarve.

Përkundër faktit se prokurorët, gjyqtarët por edhe profesionistët e tjerë ligjorë kanë njohuri mjaft të mira të dispozitave ligjore, qoftë ato të përcaktuara në KPK apo edhe në Ligjin për armët, megjithatë gjatë analizës së lëndëve të trajtuara në këtë punim janë hasur disa paqartësi në interpretimin e dispozitave ligjore dhe këto janë shtjelluar në hollësi. Siç mund të shihet në lëndët e paraqitura ka pasur interpretim të ndryshëm të disa llojeve të armëve nëse përbëjnë armë sipas dispozitave ligjore në fuqi, me ç'rast është konstatuar se "*diabola*" është armë në kuptimin e dispozitave të Ligjit për armët. Gjithashtu, falë këtyre lëndëve të analizuara janë zgjidhur disa dilema të cilat do të shërbejnë si precedentë për trajtimin e rasteve të ngjashme. Në radhë të parë është zgjidhur dilema nëse revolja me gaz është armë, meqë përmes rastit konkret është konstatuar se edhe kjo armë, ndonëse me rrezikshmëri më të ulët, megjithatë përbën armë sipas dispozitave ligjore. Në mënyrë të ngjashme është konstatuar se armë përbën edhe arma e punuar në mënyrë artizanale. Sikurse edhe rasti ku është konstatuar se edhe fishekët pa armën me të cilën mund të shkrepen përbëjnë armë sipas legjislacionit në fuqi.

Disa dilema tjera janë paraqitur përkitazi me mbajtjen e armës jashtë lejes së përcaktuar dhe jashtë vlefshmërisë së afatit të saj, ku gjithashtu përmes vendimeve gjyqësore të analizuar është ardhur në përfundim se përdorimi i armës jashtë lejes për të cilën është dhënë të përdoret dhe skadimi i afatit gjithashtu paraqesin veprime të fushës penale. Mirëpo, është konstatuar se nuk paraqet vepër penale rasti kur personi nuk e posedon lejen e tij me vete me rastin e ndalimit nga ana e personave zyrtarë.

Disa dilema janë paraqitur edhe përkitazi me posedimin dhe përdorimin e armës, me ç'rast është konstatuar se nëse ndërmerren këto dy veprime, atëherë kryesi përgjigjet për të dy veprimet e tilla inkriminuese. Mirëpo, është hequr dilema dhe është konfirmuar fakti se përdorimi i armës në mënyrë kërcënuese bëhet vetëm me përdorimin e saj, por jo edhe me ekspozimin e saj.

Në mënyrë të veçantë në këtë punim janë analizuar edhe katër raste që lidhen me trafikimin e lëndëve narkotike, që ngërthejnë çështje të cilat kanë shkaktuar dilema në interpretimin e dispozitave ligjore në këtë fushë. Së pari, çështja e sasisë së narkotikut e cila përcakton veprimin e tillë si vepër penale, meqë legjisllacioni penal, por edhe normat *"blanketë"* që rregullojnë këtë fushë nuk kanë përcaktuar sasinë e lëndës narkotike për t'u konsideruar vepër penale. Konkretisht, është analizuar rasti i cili ka ndodhur në një Qendër Paraburgimi. Dilema e shtruar ka qenë nëse sasia prej 0.1 g, e trafikuar në këtë Qendër përbën vepër penale, kurse praktika gjyqësore ka përcaktuar se duke pasur parasysh inkriminimin ligjor dhe faktin se vepra është kryer në një ent ku punohet drejt risocializimit të kryesve të veprave të natyrave të ndryshme penale, atëherë edhe kjo sasi duhet të konsiderohet se përbën vepër penale.

Një segment të rëndësishëm në këtë punim kanë marrë rastet e trafikimit të armëve dhe narkotikëve që lidhen me veprën penale të krimit të organizuar. Kurse, nga analiza e tri lëndëve të kësaj natyre është ardhur në përfundim se në të tri këto raste nuk kemi pasur kryerje të veprës penale *"Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar"*.

Siç mund të shihet edhe nga analiza, në këto lëndë ka pasur aktakuzë nga Prokuroria Speciale e Kosovës për veprën penale të *"Pjesëmarrjes ose organizimit të grupit kriminal të organizuar"*, mirëpo këto cilësime juridike në asnjërin rast nuk janë aprovuar nga ana e gjykatave, të cilat i kanë trajtuar këto si vepra penale të bashkëkryerjes që janë veprime dukshëm më të lehta në raport me veprën penale sipas aktakuzës. Pra, përkundrazi që edhe në vendimet gjyqësore janë paraqitur arsyetime se kanë ekzistuar disa elemente të kësaj vepre penale, si fakti që lënda kishte të bënte me vepra penale ku kryerja kishte karakter transnacional (shtrihej në disa shtete), megjithatë gjykatat kanë konsideruar se nuk janë plotësuar të gjitha elementet e nevojshme për t'u trajtuar si vepër penale e pjesëmarrjes ose organizimit të grupit kriminal të organizuar.

6.2. Disa konstatime në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit

Duke marrë parasysh faktin se veprat penale të përcaktuara në kapitullin e armëve janë vepra penale të cilat ndërlidhen edhe me përfitimin pasuror dhe se armët shpeshherë paraqesin mjete për kryerjen e veprave penale të tjera, te shumica dërrmuese e këtyre veprave penale janë parashikuar dy dënime: dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim. Te disa vepra penale, dënimet me gjobë dhe me burgim janë paraparë të shqiptohen në formë kumulative, kurse te disa të tjera në formë alternative dhe atë varësisht nga natyra dhe rrezikshmëria e këtyre veprave penale.

Duke marrë parasysh se në këtë kapitull janë paraparë disa vepra penale të llojeve dhe karakteristikave të ndryshme, atëherë edhe përcaktimi i dënimeve është mjaft i ndryshëm, si te dënimet me burgim ashtu edhe te dënimet me gjobë. Te dënimet e përcaktuara me gjobë është karakteristike se te disa vepra penale nuk është përcaktuar as minimumi dhe as maksimumi, kështu që në këto raste aplikohet minimumi dhe maksimumi i përcaktuar ligjor. Kurse në disa vepra penale është përcaktuar vetëm maksimumi ligjor, duke filluar nga dymijë e pesëqind (2.500) euro deri në dhjetëmijë (10.000) euro.

Për sa i përket dënimeve me burgim, gjithashtu ka mjaft hapësirë të gjerë mes minimumit dhe maksimumit dhe gjithashtu kryesisht paraqitet në dy forma. Një është ajo ku nuk është përcaktuar fare minimumi ligjor, por vetëm maksimumi. Tjetra është te disa vepra të tjera ku është përcaktuar kufiri mes minimumit dhe maksimumit, një kufi mjaft i lartë që për dy vepra penale ka margjinë të lartë dënimi duke filluar nga një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Duke e analizuar këtë larmi të madhe mes dënimeve të përcaktuara, si për dënimet me gjobë ashtu edhe për ato me burgim, rezulton se ka shumë mundësi që gjykatat të shqiptojnë dënime jo-konsistente dhe padyshim që aplikimi i Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore të botuar nga Gjykata Supreme e Kosovës²⁹ paraqet domosdoshmëri. Gjithsesi, është me rëndësi të potencohet fakti se KPK-ja ka përcaktuar si formë cilësuese përdorimin e armës apo mbajtjen me vete të saj në hiç më pak se tridhjetë (30) vepra penale, që tregon faktin se veprat penale nga ky kapitull duhet konsideruar si vepra penale me rrezikshmëri të lartë.

Lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit në sistemin tonë gjyqësor, zakonisht aplikohen dispozitat e neneve 69, 70, 71 dhe 72 të KPK-së. Këto dispozita aplikohen me qëllim të caktimit, përkatësisht matjes së dënimit ku aplikohen rregullat e përgjithshme

²⁹ https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf

për peshimin e dënimit dhe rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit, kushtet e posaçme për zbutjen e dënimit dhe kufijtë e zbutjes së dënimit. Përveç aplikimit të këtyre dispozitave ligjore, gjithashtu me qëllim të unifikimit të dënimeve, Gjykata Supreme e Kosovës ka miratuar dhe tanimë është në fuqi Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore.³⁰ Ky dokument është mjaft i rëndësishëm, ngase synon që me aplikimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese unike të mundësohet trajtimi i barabartë i kryesve të këtyre veprave penale. Padyshim që nga analiza e dënimeve të lëndëve të analizuara del se në shumicën e rasteve janë shqiptuar dënime me gjobë dhe janë renditur disa rrethana të cilat janë mjaft të standardizuara dhe të cilat nuk bëjnë një individualizim të rrethanave. Së këndejmi, mund të konstatohet fakti se nuk ka pasur analizë të plotë dhe të qartë të rrethanave rënduese dhe lehtësuese me rastin e caktimit të dënimit, siç është parashikuar në dispozitat e KPK-së dhe Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore.

Mjaft e rëndësishme është të theksohet fakti se kemi një dallim mes dënimeve të shqiptuara në rastet kur vepra penale e posedimit të armës kryhet me veprën penale të vrasjes apo vrasjes së rëndë dhe kur vepra penale është kryer si thjesht posedim i armës. Pra, në shumicën e rasteve kur vepra penale e posedimit të armës është vënë në ngarkim krahas vrasjes është e zakonshme që për këtë pikë të akuzës të shqiptohen dënime me burgim në kufi prej 1 (një) deri në 2 (dy) vjet, kurse në rastet kur vepra penale kryhet vetëm si posedim i armës, atëherë zakonisht shqiptohen dënime me gjobë apo dënime me kusht. Konsiderojmë se në funksion të parandalimit, ashtu siç është e përcaktuar me dispozitën e nenit 38 të KPK-së, do të duhej që dënimet të ishin të njëjta, meqë kjo vepër penale ka të njëjtën rrezikshmëri edhe në rastet kur kjo vepër penale vihet në barrë si vepër penale e veçantë.

Pjesë përbërëse e arsyetimit të aktgjykimit është pjesa ku paraqiten të dhënat relevante që kanë ndikuar në caktimin e dënimit. Me këtë rast padyshim që i rëndësishëm është fakti se si vlerësohen rrethanat e kryesit të veprës penale. Për këto vepra penale rezultojnë se dominojnë rrethanat lehtësuese dhe kjo për faktin e shqiptimit të dënimeve të ulëta. Me këtë rast dominojnë rrethanat personale dhe rrethanat e pranimi të fajësisë të cilat padyshim që nganjëherë mbivlerësohen, kurse në të njëjtën kohë rrethanat rënduese nuk potencohen dhe nuk vlerësohen në mënyrë të duhur apo edhe anashkalohen.

Në këtë aspekt e rëndësishme është të potencohet fakti se gjykata këto rrethana nuk i mbështet në prova konkrete, por në shumicën e rasteve vetëm i numëron pa argumentuar në mënyrën e duhur. Konkretisht, një ndër rrethanat që më së shpeshti vlerësohet është pranimi i fajësisë, që do të duhej të përcillet me rrethana tjera të pendimit apo keqardhjes së kryesit, mirëpo këto rrethana nuk argumentohen mjaftueshëm, por vetëm parafrazohen dispozitat ligjore.

30 Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore, Botimi i 1-rë, Prishtinë, 2018

Ndërsa, për sa i përket aplikimit të rrethanave rënduese, mund të përfundojmë se ato potencohen mjaft rrallë dhe kjo për faktin e llojit të dënimit që shqiptohet, pasi në shumicën dërrmuese të rasteve janë shqiptuar dënime me gjobë apo dënime me kusht. E rëndësishme është të potencohet fakti se ndër rrethanat rënduese të cilat mund të aplikohen janë kur kryesi ka precedent penal, përkatësisht ka qenë edhe më parë i dënuar për vepra penale të kësaj natyre apo të ngjashme. Gjithashtu, si rrethana rënduese mund të çmohen edhe rrethanat e përfitimit pasuror, apo kur kryesi ka vepruar në disa shtete, apo duke vepruar për kohë të gjatë rezulton numër i madh i viktimave, apo ka vepruar ndaj një viktime, mirëpo veprimet manifestohen në vazhdimësi.

Konsiderojmë se gjykatat në përgjithësi, por edhe te veprat penale të shqyrtuara në kuadër të këtij punimi duhet të theksojnë me përpikëri rrethanat rënduese dhe lehtësuese të kryesve të këtyre veprave penale dhe mundësisht të paraqiten për këto rrethana, në mënyrë që të arrihet qëllimi i shqiptimit të dënimeve adekuate për veprat penale që lidhen me armët e zjarrit.

